

RAPORT i MONITORIMIT TË
ZBATIMIT TË BUXHETIT VITI 2021
BASHKIA SHKODER

Shkurt 2022

REALIZIMI I BUXHETIT TË VITIT 2021.....	4
REALIZIMI I TE ARDHURAVE TE BASHKISË NGA BURIMET E VETA VENDORE PËR VITIN 2021.....	7
Analiza e peshës specifike sipas kategorive	17
Realizimi i të ardhurave 2021, krahasuar me vitet e kaluara	19
REALIZIMI I SHPENZIMEVE TË BUXHETIT TË VITIT 2021	28
Shpenzimet nga transfertat e pakushtezuar dhe te ardhurat e veta vendore	37
Transferta e pakushtezuar sektoriale	47
Transferta e kushtëzuar	51
Shpenzimet nga fondet e trashëguara	53
VETËVLERËSIMI FINANCIAR PER PERIUDHEN JANAR-DHJETOR 2021 PER SITUATEN E GJENDJES FINANCIARE TE BASHKISË SHKODER	54
FUNKSIONI 1: SHËRBIME TË PËRGJITHSHME PUBLIKE.....	56
Programi 01110: Planifikim, menaxhim dhe administrim	56
Programi 01170: Gjendja Civile	77
FUNKSIONI 03: RENDI DHE SIGURIA PUBLIKE.....	82
Programi 03140: Shërbimet Policore Vendore	82
Programi. 03280: Emergjencat Civile	90
FUNKSIONI 4: ÇËSHTJET EKONOMIKE	96
Programi 04130: Mbështetja për zhvillim ekonomik	96
Programi 04160: Shërbimi i tregjeve, akreditimi dhe inspektimi	115
Programi 04220: Shërbimet bujqësore, inspektimi, siguria ushqimore dhe mbrojtja e konsumatorëve	121
Programi 04240: Menaxhimi i infrastruktures së ujitjes dhe kullimit	129
Programi 04260: Administrimi i Pyjeve dhe Kullotave	134
Programi 04520: Rrjeti rrugor rural	143
Programi 04570: Transporti publik dhe lëvizshmëria	158
Programi 04760: Zhvillimi i Turizmit	164
FUNKSIONI 05: MBROJTJA E MJEDISIT	178
Programi 05100: Menaxhimi i mbetjeve	178
Programi 05200: Menaxhimi i ujërave të zeza	185
Programi 05320: Programet e Mbrojtjes së Mjedisit	192
Programi 05630: Ndërgjegjësimi Mjedisor	198
FUNKSIONI 06: STREHIMI DHE KOMODITETET E KOMUNITETIT	202
Programi 06140: Urbanistika	202
Programi 06330: Furnizimi me ujë	214



Programi 06440: Ndriçimi i rrugëve	220
FUNKSIONI 07: SHËNDETËSIA	222
Programi 07220: Shërbimet e kujdesit parësor	224
FUNKSIONI 8: ARGËTIMI, KULTURA DHE FEJA	229
Programi 08130: Sport dhe argëtim	229
Programi 08220: Trashëgimia kulturore, eventet artistike dhe kulturore	241
FUNKSIONI 09: ARSIMI	265
Programi 09120: Arsimi baze parashkollor	265
Programi 09230: Arsimi i mesem i pergjithshem	277
Programi 09240: Arsimi mesem Profesional	285
FUNKSIONI 10: MBROJTJA SOCIALE.....	292
Programi 10220: Sigurimi shoqëror	292
Programi 10430: Kujdesi social për familjet dhe fëmijët	296
Programi 10661: Strehimi social	325

Realizimi i buxhetit të vitit 2021

Realizimi i buxhetit të vitit 2021, është bërë, duke respektuar nenin 64 të ligjit 139/2015 “ Per veteqeverisjen vendore “, i ndryshuar, ligjin Nr. 9936 date 26.06.2008 “ *Per menaxhimin e sistemit buxhetor ne Republikën e Shqipërisë*”, të ndryshuar , ligjin nr 68/2017 date 27.4.2017 “*Per financat e veteqeverisjes vendore “*, ligjin nr. 10296 date 8.7.2010 “*Per menaxhimin financiar dhe kontrollin*” i ndryshuar, ligjin 137/2020 datë 16.12.2020 “*Për buxhetin e vitit 2021*” të ndryshuar, udhëzimet e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 22 date 30.07.2018 “*Për procedurat standarte të monitorimit të buxhetit të njesive të qeverisjes vendore*”, udhëzimi nr. 9 date 20.03.2018 “*Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit*”; Udhëzimin Plotësues nr. 4 datë 25.01.2021 “*Për zbatimin e buxhetit të vitit 2021*”, VKB nr. 63 datë 28.12.2020 “*Për miratimin e buxhetit të vitit 2021 dhe Programit Buxhetor Afatmesëm Përfundimtar 2021-2023 të Bashkisë Shkodër ”* i ndryshuar.

Bashkia Shkoder, administron dhe menaxhon fondet, sipas programeve të miratuara, si më poshtë:

Funksioni 1 SHËRBIME TË PËRGJITHSHME PUBLIKE

Programi - 01110: Planifikim menaxhim administrim

Programi - 01170: Gjendja civile

Funksioni 3 RENDI DHE SIGURIA PUBLIKE

Programi - 03140: Sherbimet policise vendore

Programi - 03280: Mbrojtje nga zjarri dhe mbrojtja civile”

Funksioni 4 ÇESHTJE EKONOMIKE

Programi - 04130: Mbeshtetje per zhvillim ekonomik

Programi - 04160: Sherbimet e tregjeve, akreditimi dhe inspektimi

Programi - 04220: Sherbimet bujqesore, inspektimi, ushqimi dhe mbrojtja e konsumatorit

Programi - 04240: Menaxhimi i infrastruktures se ujitjes dhe kullimit

Programi - 04260: Administrimi i pyjeve dhe kullotave

Programi - 04520: Rrjeti rrugor rural

Programi - 04570: Transporti publik

Programi - 04760: Zhvillimi i turizmit

Funksioni 5 MBROJTJA E MJEDISIT

Programi - 05100: Menaxhimi i mbetjeve

Programi - 05200: Menaxhimi i Ujrvetezeza dhe kanalizimeve

Programi - 05320: Programet e mbrojtjes se mjedisit

Programi - 05630: Ndergjegjesimi mjedisor

Funksioni 6 STREHIMI DHE KOMODITETET E KOMUNITETIT

Programi - 06140: Planifikim urban vendor

Programi - 06260: Shërbimet Publike vendore
 Programi - 06330: Furnizimi me ujë
 Programi - 06440: Ndricim rrugësh

Funksioni 7 SHENDETESIA

Programi - 07220: Shërbimet e kujdesit përsosor

Funksioni 8 ARGETIMI KULTURA DHE FEJA

Programi - 08130: Sport dhe argetim
 Programi - 08220: Trashëgimia kulturore, eventetartistike dhe kulturore

Funksioni 9 ARSIMI

Programi - 09120: Arsimit bazë përfshirë arsimin parashkollor
 Programi - 09230: Arsimit i mesëm i përgjithshëm
 Programi - 09240: Arsimit profesional

Funksioni 10 MBROJTJA SOCIALE

Programi - 10140: Kujdesi social për personat e sëmurë dhe me aftësitë kufizuara
 Programi - 10430: Kujdesi social për familjet dhe fëmijët
 Programi - 10661: Strehimi social

Burimet e financimit të buxhetit të Bashkisë, vijnë nga dy burime:

Nga burimet e veta vendore, ku përfshihen të ardhurat nga taksat vendore dhe taksat e ndara, të ardhurat nga tarifatat vendore, të ardhura të tjera, donacione, grante ndërkombëtare dhe të ardhura që trashëgohen.

Nga burimet qendrore, ku përfshihen transfertat e pakushtëzuar, transfertat e pakushtëzuar sektoriale për funksionet e transferuara dhe transfertat e kushtëzuar.

Buxheti i vitit 2021, në total në 000/leke me të gjitha burimet e financimit të realizuara, paraqitet si më poshtë:

N r	TE HYRAT DHE FINANCIMET NE LLOGARITE E THESARIT	Plani Fillestar 2021	Plani Korrigjuar 2021	Financim i realizuar	000/leke
					Diferenca
I	TE ARDHURAT E VETA	821,559	821,559	738,099	-83,460
	TË ARDHURA NGA TAKSAT VENDORE	373,082	373,082	259,082	-114,000
	TË ARDHURA NGA TAKSAT E NDARA	105,949	105,949	164,666	58,717
	TE ARDHURA NGA TARIFAT VENDORE	316,584	316,584	287,445	-29,139
	TË ARDHURA TË TJERA	25,944	25,944	26,906	962
II	GRANTE NDERKOMBETARE	758	758	210	-548
III	TË ARDHURA NGA SHITJA E TITUJVE TË PJESËMARRJES NË NDËRMARRJET SHTETËRORE	-	-	23,987	23,987

I	TRANSFERTAT	2,123,964	2,136,223	2,136,223	0
V					
1	Transferte e Pakushtezuar	652,826	652,826	652,826	0
2	Transferte e Pakushtezuar Sektoriale	379,563	390,534	390,534	0
3	Transferte specifike	17,803	17,803	17,803	0
3	Transferte e kushtezuar	1,073,772	1,075,060	1,075,060	0
V	TE TRASHEGUARA	108,955	209,423	209,423	0
1	Transferte e pakushtezuar	65,577	112,411	112,411	-
2	Transferte e Pakushtezuar Sektoriale	16,238	18,475	18,475	-
3	Te ardhura	27,140	77,918	77,918	-
4	Donacione		619	619	-
	TOTALI	3,055,236	3,167,963	3,107,942	-60,021
	Shpenzime me llogari jashte thesari	65,402	43,773	10,299	-33474
	TOTALI VITI 2021	3,120,638	3,211,736	3,118,241	-93,495
1	Transferte e pakushtezuar	153,249	106,415	106,415	0
2	Transferte e Pakushtezuar Sektoriale	33,440	31,203	31,203	0
4	Te ardhura	565,983	378,974	378,974	0
5	Donacione	10,798	10,798	10,798	0
	TE TRASHEGUARA	763,470	527,390	527,390	-
	TOTALI	3,884,108	3,739,127	3,645,631	-93,495

Realizimi i te ardhurave te Bashkisë nga burimet e veta vendore për vitin 2021.

Bashkia Shkodër, në mbështetje të Ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, ka të drejtën dhe përgjegjësinë e mbledhjes së të ardhurave dhe kryerjes së shpenzimeve. Financimin e buxhetit të saj, bashkia e realizon nga:

- a. burimet e veta vendore, ku përfshihen të ardhurat nga taksat vendore dhe taksat e ndara, të ardhurat nga tarifat vendore, të ardhura të tjera dhe të ardhura që trashëgohen;
- b. grantet e projekteve të huaja dhe donacionet;
- c. burimet qendrore, ku përfshihen transfertat e pakushtëzuar, transfertat e kushtëzuar dhe transfertat specifike.

Këto burime të ardhurash bashkia i përdor për financimin e funksioneve të përcaktuara nga Ligji nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”.

Rëndësi e veçantë iu dha shfrytëzimit dhe vënies në efikasitet të aseteve të veta, implementimit të procedurave online e të thjeshta, zgjerimit të bazës taksapaguese, rritjes së nivelit të arkëtimit nëpërmjet politikave lehtësuese, taksave të ulta dhe rritjes së frymës së konkurrencës së ndershme, thjeshtimit dhe standartizimit të procedurave, si dhe trajtimit të qytetarëve dhe bizneseve si partnerë të përbashkët të bashkisë. Objektivat kryesisht të fokusuar në lehtësimin maksimal fiskal dhe shpërndarjen e drejtë të ngarkesës tatimore, kanë ndikuar në nxitjen e zhvillimit dhe zgjerimit të biznesit, duke ruajtur dhe madje duke induktuar me efikasitet rritjen e të ardhurave për zërat kryesorë që lidhen me biznesin. Gjithashtu mundësi i shlyerjes së pagesave pranë taksapaguesit, dhënia e shërbimeve të përmirësuara dhe informimi i taksapaguesit nëpërmjet Zyrave të Integruara me Një Ndalese dhe agjentit tatimor Ujesjelles Kanalizime të shpërndara gjeografikisht në territorin e bashkisë pranë qytetarit, si dhe shtrirja e përshtatja e afateve të pagesave me qëllim lehtësimin e taksapaguesit, kanë ndikuar në përmirësimin e vazhdueshëm të klimës së biznesit dhe marrëdhënies me taksapaguesin. Objektivat e përcaktuar e të realizuar, dhe që kanë ndikuar në përmirësimin e klimës së biznesit, duke ruajtur e madje duke rezultuar si politika efikase në rritjen e të ardhurave, janë ulja e taksave të pronës deri në minimumin ligjor të lejuar, mbështetja e disa aktiviteteve të veçanta si bizneset e prodhimit, lehtësimi kryesisht i bizneseve të vogla, mbështetja me tarifa zero për fermerët, tarifa minimale për tregjet dhe ambulancat etj, me rezultat dhenie frymëmarrje financiare biznesit si dhe Vendimit nr.25, datë 26.06.2020 “Për disa ndryshime në VKB NR.1, datë 22.1.2016 “Për taksat dhe tarifat vendore në Bashkinë Shkodër”, të ndryshuar përjashtimin nga taksat dhe tarifat vendore për një periudhë tre muajore të vitit 2020, për të gjitha kategoritë e taksapaguesve individë, familje, persona fizik dhe juridik, ambulant, OJF, institucione publike në të gjithë territorin e Bashkisë Shkodër.

Politikat e ngjashme për gjendjen sa më pranë taksapaguesit nëpërmjet taksave dhe tarifave të ulëta e në harmoni me shërbimin që ofrohet, si psh: dhënia e lehtësive fiskale për shtresat familjare në nevojë, taksa në minimumin e lejuar ligjor për tokën bujqësore, mundësia e arkëtimit në këste dhe pranë njësive administrative ku banojnë etj, janë zbatuar dhe kanë rezultuar të suksesshme jo vetëm për zbutjen e vështirësive ekonomike për shtresa të veçanta të familjeve dhe reduktimin e papunësisë, por edhe për vetë rritjen e arkëtimit nga viti në vit. Këto politika të lehtësimit fiskal dhe inçentivues, shoqëruar paralelisht me përmirësimin e vazhdueshëm të shërbimit, kanë ndikuar pozitivisht edhe në objektivin për zgjerimin e bazës

së taksapaguesve. Rritja e vazhdueshme e të ardhurave si nga biznesi, ashtu edhe nga taksapaguesi familjar, kundrejt fokusimit për uljen e barrës fiskale nga ana tjetër, vërteton efikasitetin e këtyre politikave, kundrejt rezultatit pozitiv që bashkia ka arritur në rritjen e bazës së taksapaguesve, si familjar, ashtu edhe atij biznes. Vëmendje e veçantë gjatë vitit 2021 i është kushtuar monitorimit të detajuar dhe implementimi i regjistrave të sakte elektronikë të kapaciteteve fiskale, duke përfshirë gjithë territorin e bashkisë. Për këtë arsye ju kushtua vëmendje e veçantë dhe mbështetje logjistike më tej strukturave e konstatimeve në vend të këtyre kapaciteteve, u ushtruan verifikime të vazhdueshme në të gjitha njësitë administrative, duke vijuar me formalizimin e të dhënave dhe dixhitalizimin e tyre, me efekt arritjen e rezultate shumë të mira në pothuajse të gjithë zërat kryesore të të ardhurave. Kujdes të veçantë gjatë vitit 2021 iu kushtua përmirësimit të mëtejshëm të sistemeve të kompjuterizuara, detajimit të raporteve, emetimit të statistikave, saktësisimit dhe detajimit të të dhënave për bizneset, etj. Sot është e mundur hedhja on-line në sistemin e taksave të gjobave të IMT dhe Policisë Bashkiake, llogaritja automoatike e kamatvonesave, llogaritja e menjëhershme dhe emetimi i akt-marrëveshjeve pranë ZIN për subjektet shfytëzuese të hapsirave publike, parkingjeve, ambulantëve etj. Vazhdon përdorimi i aplikacionit për smartphone “Taksat e Mia Shkodër”, ku mundësohet llogaritja e taksës së ndërtesës, truallit dhe tokës bujqësore sipas adresave, vitit fiskal, dhe kategorisë familjare. Objektivi kryesor për realizimin e të ardhurave buxhetore të planifikuara është realizuar në masën 90%, referuar planifikimit buxhetor. Mosrealizimi i planit buxhetor të vitit 2021 ka ardhur kryesisht nga mosrealizimi i taksës së ndikimit në infrastrukturë e cila është realizuar në masën 42 % për arsye të mospagesës së taksës ndikimit në infrastrukturë për legalizimet e ndërtimeve pa leje, mosrealizimi i taksës së tokës bujqësore e cila është realizuar në masën 38 %, si rrjedhim i mosregjistrimit të pronave të tokës bujqësore, problemeve me Aktet e Marrjes së Tokës në Pronësi. Referuar arkëttimeve mujore gjatë vitit 2021, është siguruar njëtrajtshmëri në nivelet e të hyrave mujore, duke garantuar kështu të ardhurat e nevojshme për ushtrimin e funksioneve të veta të bashkisë për gjithë periudhën e vitit buxhetor. Të ardhurat e veta u realizuan nga administrata e bashkisë, Njësitë Administrative, Institucionet dhe agjentët tatimorë, institucionet shtetërore etj. Vijimi i performancës së punës dhe i procesit bashkëpunues, garanton më tej sigurimin e të ardhurave të veta buxhetore vjetore për përmirësimin e vazhdueshëm të shërbimeve që ofron bashkia ndaj qytetarëve të saj, duke realizuar objektivat madhorë në funksion të zhvillimit të qëndrueshëm të të gjithë territorit të bashkisë.

Bashkia Shkodër me burimet e veta arriti të menaxhojë situatën dhe të ofrojë shërbimet e duhura ndaj qytetarëve në gjithë territorin e saj.

Kategorizimi i të ardhurave

- Taksat vendore:
 - Taksa mbi pasurinë e paluajtshme, për ndërtesa, troje dhe toka bujqësore
 - Taksa e ndikimit në infrastrukturë
 - Taksa e fjetjes në hotel
 - Tatimi thjeshtuar mbi fitimin, biznesi vogël nga 5-8 milion, agjent DRT Shkodër
 - Taksa e tabelës për qëllime reklamimi ose identifikimi

- Taksat e ndara:
 - Taksa vjetore e e qarkullimit te mjeteve
 - Taksa mbi kalimin e të drejtës së pronësisë, agjent tatimor ASHK
 - Taksa e rentës minerare
 - Tatimi mbi të ardhurat personale

- Tarifat vendore
 - Tarifa e pastrimit dhe largimit të mbeturinave
 - Tarifa për ndriçimin publik
 - Tarifa për gjelbrimin
 - Tarifa të shërbimit administrativ
 - Tarifa për parkimin e mjeteve e liçensuara dhe vendparkime publike
 - Tarifat e shërbimeve që kryen struktura e mbrojtjes nga zjarri
 - Tarifa për zënien e hapësirave publike
 - Tarifa të institucioneve të arsimit, kultures, sportit, etj

- Të ardhura të tjera:
 - Të ardhura nga Institucionet e arsimit, kulturës, sportit etj.
 - Të ardhura nga kundravajtjet administrative
 - Të ardhura nga dhënia me qira e asetëve
 - Të ardhura nga sekuestime dhe zhdëmtime
 - Të ardhura nga shitja e mallrave dhe e shërbimeve
 - Grante nga ndihma nderkombetare
 - Te ardhura nga donacione/sponsorizime
 - Të ardhura te tjera (komision si agjent tatimor).

Realizimi i të ardhurave nga të ardhurat vendore 2021

Të ardhurat nga Burimet e Veta Vendore /mijë lekë	Plan	Fakt
Të ardhura nga taksat	373,082	259,082
Të ardhura nga taksat e ndara	105,949	164,666
Të ardhura nga tarifat	316,584	287,445
Të ardhura nga burime të tjera vendore	25,944	27,116
Totali	821,559	738,099
<i>Të ardhura nga shitja e titujve të pjesëmarrjes në ndërmarrjet shtetërore</i>	0	23,987
Grante nga ndihma nderkombetare me me sistem të plotë thesari	758	210
PARK4SUMP	758	210
Grante nga ndihma nderkombetare me sistem të pjesshëm thesari	55,103	0
EFICIENCA E ENERGJISE BASHKI TE ZGJUARA	33,474	0
IADSA II	21,629	0
TOTAL GRANTE	55,861	210

Të ardhurat nga burimet e veta vendore për vitin 2021 arritën vlerën 738,099 mijë Lekë. Ato përfshijnë të ardhurat nga taksat vendore, të ardhurat nga taksat e ndara, të ardhura nga tarifatat dhe të ardhura të tjera.

Realizimi i të ardhurave në lidhje me planin


Realizimi i planit të të ardhurave në total është në masën 90%

mijë/lek


Bashkia Shkodër, Realizimi i të ardhurave Viti 2021				
		Bashkia Shkoder		
	LLOJET E TË ARDHURAVE	Plan viti 2021	Realizimi Viti 2021	Krahasimi në % me planin 2021
A	TË ARDHURAT E VETA	821,559	738,099	90%
A.I	TË ARDHURA NGA TAKSAT VENDORE	373,082	259,082	69%
I.1	Të ardhura nga tatimi i thjeshtuar mbi fitimin për BV	7,650	6,974	91%
I.1.0	Të ardhura nga taksa mbi BV	50	139	278%
I.2	Te ardhura nga taksa mbi pasurinë e paluajtshme	179,343	160,406	89%
I.2.1	Të ardhura nga taksa mbi ndërtesat	144,500	138,703	96%
I.2.1.1	Ndërtesa banimi	65,440	55,689	85%
I.2.1.2	Ndërtesa të tjera	79,060	83,014	105%
I.2.2	Të ardhura nga taksa mbi tokën bujqësore	21,736	8,283	38%
I.2.3	Të ardhura nga taksa mbi truallin	13,107	13,421	102%
I.3	Të ardhura nga taksa e fjetjes në hotel	15,000	12,967	86%
I.4	Të ardhura nga taksa e ndikimit në infrastrukturë	155,044	65,687	42%
I.4.1	Nga ndërtimet e reja	124,035	44,006	35%
I.4.2	Ndërtimet ne proces legalizimi	31,009	21,680	70%
I.5	Të ardhura nga taksa e tabelës	15,995	12,909	81%
I.5.1	Takse Tabele	8,797	12,886	146%
I.5.2	Takse Reklame	7,198	23	0%
A.II	TË ARDHURA NGA TAKSAT E NDARA	105,949	164,666	155%
II.1	Të ardhura nga taksa vjetore e qarkullimit te mjeteve	80,100	109,324	136%
II.2	Të ardhura nga taksa mbi kalimin e të drejtës së pronësisë	14,560	17,555	121%
II.3	Të ardhura nga taksa e rentës minerare	35	11	30%
II.4	Të ardhura nga tatimi mbi te ardhurat personale	11,254	37,777	336%
A.III	TE ARDHURA NGA TARIFAT VENDORE	316,584	287,445	91%
III.1	Te ardhura nga tarifa e pastrimit, largimit të mbeturinave	169,711	157,588	93%
III.1.1	Të ardhura nga tarifë pastrimi nga Familje	73,699	62,011	84%
III.1.2	Të ardhura nga tarifë pastrimi nga Institucione	512	721	141%
III.1.3	Të ardhura nga tarifë pastrimi nga Biznesi	95,500	94,856	99%
III.2	Të ardhura nga tarifa për ndriçimin publik	39,767	32,719	82%
III.1.1	Të ardhura nga tarifë për ndriçimin publik nga Familje	23,998	20,449	85%
III.1.2	Të ardhura nga tarifë ndriçimi publik nga Institucione	125	138	110%
III.1.3	Të ardhura nga tarifë ndriçimi publik nga Biznesi	15,644	12,132	78%
III.3	Të ardhura nga tarifa për gjelbrimin	22,972	20,111	88%
III.1.1	Të ardhura nga tarifa për gjelbrimin nga Familje	9,602	7,967	83%
III.1.2	Të ardhura nga tarifë gjelbrimi nga Institucione	160	138	86%
III.1.3	Të ardhura nga tarifë gjelbrimi nga Biznesi	13,210	12,005	91%
III.5	Të ardhura nga tarifa të shërbimit administrativ	84,134	77,028	92%
III.5.1	Nga tarifa administrative, kontroll territorit, AMTP, etj.	3,604	5,707	158%

III.5.2	Nga tarifa për vulosje veterinerë të bagëtitë të therura	848	573	68%
III.5.3	Nga Tarifat e liçensimit të veprimtarive të transportit	1,050	866	82%
III.5.4	Nga tarifa parkimi për mjetet	4,508	5,528	123%
III.5.5	Nga tarifë për dhënie liçensa për tregtimin e naftës	5,000	6,543	131%
III.5.6	Nga tarifat në sektorin e pyjeve dhe kullotave.	580	11	2%
III.5.7	Nga tarifat e shërbimeve që kryen struktura e MKZ	660	1,591	241%
III.5.8	Nga tarifa për zënien e hapësirave publike	45,000	40,470	90%
III.5.9	Nga linjat ajrore dhe nëntokësore	500	0	
III.5.10	Nga dokumentat për tender, ankand etj.	12	22	183%
III.1.11	Nga tarifa të institucioneve të arsimit, kultures, sportit, etj	22,372	15,717	70%
III.1.11.1	<i>Biblioteka "Marin Barleti"</i>	15	12	82%
III.1.11.2	<i>Muzeumet</i>	2,500	1,340	54%
III.1.11.3	<i>Teatri "Migjeni"</i>	1,800	679	38%
III.1.11.4	<i>Qendra Kulturore e fëmijëve</i>	177	0	
III.1.11.5	<i>Pallati sportit " Qazim Dervishi"</i>	650	0	
III.1.11.6	<i>Stadiumi Loro Borici</i>	800	0	
III.1.11.7	<i>Qendra Komunitare</i>	0	0	
III.1.11.8	<i>Nga mensat (konviktet)</i>	30	69	229%
III.1.11.9	<i>Nga kopshtet</i>	11,100	9,055	82%
III.1.11.10	<i>Nga çerdhet</i>	5,300	4,562	86%
A.IV	TË ARDHURA TË TJERA	25,944	26,268	101%
IV.1	Të ardhura nga kundravajtjet administrative (Gjobat)	20,000	21,768	109%
IV.1.1	<i>Gjobe Kësti</i>	9,500	12,239	129%
IV.1.2	<i>Gjoba Policia Ndërtimore</i>	9,000	8,551	95%
IV.1.3	<i>Gjobe Gjendja Civile</i>	0	0	
IV.1.4	<i>Gjobe Policia Bashkiake</i>	1,500	978	65%
IV.2	Të ardhura nga dhënia me qira	2,543	2,802	110%
IV.3	Të ardhura nga sekuestrime dhe zhdëmtime	3,060	1,396	46%
IV.4	Grante nga nivele tjera qeverisje-nga buxheti i pushtetit qendror	0	0	#DIV/0!
IV.5	Të ardhura nga shitja e mallrave dhe e shërbimeve	0	0	
IV.6	Të ardhura nga shitja e aktiveve	0	0	
IV.7	Të ardhura nga privatizimi	0	0	
IV.8	Të ardhura të tjera	341	301	88%
IV.9	Të ardhura nga garanci financiare	0	0	
IV.10	TË ARDHURA NGA DONACIONET	0	639	#DIV/0!
	<i>Të ardhura nga shitja e titujve të pjesëmarrjes në ndërmarrjet shtetërore</i>	0	23,987	
	Grante nga ndihma nderkombetare me me sistem të plotë thesari	758	210	28%
	PARK4SUMP	758	210	
	Grante nga ndihma nderkombetare me sistem të pjesshëm thesari	55,103	0	
	EFICIENCA E ENERGIJE BASHKI TE ZGJUARA	33,474	0	
	IADSA II	21,629	0	
	TOTAL GRANTE	55,861	210	

Grafiku i mëposhtëm paraqet nivelin e planifikimit dhe realizimit të të ardhurave sipas kategorive kryesore.



Grafiku i mëposhtëm pasqyron përqindjen e realizimit të ardhurave për zërat kryesorë, në raport me planin.



Zërat kryesorë, që janë me tejkalim në krahasim me planin e vitit 2021 janë të ardhurat nga taksa e truallit, të ardhura nga taksa e mjeteve të përdorura, të ardhura nga taksa mbi kalimin e të drejtës së pronësisë, të ardhurat nga tarifa e parkimit, të ardhurat nga kamatvonesat për subjektet, të ardhurat nga gjobat e IMT-së, si dhe të ardhura nga detyrime të prapambetura.



Të ardhurat për këto zëra janë realizuar me tejkalim si rezultat i zgjerimit së bazës taksapaguesesi efekt i rritjes së kontrollit në terren dhe realizimit të 2567 akt-kontrolleve, ushtrimit të masave shtrënguese ligjore rreth 651 bllokime llogari bankare, sensibilizimit dhe ndërgjegjësimit të takapagueve nëpërmjet njoftimeve në media dhe në ëeb, nëpërmjet dërgimit të rreth 4.950 njoftim-detyrimeve, përmirësimit të sistemit informatik SiTTV dhe lidhjes me Zyrën me INdalesë, rivlersimit të kategorive dhe aktivitetit të subjekteve, mbështetjes nga agjentët tatmorë etj.

Në realizimin e planit kanë ndikuar gjithashtu edhe donacionit, Grantet , si dhe shitja e titujve të pjesëmarrjes në ndërmarrjet shtetërore "Klubi Futbollit Vllaznia.

Zërat ndikues me mosrealizim janë taksa e tokës bujqësore, si rezultat i mungesës së informacionit të plotë nga ASHK me pasojë vështirësinë e krijimit të regjistrave të saktë që lidhin pronën dhe taksapaguesin e taksës së tokës bujqësore, taksa e ndikimit në infrastrukturë si rezultat i numrit të ulët të aplikimive për leje ndërtimi. Këto diferenca në të ardhurat buxhetore totale plotësohen nga zëra të tjerë me tejkalim dhe kanë ndikuar në realizimin e mbledhjes së të ardhurave në masën 90 %.

Agjenti tatimor Ujësjiellës Kanalizime sh.a ka rezultuar i bllokuar nga subjekte të treta, shoqëri përmbarimore në bankat e nivelit të dytë, dhe si pasojë detyrimi që Ujësjiellës Kanalizime sh.a ka ndaj Bashkisë Shkodër nuk është transferuar në llogari të saj duke sjellë mosrealizim të ardhurash sipas planifikimit për vitin 2021 me një diferencë prej -50,466 mijë lek, ose ndryshe -6% më pak të ardhura. Kjo vlerë ka ndikuar gjithashtu edhe në mosrealizimin e zërave kryesorë të të ardhurave si: taksa e ndërtesës,e truallit, tarifa e pastrimit, ndriçimit, gjelbërimit etj. Nga ana e Bashkisë Shkodër janë marrë masa për gjetjen dhe ndjekjen e rrugëve ligjore për transferimin e shumave përkatëse të palikujduara duke u bazuar në akt marrëveshjen e lidhur Ujësjiellës Kanalizime sha dhe korrespondencën me bankat e nivelit të dytë .


Grafiku paraqet planin dhe realizimin e të ardhurave për secilën Njësi Administrative më vehte.



Analiza e peshës specifike sipas kategorive

Pjesën më të madhe të të ardhurave e përbëjnë të ardhurat nga tarifat me 39% dhe të ardhurat nga taksat me 35% të totalit.

Grafiku i mëposhtëm peshën e të ardhurave sipas kategorive:




Analiza e peshës specifike sipas zërave

Të ardhurat që mbulojnë pjesën më të madhe të realizimit nga burimet e veta për vitin 2021 janë zërat e tarifës së pastrimit dhe largimit të mbeturinave nga bizneset dhe familjet me 21% të të ardhurave të veta, taksa mbi ndërtesat për biznese dhe banesa me 19%, taksa e ndikimit në infrastrukturë 9%, taksa vjetore e mjeteve të përdorura 15%, tarifa për zënien e hapësirës publike 5%, tarifa e ndriçimit publik 4%, tarifa e gjelbërimit 3%, taksa e tabelës 2%, tarifa nga institucionet e varësisë me 2%, taksa e fjetjes në hotel 2%, gjobat 3%, taksa mbi truallin 2%, etj.

Grafiku vijues paraqet peshën specifike sipas zërave kryesorë të ardhurave të veta të realizuara për vitin 2021.


Realizimi i të ardhurave sipas zërave kryesore



Fluksi monetar mujor i të ardhurave të veta, viti 2021

Falë fokusimit për zgjerim të vazhdueshëm të bazës taksapaguese, evidentimit të kapaciteteve, ndjekjes së hapave ligjorë ndaj subjekteve debitoare, etj., të ardhurat kanë ruajtur një nivelet konstant të arkëtimeve, duke siguruar kështu plotësimin buxhetor dhe fluiditetin e nevojshëm financiar në ushtrimin e funksioneve të veta të bashkisë.

Fluksi monetar i të ardhurave gjatë vitit 2021 në mijë lekë



Referuar arkëtimeve të të gjithë vitit, niveli më i lartë i arkëtimit është në muajin Prill, Qershor dhe Dhjetor, periodha të përcaktuara për afatin e fundit të shlyerjes së detyrimit nga biznesi sipas VKB nr.1, datë 22.01.2016 “Për taksat dhe tarifat vendore në Bashkinë Shkodër” të ndryshuar dhe


falë efektit të njoftimit, sensibilisimit dhe ndjekjes së masave administrative shtrënguese të ushtruara ndaj subjekteve debitore.

Realizimi i të ardhurave 2021, krahasuar me vitet e kaluara

Emertimi /000 Lekë	Viti 2015	Viti 2016	Viti 2017	Viti 2018	Viti 2019	Viti 2020	Viti 2021
Totali	482.687	506.154	612.033	702.144	682.069	659.778	738.309
Taksat vendore	244,549	195,811	278,096	280,071	268,810	233,917	259,082
Taksat e ndara	57,5	54,448	57,207	81,214	94,614	126,722	164,666
Tarifat vendore	171,122	239,277	241,838	305,624	287,610	274,154	287,445
Burime të tjera vendore	9,515	16,618	34,892	35,235	31,034	24,985	27,116

Krahasuar me vitin 2020, realizimi i të ardhurave ka një rritje me rreth +78,531 mijë Lekë, ose **12% më shumë se viti i kaluar**. Kjo rritje vjen si rezultat i performancës pozitive në arkëtimin e detyrimeve aktuale dhe të prapambetura. Rritja e të ardhurave në krahasim edhe me vitin 2019 pasqyron rimëkëmbjen pas krizës dhe pasojave të Covid-19. Në programimin e të ardhurave për vitin 2021 Bashkia Shkodër u tregua e kujdesshme me qëllim parashikimin afatgjatë të pasojave të pandemisë dhe efektin negativ që mund të shkaktonte në mbledhjen e të ardhurave, por hapja shkallë-shkallë dhe sezoni i verës, i cili rigjallëroi turizmin dhe të gjithë sektorët e tjerë të ekonomisë ndikoi pozitivisht në rritjen të ardhurave dhe përmbushjen e objektivave të vendosur.

Analiza e zërave kryesore që kanë ndikuar tek të ardhurat e veta të bashkisë ndër vite



Detyrimi i taksës së pasurisë për biznesin shlyhet bashkë me detyrimet e tjera vjetore, ndërsa detyrimi për familjet llogaritet dhe shlyhet së bashku me faturën e shërbimit të furnizimit me ujë të Ndërmarrja Ujësjellës Kanalizime Sh.A. Shkodër, në cilësinë e agentit tatimor. Detyrimi që Ujësjellës Kanalizime Sh.A ka ndaj Bashkisë Shkodër për taksën e pasurisë në qoftë se do

likujdohej brenda vitit 2021 do sillte një rritje të konsiderueshme krahasimisht me +52,130 mijë lekë për 2020 dhe +27,352 mijë lekë më shumë për vitin 2019.

Taksa e *ndërtesës*, krahasuar me vitin e kaluar, ka pësuar rritje në nivelin e arketimit me +18% më shumë ose 21,198 mijë lekë ndërsa me vitin 2019 ka një diferencë prej -3,432 mijë lekë më pak.

Niveli i arkëtimit ka pasur rritje këtë vit me 2,066 mijë Lekë nga banesat, dhe 19, 132 mijë lekë më shumë ndërtesat për qëllime biznesi, me një total rritje prej +21,198 mijë Leke më shumë se vitin e kaluar.

Rritja në arkëtimin e të ardhurave nga ndërtesat për qëllimi biznesi, ka ardhur si rezultat i përmirësimit të situatës së krijuar nga pandemia COVID-19, rritjes së numrit të njësive të biznesve të reja dhe zgjerimit të aktiviteteve të bizneseve në plazhin e Velipojës krahasimisht me vitin 2020 dhe 2019.

Gjatë vitit 2021, janë rregjistruar rreth 681 biznese të reja krahasuar me 540 biznese të reja në vitin 2020, pra rreth 141 biznese më shumë. Njëkohësisht janë mbyllur ose kanë pezulluar aktivitetin 559 biznese në krahasim me 687 biznese që ishin në vitin 2020.

Gjatë sezonit turistik 2021, kanë zhvilluar aktivitet më shumë njesi biznesi në nj.admin Velipojë, krahasuar me të njëjtën periudhë të v.2020 dhe konkretisht gjatë v.2021 është faturuar një vlerë prej 30,719 mijë lekë taksë ndërtesë, krahasuar me vlerën prej 22,405 mijë lekë në vitin 2020.


Taksa e *truallit*, krahasuar me vitin e kaluar, është pothuajse në të njëjtat nivele arkëtimi me + 1% më shumë ose me +89 mijë Leke më shumë se vitin e kaluar.

Taksa e *tokës bujqësore*, krahasuar me vitin e kaluar, ka pësuar një rritje të konsiderueshme me +3,585 mijë më shumë. Për efekt të lehtësimit fiskal për fermerët, në gjithë bashkinë Shkodër niveli i taksës së tokës bujqësore është ulur me 30%, pra deri në nivelin e lejuar të referencës ligjore, me ndikim nxitjen e fermerëve, por dhe në zgjerimin e bazës së taksapaguesve.


Rritja e të ardhurave ka ardhur si efekt edhe i procedurave të verifikimit të kapaciteteve, të ndjekjes së detyrime, bashkrendimit të punës ndërmjet Nj.A, drejtorisë së bujqësisë, agjentit tatimor, zyrave me një ndalesë etj.

Janë përfshirë falë monitorimit të sistemit të Z1N në skemën e pagesave të taksave dhe tarifave familjare rreth 684 familje, nga të cilat 319 familje në qytet dhe 365 familje në Nj.A., të cilat janë faturuar në Sistemin e Integruar të Taksave dhe Tarifave Vendore të Bashkisë Shkodër.


Zgjerimi i bazës taksapaguese dhe rritja e arkëtimit ka ardhur si rezultat i verifikimeve të kapaciteteve dhe krijimit dhe formalizimit të bazës së të dhënave, i kontakteve konstante në terren me subjektet dhe familjarët, nxitjes së vazhdueshme të debitorëve, si dhe i politikave lehtësuese, nxitëse e sensibilizuese të bashkisë.




Tatim fitimi i biznesit të vogël administrohet, pas miratimit të ndryshimeve ligjore sipas ligjit 142/2015 dt 17.12.2015, “Për disa ndryshime dhe shtesa me ligjin 9632, datë 30/08/2006 “Për sistemin e taksave vendore”, dhe Ligjit Nr. 122/2020 “Për disa ndryshime në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, të ndryshuar arkëtohet nga bizneset e vogla, dhe më pas i transferohet bashkisë nga drejtoria tatimore, në rolin e agjentit tatimor.



Kjo taksë zë një nga zërat më të rëndësishëm tek të ardhurat e veta të bashkisë. Në raport me vitin e kaluar kjo taksë ka një rënie në arkëtim me -3,986mijë Lekë. Kjo rënie pasqyron akoma pasojat e Covid-19 me një rimëkëmbje me hapa shumë të lehtë persa i përket sektorit të ndërtimit.



Të ardhurat nga taksa e hotelit burojnë kryesisht nga zonat turistike, konkretisht plazhi Velipojë, dhe faturohen bazuar në monitorimet dhe verifikimet e herëpashershëm të shfrytëzimit të kapaciteteve në terren. Krahasuar me vitin e kaluar të ardhurat kanë një rritje prej 76 % ose e shprehur në lek 5,587 mijë. Kjo ka ardhë si rrjedhojë e rritjes së kapaciteteve të bizneseve në plazhin e Velipojës, rihapjes graduale pas pandemisë globale COVID-19 dhe rinisjes së lëvizjeve të transportit të udhëtarëve brenda vendit gjatë periudhës së verës. Në qoftë se do ta krahasojmë me vitet e kaluara vihet re një trend i përafritimit të vlerës së arkëtuar me vitet e tjera.



Taksa e tabelës për qëllime reklamimi, krahasuar me vitin e kaluar, ka një rritje prej +1,003 mijë Lek, si rezultat i hyrjes në fuqi të ligjit Nr. 106/2017 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, “për sistemin e taksave vendore”, të ndryshuar”, me efekt uljen e bazës së taksës referuar aneksit Nr. 7 të këtij Ligji.

Taksat e ndara

Taksa e kalimit të drejtës së pronësisë administrohet nga ASHK (Agjensia Shtetërore e Kadastrës), në rolin e agentit tatimor. Taksa mbledhet nga agjenti tatimor i cili ia transferon të ardhurat e grumbulluara bashkisë. Krahasuar me vitin e kaluar kjo taksë është realizuar me +5,111 mijë Lekë, ose +41%.

Taksa vjetore e mjeteve të përdorura grumbullohet bazuar në ligjin 9975 dt. 28.07.2008 “Për Taksat Kombëtare” të ndryshuar, ku përcaktohet administrimi i taksës kombëtare të regjistrimit të mjeteve të përdorura, pas arkëtimit nga institucioni i Drejtorisë Shërbimit Transportit Rrugor në rolin e agentit tatimorë. Krahasuar me vitin e kaluar, rezulton një rritje e të ardhurave nga kjo taksë me një vlerë +23,604 mijë lekë, ose +28%, që është krijuar si realizatat i rritjes së numrit të automjeteve që aplikojnë për regjistrim pranë zyrave të DRShTRr.


Taksa e rentës minerare që grumbullohet bazuar në ligjin 9975 dt. 28.07.2008 “Për Taksat Kombëtare” të ndryshuar, dhe shpërndahet si taksë e ndarë nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë. Rezulton me një rënie të të ardhurave nga viti i kaluar me një vlerë 2 mijë lekë, ose - 15 % .

Tatimi mbi të ardhurat personale, sipas ligjit Nr. 68/2017 “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore”, si taksë e ndarë, duhet t’ transferohet 2% bashkisë. Per 2 vite rresht 2018-2019, bashkisë nuk iu transferua asnjë lekë nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë.

Gjatë vitit 2020, pas 2 viteve, që nga hyrja në fuqi e ligjit, Ministria e Financave dhe Ekonomisëka transferuar vlerë prej 28,545 mijë lek në favor të bashkisë dhe në vitin 2021 një vlerë prej 37,777 mijë lek.


Në total të ardhurat nga taksat e ndara janë realizuar +9,232 mijë lekë më shumë se vitin e kaluar, ose +28%

Tarifat




Tarifat vjetore të pastrimit në total arrijnë vlerën e arketuar prej 157,588 mijë lek me 8,471 mijë lek më shumë konkretisht : nga biznesi për vitin 2021 arrijnë në total vlerën e 94,856 mijë Lekë krahasuar me vlerën e vitit të kaluar kemi një rritje me vlerë +19,115 mijë ose +25%.

Gjithashtu edhe të ardhurat me vlerë 62.011 mijë Lekë nga tarifat vjetore të familjeve kanë një rënie krahasuar me vitin e kaluar me vlerë -10,650 mijë . Kjo vlerë do ishte mbuluar dhe tejkaluar nqs do kishim të arkëtuara edhe vlerën debitore të Ujësjetllës Kanalizime prej 20,163 mijë lek duke sjellë një përmbushje të planit dhe tejkalim të të ardhurave të viteve 2019-2020.




Tarifat vjetore të ndriçimit, që janë arkëtuar për vitin 2021 arrijnë në total vlerën e 32,719 mijë Lekë. Krahasuar me vlerën e vitit të kaluar kemi një rritje me vlerë +1,817 mijë Lekë ose +6% dhe gjithashtu një vlerë prej 4,663 mijë lek, të munguar në arkëtimin e Bashkisë Shkodër për tarifën e ndriçimit si rezultat i bllokimit të llogarive të Ujësjetllës Kanalizime sha.



Tarifat vjetore të gjelbërimit, që janë arkëtuar nga biznesi dhe familjarët për vitin 2021 arrijnë në total vlerën e 20,111 mijë Lekë. Krahasuar me vlerën e vitit të kaluar kemi një rritje me vlerë 292 mijë Lekë ose +1% dhe gjithashtu një vlerë prej 2,187 mijë lek, të munguar në arkëtimin e Bashkisë Shkodër si rezultat i bllokimit të llogarive të Ujësjetës Kanalizime sha. për tarifën e gjelbërimit duke sjellë edhe një tejkalim të vitit 2019.

Të ardhura nga tarifa të shërbimit administrativ të bashkisë



Pavarësisht se institucionet nuk kanë qëllim në vetvete krijimin e të ardhurave, nëpërmjet grumbullimit të tyre dhe gjetjen e burimeve të reja, ato lehtësojnë dhe mundësojnë shërbimin më cilësor dhe më të standartizuar të vetë atyre ndaj qytetarëve.

Edhe pse tarifatat për shërbimet që ofrojnë këto insitucione kulturore, arsimore, sportive etj. kanë pasur tendencë uljeje si rrjedhojë e mbylljes së Klubit Sportiv “Vllaznia ose zerimi kryesisht për disa kategori të veçanta përfituese si nxënës, studenë, grupe rinore etj.” gjithsesi falë përmirësimit të shërbimit me efekt rritjen e fluksit të përfituesve të shërbimeve, shfrytëzimit me efikasitet i ambienteve, si dhe rritjes së numrit të aktiviteteve në përgjithësi, ka rezultuar që në total gjatë vitit 2021 janë krijuar rreth 77,028 mijë Lekë të ardhura.

Krahasuar me vlerën e vitit të kaluar, kemi një rritje me vlerë +2,712 mijë Lekë ose + 4%.

Tarifatat e shërbimit administrativ, kontroll zhvillim territori, AMTP etj. kanë një realizim – 2,561 mijë Lekë më shumë se vitin e kaluar, që vjen edhe si rezultat i numrit të ulët të aplikimeve për kontrole fizike të ndërtesave të përfunduara, si dhe përfundimi i afatit të ligjshmërisë “Kërkesë për pajisje me AMTP “ ofruar nga Bashkia Shkodër sipas Ligji nr. 20/2020 i cili ka shfuqizuar Ligjin nr. 171/2014, “Për përfundimin e procedurave ligjore të kalimit të tokës bujqësore të ish-ndërmarrjeve bujqësore në pronësi të përfituesve”, i ndryshuar


Tarifa e parkimit të mjeteve të liçensuara dhe parkimet publike ka një rritje me + 2,079 mijë Lekë, ose +60%.

Tarifat e shërbimeve që kryen MZSH kanë një rritje prej + 277 mijë Lekë, si rezultat i rritjes së numrit të kontrolleve të ushtruara nga inspektorët dhe detyrimet ligjor të gjithë subjekteve për rinovim të akteve kundra zjarrit.

Tarifat për zënien e hapësirës publike që janë arkëtuar për vitin 2021 arrijnë në vlerën 40,470 mijë Lekë, me një rënie prej -4,880 mijë Lekë më pak se vitin e kaluar, ose -11%. Rreth 72% e të ardhurave nga kjo tarifë u realizua në Plazhin Velipojë.


Tarifat nga institucionet e arsimit, kulturës, sportit etj që janë arkëtuar për vitin 2021 arrijnë në vlerën 15,717 mijë Lekë, me një rritje prej +5,967 mijë Lekë, ose +61%

Të ardhura të tjera




Të ardhurat e tjera burojnë nga gjocat, kamatvonesat, qira etj, për vitin 2021 janë grumbulluar 26,478 mijë lekë. Krahasuar me vitet e kaluara, të ardhurat kanë pasur një zbritje me vlerë – 4,194 mijë Lekë, ose - 14%.

Të ardhurat nga Gjocat



Të ardhura nga kundravajtjet administrative (Gjobat) për vitin 2021 arrijnë në total vlerën e 21,768 mijë Lekë. Krahasuar me vlerën e vitit të kaluar kemi një rritje me vlerë +9,668 mijë Lekë ose +80%.



Të ardhurat nga donacionet për vitin 2021 janë në masën 639 mijë lekë. Këto donacione kanë ardhur nga projekti fitues " krijimi i shërbimit të specializuar ditor për fëmijët me çrregullime të spektrit autik në Bashkinë Shkodër" i financuar nga UNDP në kuadër të thirrjes për projekte " Askush të mos mbetet Pas", projekti People" histori personale të diskriminimit dhe persekutimit nën regjimet totalitare të shekullit XX" ndërmjet shoqatës ATRIUM dhe Bashkisë Shkodër.


Realizimi i shpenzimeve të buxhetit të vitit 2021

Shpenzimet e përgjithshme të buxhetit, të vitit 2021 , nga te gjitha burimet e financimit, arritën në 2,792,779 mije lekë me një nivel realizimi prej 74,7 për qind.

Realizimi i buxhetit, duke përfshirë edhe obligimet me fature apo me kontrate është 3,274,453 mije leke me nivel realizimi prej 87.6 %.


000/leke

Emertimi	Plani Korrigjuar	Likuidimi ne thesar	Realizimi ne %	Obligime me fature/kontrate	Totali realizimit	Realizimi ne %
Paga dhe Sigurime	836,119	660,878	79%	-	660,878	79%
Shpenz.Operative	891,063	522,729	59%	238,512	761,241	85%
Subvencione	3,000	-	0%	-	-	0%
Transferime	1,204,164	1,133,408	94%	11,569	1,144,977	95%
Investime	761,008	465,945	61%	231,593	697,538	92%
Totali shpenzimeve me Thesar	3,695,354	2,782,960	75%	481,674	3,264,634	88%
Shpenzime me llogari jashte thesari	43,773	9,819	22%		9,819	22%
TOTALI	3,739,127	2,792,779	74.7%	481,674	3,274,453	88%



Peshen me te madhe te realizimit ne perqindje e zene transferimet ne masen 35 % ku perfshihen ndihmat ekonomike dhe pagesa e personave me aftesi ndryshe ne shumen 943 959 mije leke si transferte e kushtezuar .

Pesha specifike e shpenzimet totale per 12 M 2021







Shpenzimet per paga rreth 55,82 % jane realizuar me burim financimi Burimet e Veta , rreth 40.12 % me Transferte e pakushtezuar sektoriale, 0,15% me donacion dhe 3,91 % me Transferte te Kushtezuar.

Shpenzimet operative rreth 84,27 % jane realizuar me Burimet e veta, 14,41 % me Transferte e pakushtezuar sektoriale, 0,30 % me donacion dhe 1,02 % me Transferte te Kushtezuar.

Shpenzimet per transferime jane realizuar me transferte te kushtezuar me rreth 84.5 % ,me Burimet e veta 11,96 % dhe 3,51 % me Transferte e pakushtezuar sektoriale dhe 0,03 % me donacion .

Shpenzimet per investime rreth 92,41 % jane realizuar me Burimet e Veta dhe 0,36 % me Transferte e pakushtezuar sektoriale, 0,36 % me donacion dhe 6,87 % me Transferte te Kushtezuar. Realizimi i shpenzimeve sipas burimeve te financimit paraqitet si me poshte:




Realizimi i shpenzimeve sipas matricës së programeve, per vitin 2021 paraqitet si me poshte:

000/leke

Programi	EMERTIMI	Paga dhe Sigurime			Shpenzime operative			Subvencione			Transferime			Investime			Totali		
		Plani fillestar 2021	Plani korrigjuar 2021	Realizimi 2021	Plani fillestar 2021	Plani korrigjuar 2021	Realizimi 2021	Plani fillestar 2021	Plani korrigjuar 2021	Realizimi 2021	Plani fillestar 2021	Plani korrigjuar 2021	Realizimi 2021	Plani fillestar 2021	Plani korrigjuar 2021	Realizimi 2021	Plani fillestar 2021	Plani korrigjuar 2021	Realizimi 2021
		Totali	Totali	Totali	Totali	Totali	Totali	Totali	Totali	Totali	Totali	Totali	Totali	Totali	Totali	Totali	Totali	Totali	Totali
01110	Planifikimi Menaxhimi dhe Administrimi	257,933	237,804	182,331	90,600	87,661	46,187	-	-	-	4,994	5,708	2,666	11,684	8,660	5,341	365,211	339,833	236,525
01170	Gjendja civile	15,818	15,386	15,289	-	-	-	-	-	-	-	379	118	-	-	-	15,818	15,765	15,407
1620	Shërbime të tjera të përgjithshme	-	9,122	9,122	-	973	769	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	10,095	9,891
03140	Shërbimet e Policisë Vendore	24,840	20,807	14,530	3,856	3,556	2,450	-	-	-	-	-	-	2,000	2,000	1,987	30,696	26,363	18,967
03280	Mbrojtja nga zjarri dhe mbrojtja civile	47,823	42,098	34,238	76,253	53,726	21,286	-	-	-	48,295	12,640	8,756	14,002	13,000	258	186,373	121,464	64,538
04130	Mbështetje për zhvillimin ekonomik	1,481	1,653	1,451	3,321	2,413	497	-	-	-	5,632	4,686	3,743	1,665	1,665	-	12,099	10,417	5,691
04160	Shërbimet e tregjeve, akreditimi dhe inspektimi	-	-	-	1,856	515	126	-	-	-	-	-	-	962	962	-	2,818	1,477	126
04220	Shërbimet bujqësore, inspektimi, ushqimi dhe mbrojtja e konsumatorëve	-	-	-	3,354	1,924	1,917	-	-	-	-	-	-	-	-	-	3,354	1,924	1,917
04240	Menaxhimi i Infrastrukturaës së ujtes dhe kullimit	17,792	15,287	10,746	24,690	23,848	20,372	-	-	-	52	31	30	307	174	-	42,841	39,340	31,148
04260	Administrimi i pyjeve dhe kullotave	19,360	17,485	10,386	6,133	4,878	2,691	-	-	-	-	-	-	9,373	7,950	-	34,866	30,313	13,077
04520	Rrjeti rrugor rural	-	-	-	37,484	36,583	24,638	-	-	-	-	-	-	497,984	523,369	367,342	535,468	559,952	391,980
04570	Transporti publik	-	-	-	4,471	3,774	3,047	6,000	3,000	-	-	-	-	13,622	4,000	-	24,093	10,774	3,047
04760	Zhvillimi i turizmit	-	-	-	4,603	2,360	863	-	-	-	4,000	2,350	2,346	1,883	1,550	951	10,486	6,260	4,160
05100	Menaxhimi i mbetjeve	-	-	-	286,499	286,499	121,314	-	-	-	-	-	-	4,820	4,455	-	291,319	290,954	121,314
05200	Menaxhimi i ujrave të zeza dhe kanalizimeve	-	-	-	-	-	-	-	-	-	15,000	15,000	13,998	-	-	-	15,000	15,000	13,998

05320	Programet e mbrojtjes së mjedisit	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	40,446	40,446	-	40,446	40,446	-
05630	Ndërgjegjësi mi mjedisor	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
06140	Planifikimi Urban Vendor	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	2,668	1,000	-	2,668	1,000	-
06260	Sherbime publike vendore	40,319	35,985	23,619	55,156	54,162	34,908	-	-	270	194	101	3,600	3,600	3,534	99,345	93,941	62,162	
06330	Furnizimi me ujë	-	-	-	61	61	-	439	-	-	-	-	-	27,404	27,404	9,016	27,904	27,465	9,016
06440	Ndriçim rrugësh	5,071	4,997	4,222	99,049	97,558	94,927	-	-	40	40	-	10,284	9,800	9,720	114,444	112,395	108,869	
07220	Sherbimet e kujdesit parësor	-	-	-	3,000	3,000	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	3,000	3,000	-
08130	Sport dhe argëtim	30,936	15,310	13,450	50,808	35,973	28,310	-	-	45,891	104,144	101,105	101	-	-	127,736	155,427	142,865	
08220	Trashëgimia kulturore, eventet artistike dhe kulturore	60,738	54,057	41,201	58,101	41,342	32,698	-	-	5,336	5,229	2,825	1,491	1,073	956	125,666	101,701	77,680	
09120	Arsimi bazë përfshirë arsimin parashkollor.	249,419	250,144	218,856	83,214	73,997	45,058	-	-	800	1,149	1,149	22,709	17,947	9,543	356,142	343,237	274,606	
09230	Arsimi i mesëm i përgjithshëm	34,857	31,918	20,459	25,287	17,579	4,792	-	-	-	366	361	27,303	27,263	5,345	87,447	77,126	30,957	
09240	Arsimi profesional	25,409	27,845	18,550	36,199	39,119	23,571	-	-	11,100	13,289	12,572	50,243	28,613	10,800	122,951	108,866	65,493	
10220	Te moshuarit	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
10430	Kujdesi social për familjet dhe fëmijët	62,752	56,218	42,427	22,327	18,381	12,192	-	-	1,009,160	999,401	979,894	1,256	1,253	398	1,095,495	1,075,253	1,034,911	
10661	Strehimi social	-	-	-	1,647	1,182	115	-	-	1,200	9,042	3,747	49,552	78,601	50,574	52,399	88,825	54,436	
	Fond Rezerve /kontigjence									58,025	30,515					58,025	30,515	-	
TOTALI		894,548	836,119	660,878	977,969	891,063	522,729	6,439	3,000	-	1,209,795	1,204,164	1,133,408	795,359	804,781	475,764	3,884,108	3,739,127	2,792,779

Pesha specifike e programeve ne realizimin e 12 M 2021



- 01110 Planifikimi Menaxhimi dhe Administrimi
- 01170 Gjendja civile
- 1620 Shërbime të tjera të përgjithshme
- 03140 Shërbimet e Policisë Vendore
- 03280 Mbrotja nga zjarri dhe mbrotja civile
- 04130 Mbështetje për zhvillimin ekonomik
- 04160 Shërbimet e tregjeve, akreditimi dhe inspektimi
- 04220 Shërbimet bujqësore, inspektimi, ushqimi dhe mbrotja e konsumatoreve
- 04240 Menaxhimi i Infrastruktues së ujitjes dhe kullimit
- 04260 Administrimi i pyjeve dhe kullotave
- 04520 Rrjeti rrugor rural
- 04570 Transporti publik
- 04760 Zhvillimi i turizmit
- 05100 Menaxhimi i mbetjeve
- 05200 Menaxhimi i ujrave të zeza dhe kanalizimeve
- 06260 Shërbime publike vendore
- 06330 Furnizimi me ujë
- 06440 Ndrëçim rrugësh
- 08130 Sport dhe argëtim
- 08220 Trashëgimia kulturore, eventet artistike dhe kulturore
- 09120 Arsimi bazë përfshirë arsimin parashkollor.
- 09230 Arsimi i mesëm i përgjithshëm
- 09240 Arsimi profesional
- 10430 Kujdesi social për familjet dhe fëmijët

Realizimi i shpenzimeve per te gjitha programet sipas Aneksit 1 të monitorimit, paraqitet si me poshte:

ANEKSI nr.1 "Raporti i Shpenzimeve sipas Programeve"

ne 000/leke

Emri i Grupit		BASHKIA SHKODËR			Kodi i Grupit	141	
Programet		Shpenzimet e Njesisë së Vetëqeverisjes Vendore					
		(1)	(2)	(3)	(5)	(6)	(7)=(6)-(5)
Titulli	Emërtimi	Fakti i vitit paraardhës Viti 2020	PBA Viti 2021	Buxheti Vjetor Plan Fillestar	Buxheti Vjetor Plan i Periudhës/ progresiv	Fakti i Periudhës/ progresiv	Diferenca
1110	Planifikim Menaxhim Administrim	245,534	282,252	365,212	339,598	236,527	(103,071)
1170	Gjendja Civile	17,091	15,818	15,818	15,765	15,407	(357)
1620	Zgjedhje të Përgjithshme dhe Lokale	-	-	-	10,095	9,891	(204)
3140	Shërbimet e Policise Vendore	22,211	21,067	30,696	26,363	18,967	(7,396)
3280	Mbrojtja nga zjarri dhe mbrojtja civile	48,878	134,458	186,373	113,405	56,479	(56,926)
4130	Mbështetja për Zhvillim Ekonomik	5,114	7,850	12,098	10,417	5,690	(4,726)
4160	Shërbimi i tregjeve, akreditimi dhe inspektimi	144	1,462	2,818	1,477	126	(1,351)
4220	Shërbimet bujqësore, inspektimi, siguria ushqimore dhe mbrojtja e konsumatorëve	1,014	1,924	3,354	1,924	1,917	(7)
4240	Menaxhimi i infrastrukturës së kullimit dhe ujitjes	29,862	34,331	42,841	39,340	31,148	(8,192)
4260	Administrimi i pyjeve dhe kullotave	11,821	16,541	34,866	30,313	13,076	(17,237)
4520	Rrjeti rrugor rural	302,020	339,446	535,388	559,870	391,979	(167,891)
4530	Menaxhimi i rrugëve	86	-	80	80	-	(80)
4570	Transporti publik	4,450	10,637	24,093	10,774	3,047	(7,727)
4760	Zhvillimi i Turizmit	2,624	6,160	10,486	6,260	4,160	(2,100)
4910	Fondi Rezerve	-	10,149	10,149	10,149	-	(10,149)
4940	Fondi i kontigjences	-	20,366	20,366	20,366	-	(20,366)
4960	Ndërmjet llogarive në qendër	-	-	-	235	-	(235)
4980	Shpenzime të tjera	-	-	27,510	-	-	-

5100	Menaxhimi i mbetjeve	131,593	197,340	291,318	290,954	121,313	(169,640)
5200	Menaxhimi i ujërave të zeza dhe kanalizimeve	14,710	15,000	15,000	15,000	13,998	(1,002)
5320	Mbrojtja e mjedisit	-	6,972	6,972	6,972	-	(6,972)
6140	Planifikimi Urban Vendor	-	500	2,668	1,000	-	(1,000)
6190	Strehimi	69,144	-	5,522	54,342	50,702	(3,639)
6220	Menaxhim i Mbetjeve Urbane	-	-	-	-	-	-
6260	Shërbimet publike vendore	78,943	84,049	99,345	93,941	62,160	(31,781)
6330	Furnizimi me ujë	18,585	-	27,904	27,465	9,016	(18,449)
6440	Ndriçim rrugësh	106,644	111,101	114,445	112,395	108,869	(3,526)
7220	Shërbimet e kujdesit parësor	1,147	-	3,000	3,000	-	(3,000)
8130	Sport dhe argëtim	104,715	105,586	127,391	155,083	142,520	(12,563)
8140	Zhvillimi i Sportit	3,229	-	344	344	344	-
8220	Trashëgimia kulturore, eventet artistike dhe kulturore	71,887	88,446	125,373	101,409	77,680	(23,729)
8250	Programe specifike kulturore dhe të turizmit	-	-	292	292	-	(292)
9120	Arsimi bazë përfshirë arsimin parashkollor.	260,478	312,920	356,141	343,236	274,607	(68,630)
9230	Arsimi i mesëm i përgjithshëm	111,788	118,672	146,380	142,491	72,413	(70,078)
9240	Arsimi profesional	11,299	17,805	32,090	33,202	14,218	(18,984)
10140	Kujdesi social për personat e semure dhe me aftësi të kufizuara	356	-	885	684	-	(684)
10430	Kujdesi social për familjet dhe fëmijët	1,091,268	1,067,629	1,094,610	1,074,569	1,034,911	(39,658)
10661	Strehimi social	789	26,754	46,877	34,483	3,734	(30,750)
10910	Emergjencat Civile	7,033	-	-	8,059	8,059	-
Totali i Shpenzimeve të Njesisë		2,774,458	3,055,236	3,818,706	3,695,354	2,782,960	(912,393)
P03140.O1.A1 Vazhdimësia e menaxhimit efektiv të Policisë Bashkiake në funksion të përbushjes së misionit, qëllimeve dhe objektivave dhe përgjegjësi të Bashkisë së Shkodrës për ofrimin e shërbimeve ndaj qytetarëve. & Të trashëguara	18,107	20,807	14,530
P03140.O2.A1 Pajisje me Uniforma për Policinë Bashkiake & të trashëguara	800	1,396	1,246
P03140.O2.A2 Mbështetje dhe ofrim i shërbimit të transportit për funksionimin e policisë Bashkiake	1,320	1,320	1,204
P03140.O2.A3 Blerje dokumentacioni shtypshkrime në funksion të policisë bashkiake	40	40	-
P03140.O2.A4.Furnizim, vendosje kamera sigurie(CCTV) për ambiente publike dhe mirëmbajtja e tyre.	800	800	-

P03140.O2.A5. Blerje automjete në funksion të policisë bashkiake – të trashëguara	-	2,000	1,987
03140 Shërbimet e policisë vendore	21,067	26,363	18,967
Të trashëguara	9,629	-	-
Totali	30,696	26,363	18,967

Aktivitetet janë realizuar si më poshtë:

P03140.O1.A1 Vazhdimësia e menaxhimit efektiv të Policisë Bashkiake në funksion të përmbushjes së misionit, qëllimeve dhe objektivave dhe përgjegjësive të Bashkisë së Shkodrës për ofrimin e shërbimeve ndaj qytetarëve.

Për 12 mujorin e vitit 2021 janë realizuar pagesa për pagat+sigurime shoqërore dhe shëndetësore për 21 punonjës të policisë bashkiake me vlerë 14,530 mijë lekë. Në strukturën e Bashkisë Shkodër janë planifikuar 24 punonjës. Bashkia Shkodër, Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve mbështetëqse, dhe Drejtoria e Policisë Bashkiake, kanë nisur procedurat e rekrutimit për punonjës policie të nivelit të lartë drejtues, nivelit të mesëm drejtues dhe nivelit zbatues për pozicionet vakante.

P03140.O2.A1 Pajisje me Uniforma për Policinë Bashkiake.

Për vitin 2021 është planifikuar fondi prej 1,396 mijë lekë për blerjen e uniformave për punonjësit e policisë bashkiake. Aktualisht kemi realizuar procedurën e prokurimit dhe është bërë blerje e uniformave, si dhe paisja efektivave të Policisë Bashkiake me uniformat e reja.

P03140.O2.A2 Mbështetje dhe ofrim i shërbimit të transportit për funksionimin e policisë Bashkiake.

Në funksion të policisë bashkiake janë 3 automjete, i cili për 12-mujorin e vitit 2021 është shpenzuar 1,204 mijë lekë për siguracion makine.

P03140.O2.A3 Blerje dokumentacioni shtypshkrime në funksion të policisë bashkiake.

Për këtë aktivitet nuk është realizuar shpenzim për periudhën e 12- mujorit të vitit 2021. Blerja e shtypshkrimeve (akt konstatime shkelje akt kontrollë raport shërbime etj) kryhet përmes blerjes shtypshkronjës së letrave me vlerë. Blerja e shtypshkrimeve është në proces të hartimit të dokumentacionit teknik për realizimin më pas të prokurimit të fondit të planifikuar sipas nevojës për shtypshkrime.

Programi. 03280: Emergjencat Civile

Ky program përfshin institucione dhe konkretisht:

2. Aparatin e Bashkisë
3. MZSH

Realizimi i qëllimit dhe objektivave të politikës së programit:

-Qëllimi i programit të Emergjencave Civile është:

Zvogëlimi i riskut nga fatkeqësitë dhe menaxhimi i tyre, duke siguruar mbrojtjen e jetës së njerëzve, pronës, trashëgimisë kulturore dhe mjedisit nëpërmjet sistemit të mbrojtjes civile.

-Objektivat e programit buxhetor për përmbushjen e këtij qëllimi për 12-mujorin e vitit 2021 kanë qënë:

O1. Strukturat për planifikimin, menaxhimin dhe përballimin e emergjencave civile.

Është realizuar pagesa për transportin e tre automjeteve nga Ancona në Durrës, dhuratë nga Brigata Kombëtare e Zjarrit Italian CNVV.

Është realizuar Objekti “Shërbim për mirëmbajtjen emergjente të objekteve infrastrukturore nga situatat e rënduara atmosferike Bashkia Shkodër”

O2. Shërbim i përmirësuar i MZSH me prioritet parandalimin e ngjarjeve.

Është realizuar blerja e koncentratit për bagëti.

Është realizuar Loti I-rë Shërbime për mirëmbajtjen emergjente të rrugëve të qytetit dhe njësive administrative Bashkia Shkodër.

Është realizuar Loti II-të Shërbime për mirëmbajtjen emergjente të segmentit Ura Mesit – Prekal – Kir - Mali Shoshit – Breglumi – Nderlytaj – Theth.


Është realizuar blerja materiale dizinfektuese për COVID 19.

Është dhënë ndihma për raste fatkeqesi, shtëpi të djegura.

Realizimi i Buxhetit të planifikuara


mijë lekë

Programi 03280	Paga & sigurime	Shpenzime operative	Transferta	Investime	Totali
PBA 2021	36,432	41,659	44,367	12,000	134,458
Plani fillestar 2021	47,823	76,253	48,295	14,002	186,373
Plani i rishikuar 2021	42,098	53,726	12,640	13,000	121,464
Realizimi viti 2021	34,238	21,286	8,756	258	64,538
% e realizimit	81.3%	39.6%	69.3%	2.0%	53.1%



Realizimi i shpenzimeve për paga, shpenzime operative, transferime dhe kapitale për këtë program, duke e krahasuar me planifikimin është 53.1 %, sipas zërave kryesorë si më poshtë:

Shpenzime korrente	59.3%
Shpenzime kapitale	2.0%



Faktorët që kanë ndikuar në mosrealizimin e fondeve të planifikuara:

- Plotësimi i dokumentacionit ligjor teknik për masat MZSH dhe certifikimi për MZSH i të gjitha objekteve të varësi të Bashkisë është mbartur për t'u realizuar në vitin 2022.
- Blerja dhe rimbushje e fikeve të zjarrit nuk është realizuar.

Aneksi nr.4 Raporti i realizimit të objektivave të politikës së programit

Periudha e Raportimit: 01.01.2021-31.12.2021

Kodi i Programit	3280	Emertimi i programit:	Mbrojtja nga zjarri dhe mbrojtja civile					Komente	
Qellimi 1	<p>Zvogëlimi i riskut nga fatkeqësitë dhe menaxhimi i tyre, duke siguruar mbrojtjen e jetës së njerëzve, pronës, trashëgimisë kulturore dhe mjedisit, nëpërmjet sistemit të mbrojtjes civile. 1. Përafritimi me standardet europiane të organizimit të mbrojtjes civile. 2. Sigurimi i mbrojtjes civile në të gjithë territorin. 3. Parandalimi.</p> <p>4. Informim public për reziqet dhe aktivitetet e organeve vendore përgjegjëse për mbrojtje nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë e tjera. Garantimin e shërbimit të zjarrfikësve në nivel lokal dhe administrimi i strukturave përkatëse, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj;</p>								
**Treguesit e performancës/Produktet:									
Objektivat e politikës:		Kodi i Treguesit te Performances/Produktit	Emertimi i Treguesit te Performances	Niveli faktik i vitit paraardhes	Niveli i planifikuar ne vitin korent	Niveli i rishikuar ne vitin korent	Niveli faktik ne fund te vitit korent	% e Realizimit te Treguesit te Performances/Produktit	
Objektivi 1	Strukturat per planifikimin, menaxhimin dhe përballimin e emergjencave civile	1	Zone e ndikuar nga fatkeqesite (Nj. A)	7	7	7	7	100%	
		2	Familje te trajtuara ,e shperblim per fatkeqesi natyrore	3	37	37	8	22%	
		3	Numri i kontrolleve sistematike vjetore per certifikimin për MZSH i objekteve të Bashkisë.	0	190	190	0	0%	
		4	Rritja e numrit të ofruar të pajisjeve dhe kolaudimi i fikësve të zjarrit në institucione: (ritja vjetore në %)	0	0	0	0		

Objektivi 2	Shërbim i përmirësuar i MZSH me prioritet parandalimin e ngjarjeve.							
		5	Numri i stacioneve të MZSH që ka bashkia	1	1	1	1	100%
		6	Numri total i rasteve të menaxhuara	403	640	640	517	81%
		7	Të ardhurat nga tarifat për shërbimin ndaj të tretëve (pajisja me çertifikata, , etj) në mijë Lekë	1314	660	660	516	78%
		8	Koha e daljes nga stacioni në sekonda:	60	60	60	60	
		9	diten	45	45	45	45	100%
		10	naten	7	7	7	7	100%
		11	Numri i thirrjeve nga popullata drejt Shërbimit Zjarrfikës	528	508	508	830	163%
	12	Efiçienca buxhetore në ofrimin e shërbimit MZSH (leke/raste të menaxhuara)	91	67.6	78.3	78.4	100%	

ANEKSI nr.3 "Raporti permbledhes i realizimit te treguesve te performances/produkteve te programit"

Emri i Grupit	Bashkia Shkodër	Kodi i Grupit	141
Programi	Mbrojtja nga zjarri dhe mbrojtja civile	Kodi i Programit	3280

Kodi	Emertimi i Produktit	Njësia matese	Sasia Faktike (v. 2020)	Shpenzimet (v. 2020)	I			II			III			IV			Luhatjet ne Koston per Njesi	Komente
					Kosto per Njesi (v. 2020)	Sasia (v. 2021)	Shpenzimet (v. 2021)	Kosto per Njesi (v. 2021)	Sasia e Rishikuar (v. 2021)	Shpenzimet e Rishikuara (v. 2021)	Kosto per Njesi e Rishikuar (v. 2021)	Sasia Faktike (v. 2021)	Shpenzimet Faktike (v. 2021)	Kosto per Njesi Faktike (v. 2021)	V = IV - I	V = IV - II		
1	Masa të marra për parashikimin, parandalimin, lehtësimin, gatishmërinë, përgjigjen dhe rimëkëmbjen nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë e tjera, me qëllim mbrojtjen e jetës së njerëzve, të gjësë së gjallë, të pronës, të trashëgimisë kulturore dhe të mjedisit	numër	15,717	15,936	1	1,517	91,040	60	1,517	71,359	47	1,430	24,021	17	16	-43	-30	
2	Raste të menaxhuara për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimi	Numri i rasteve të menaxhuara	403	37,007	92	640	43,418	68	640	50,105	78	517	40,517	78	-13	11	0	

Drejtuesi i Ekipit Menaxhues të Programit	Emri	Alfred Luleta	Kryetari i Njesisë së Vetëqeverisjes Vendore	Emri	Voltana Ademi
	Firma			Firma	
	Data			Data	

Për vitin 2021 në Programin "Mbrojtja nga zjarri dhe mbrojtja civile" në funksion të veprimtarisë kryesore dhe përmbushjen e objektivave të përcaktuara, janë parashikuar 4 aktivitete.

-Aktivitetet janë analizuar si me poshtë:

P.03280.O1.A2. Përballimi i ndihmave të menjëherëshme për familjet me raste fatkeqësie

P.03280.O1.A3. Plotësimi i dokumentacionit ligjor teknik për masat MZSH dhe çertifikimi për MZSH i të gjitha objekteve në varësi të Bashkisë

P.03280.O2.A1. Shërbimi i Mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimi

P.03280.O2.A2. Rikonstrukcion i godinës së MZSH

Aktiviteti	Buxheti Fillestar në mijë lekë	Buxheti i Rishikuar në mijë lekë	Realizimi i 12 Mujorit 2021 në mijë lekë
P.03280.O1.A1. Struktura e mbrojtjes civile dhe organizimi i strukturave vullnetare në Bashkinë Shkodër & të trashëguara.	84,040	54,270	15,742
P.03280.O1.A2. Përballimi i ndihmave të menjëherëshme për familjet me raste fatkeqësie	3,000	12,089	8,279
P.03280.O1.A3. Plotësimi i dokumentacionit ligjor teknik për masat MZSH dhe çertifikimi për MZSH i të gjitha objekteve në varësi të Bashkisë & të trashëguara.	4,000	5,000	-
P.03280.O2.A1. Shërbimi i Mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimi & të trashëguara.	43,418	50,105	40,517
03280 Mbrojtja nga Zjarri dhe Mbrojtja Civile	134,458	121,464	64,538
Të trashëguarat	51,915		
Totali	186,373	121,464	64,538

FUNKSIONI 4: ÇËSHTJET EKONOMIKE

Programi 04130: Mbështetja për zhvillim ekonomik

Drejtoria e Planifikimit Strategjik dhe Përmirësimit të Klimës së Biznesit ka për qëllim rritjen ekonomike nëpërmjet tërheqjes së investitorëve të huaj dhe zhvillimi i NVM-ve. Kjo arrihet nga forcimi i bashkëpunimit ndërmjet pushtetit vendor, bizneseve dhe punëkërkesve, me qëllim promovimin e forcës aktive të punës, promovimin e produkteve dhe shërbimeve të bizneseve sipas sektorëve të ndryshëm të ekonomisë. Në mbështetje të biznesit, si institucion realizojmë panairin e Punës dhe të Biznesit cdo vit brenda ambienteve të Bashkisë si një mënyrë shumë efektive për të vënë përballë njëri-tjetrit të gjithë aktorët e interesuar në proces. Qëllimi është krijimi i një netëorke - u që lidh aktorët e interesuar, shkëmben informacionet me synim zbutjen e papunësisë. Këtë vit, për shkak të situatës së krijuar nga Covid-19, u mendua rikonceptimi i panairëve në njësitë administrative nga ana jonë me qëllim promovimin e vlerave artistiko-kulturne dhe të produkteve të territorit të njësisë administrative të Bashkisë. U bë e mundur një fushatë promovionale për promovimin e traditës, kulturës si dhe të produkteve vendase të njësisë administrative duke qenë kështu dhe një mbështetje për bizneset e zonës.

Realizimi i qëllimit dhe objektivave të politikës së programit

Bashkia Shkodër gjatë vitit 2021 në programin 04130 “Mbështetja për zhvillim ekonomik” ka qëllim të programit të saj këto funksione zhvillimi:

- Hartimi i planeve dhe programeve për zhvillimin ekonomik lokal.
- Ngritja dhe funksionimi i tregjeve publike dhe i rrjetit të tregtisë.
- Mbështetje për zhvillimin e biznesit të vogël nëpërmjet veprimtarive nxitëse, të tilla si panairë e reklama në vende publike.
- Publikimi i broshurave informative, krijimit të portaleve me profil ekonomik.
- Dhënia e granteve dhe ndihmave financiare për mbështetjen e aktiviteteve të biznesit të vogël dhe të mesëm, sipas mënyrës së përcaktuar në legjislacionin në fuqi.

Objektivat për përmbushjen e këtyre funksioneve për 12- mujin e vitit 2021 janë:

O1. Mbështetja për përmirësimin e klimës për zhvillimin e biznesit nëpërmjet ngritjes së strukturave të dedikuara, bashkëpunimit me institucione të specializuara dhe aktorët e interesuar për hartimin e strategjive dhe planeve ekonomike zhvillimore lokale.


O2. Promovimi i produkteve vendore dhe fuqisë së punonjësve të specializuar për tregun lokal, kombëtar dhe ndërkombëtar.

O3. Hartimi dhe publikimi i materialeve informative dhe promovionale për nxitjen e investimeve vendase dhe të huaja.

O4. Nxitja dhe mbështetja e bashkëpunimit të biznesit vendor, nëpërmjet incentivave financiare, për zhvillimin dhe fuqizimin e tyre.


Realizimi i buxhetit të planifikuar

Programi 04130	Paga & Shpenzime operative	sigurime	Transferta	Investime	Totale
PBA 2021	1,481	2,429	3,940		7,850
Plani fillestar 2021	1,481	3,321	5,631	1,665	12,098
Plani i rishikuar 2021	1,653	2,413	4,686	1,665	10,417
Realizimi viti 2021	1,451	497	3,743	-	5,691
% e realizimit	87.8%	20.6%	79.9%	0.0%	54.6%



Realizimi i shpenzimeve korente dhe kapitale për këtë program krahasuar me planifikimin është në total 54.6% sipas zërave më poshtë:

Shpenzime korente	65.0%
Shpenzime kapitale	0.0%



Faktorët që kanë ndikuar në mosrealizimin e fondeve të planifikuara

Për sa i përket programit 4130 aktivitetet janë të shtrira në kohë përgjatë vitit kalendarik/ buxhetor dhe kemi aktivitete të cilave i ka kaluar afati dhe nuk janë realizuar. Covid- 19 ka vështirësuar punën në terren dhe aktivitetet në fjalë nuk kanë arritur të përfundohen brenda vitit 2021.

Aneksi nr.4 Raporti i realizimit të objektivave të politikës së programit

Periudha e Raportimit: 01.01.2021-31.12.2021

Kodi i Programit	4130	Emertimi i programit:	Mbeshtetja per zhvillim ekonomik						Komente
Qëllimi 1	Synojmë që zhvillimi lokal i udhëhequr nga komuniteti të mobilizojë dhe të përfshijë komunitetet dhe organizatat lokale për të kontribuar në arritjen e qëllimeve të Strategjisë Europë 2020 për rritje të zgjuar, të qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse, duke nxitur kohezionin territorial dhe duke arritur objektiva të caktuara politikash.								
			Produktet:						
Objektivat e politikës:	Kodi i Produktit	Emertimi i Produktit	Niveli faktik i vitit paraardhes	Niveli i planifikuar ne vitin korent	Niveli i rishikuar ne vitin korent	Niveli faktik ne fund te vitit korent	% e Realizimit te Produktit		
Objektivi 01 Mbështetja për përmirësimin e klimës për zhvillimin e biznesit nëpërmjet ngritjes së strukturave të dedikuara, bashkëpunimit me institucione të specializuara dhe aktorët e interesuar për hartimin e strategjive dhe planeve zhvillimore lokale.	1	Dokumenti i monitorimit të strategjisë së zhvillimit të Bashkisë Shkodër	1	1	1	0	0%	dokument i përvitshem që është realizuar në fund vitit fiskal	
	2	Kapacitete të forcuar të OSHC-ve	9	11	11	24	218%	nga 24 të aplikuar 18 janë projekte fituese po zbatohen në kuadër të (Met. LOD, Programi ReLoad) ku përfshihen dhe shoqatat sportive	
	3	Projekte të aplikuar sipas programeve të financuara nga BE dhe organizata të tjera ndërkombetare	16	20	20	7	35%	7 projekte janë aplikuar në programe të BE,	

		4	Aktivite informuese	42	40	40	42	105%	Janë zhvilluar aktivitetet me tematika të ndryshme duke filluar nga aktivitetet informuese dhe promovuese për politikën e BE-së dhe ditët e BE-së.
		5	Persona të informuar	200	220	220	220	100%	proces që ka vazhduar gjithë vitin
Objektivi O2	Promovimi i produkteve vendore dhe fuqisë së punonjësve të specializuar për tregun lokal, kombëtar dhe ndërkombëtar.	6	Panaire të produkteve dhe shërbimeve të territorit	7	10	10	10	100%	Shpallja e fituesve me Vendim nr. prot 114, datë 07.04.2021; panaire të realizuara sipas kontratave të lidhura
		7	Shërbimi pranë zyrës QKB	1	1	1	1	100%	Jane likuiduar në kohë shpenzimet e parashikuara
Objektivi O3	Hartimi dhe publikimi i materialeve informative dhe promocionale për nxitjen e investimeve vendase dhe të huaja.	8	Publikime & Botime për zhvillim ekonomik	1	1	1	0	0%	nuk është realizuar
Objektivi O4	Nxitja dhe mbështetja e bashkëpunimit të biznesit vendor, nëpërmjet incentivave financiare, për zhvillimin dhe fuqizimin e tyre.	9	Iniciativa të biznesit të mbështetura financiarisht	1	2	2	1	50%	është zbatuar kontrata me zonen BID
		10	Biznese të asistuar për aplikime në programe dhe skema financiare	30	25	25	30	120%	proces që zgjat gjithë vitin, janë asistuar me info mbi skemat e ndryshme financiare të hapura gjatë vitit 2022

ANEKSI nr.3 "Raporti permbledhes i realizimit te treguesve te performances/produkteve te programit"

Emri i Grupit	Bashkia Shkodër	Kodi i Grupit	141
Programi	Mbeshtetja per zhvillim ekonomik	Kodi i Programit	4130

Kodi	Emertimi i Produktit	Njësi matëse	Sasia Faktike (v. 2020)	Shpenzimet (v. 2020)	I		II		III		IV		Luhatjet ne Koston per Njesi			Komente		
					Kosto per Njesi (v. 2020)	Sasia (v. 2021)	Shpenzimet (v. 2021)	Kosto per Njesi (v. 2021)	Sasia e Rishikuar (v. 2021)	Shpenzimet e Rishikuara (v. 2021)	Kosto per Njesi e Rishikuar (v. 2021)	Sasia Faktike (v. 2021)	Shpenzimet Faktike (v. 2021)	Kosto per Njesi Faktike (v. 2021)	V = IV - I		V = IV - II	V = IV - III
1	Dokumenti i monitorimit të strategjisë së zhvillimit të Bashkisë Shkodër	dokumenti	1	0	0	1	0	0	1	0	0	1	0	0	0	0	0	dokumenti i përvitshëm që është realizuar në fund vitit fiskal
2	Kapacitete të forcuara të OSHC-ve	nr OSHC	9	0	0	11	0	0	11	0	0	24	0	0	0	0	18 janë projekte po zbatohen në kuadër të (Met. LOD, Programi	

																		ReLOa d) ku perfshi hen dhe shoqat at sportiv e
3	Projekte të aplikuara sipas programeve të financuara nga BE dhe organizata të tjera ndërkombëtare	numer projektesh	16	83	5	20	1,000	50	20	1,000	50	7	501	72	66	22	22	7 projekt e janë apliku ar në progra me të BE.
4	Aktivitetet informuese	numer aktivitetesh	42	0	0	40	43	1	40	43	1	42	0	0	0	-1	-1	Janë zhvillu ar aktivit eteve me temati ka të ndrysh me duke filluar nga aktivit etet inform uese dhe promo vuese për politik at e BE-së dhe ditët e BE-së.

5	Persona të informuar	nr personash	200	0	0	220	0	0	220	0	0	220	0	0	0	0	0	0	proces që ka vazhduar gjithë vitin
6	Panairë të produkteve dhe shërbimeve të territorit	nr panairësh	7	1,877	268	10	2,440	244	3	2,440	813	10	2,138	214	-54	-30	-600	Shpallja e fituesve me Vendim nr. prot 114, datë 07.04.2021; panairë të realizuara sipas kontratave të lidhura	
7	Shërbimi pranë zyrës QKB	shërbim në kohe	1	1,531	1,531	1	1,567	1,567	1	1,723	1,723	1	1,521	1,521	-10	-46	-202	Jane likuiduar në kohë shpenzimet e parashikuara	
8	Publikime dhe botime	nr botimesh	0	0	0	1	200	200	1	200	200	0	0	0	0	-200	-200	nuk është realizuar	
9	Iniciativa të biznesit të mbështetura financiarisht	numër	1	833	833	2	2,600	1,300	2	3,346	1,673	1	1,531	1,531	698	231	-142	është zbatuar kontrata me zonen BID	

10	Biznese të asistuar për aplikime në programe dhe skema financiare	nr bizne sesh	30	0	0	25	0	0	25	0	0	30	0	0	0	0	0	0	proces që zgjat gjithë vitin, jane asistua r me info mbi skemat e ndrysh me financi are të hapura gjatë vitit 2022
Drejtuesi i Ekipit Menaxhues të Programit		Emri	Ridvan Sokoli		Kryetari i Njësisë së Vetëqev erisjes Vendor e	Emri	Voltana Ademi												
		Firma				Firma													
		Data				Data													

Gjatë 12 mujorit të vitit 2021 është punuar për përmbushjen e objektivave nëpërmjet realizimit të aktiviteteve të parashikuara në Buxhetin e Bashkisë Shkodër për Programin 04130 “Mbështetja për zhvillim ekonomik”

Tabela e produkteve dhe realizimi i tyre nga pikëpamja financiare.

Aktiviteti	Buxheti fillestar në 000/Lekë	Buxheti i rishikuar në 000/Lekë	Realizimi 12-mujori Viti 2021 në 000/Lekë
P04130.O1.A1. Monitorimi dhe Vlerësimi i strategjisë së zhvillimit të Bashkisë Shkodër	-	-	Realizuar
P04130.O1.A3. Vazhdimi i zbatimit të metodologjisë ReLoad si instrument financiar për forcimin e kapaciteteve të OSHC-ve.	-	-	Realizuar
P04130.O1.A4. Pjesëmarrje në programet dhe projektet e financuara nga Bashkimi Europian, Organizata të tjera ndërkombëtare si dhe anëtarësimi në shoqata ndërkombëtare.	1,000	1,000	501
P04130.O1.A5. Organizimi i aktiviteteve informuese dhe promovuese mbi programet dhe projektet e Bashkimit Europian nëpërmjet Këndit të BE Shkodër.	43	43	Realizuar
P04130.O1.A6. Informimi në mënyrë periodike për publikun dhe grupet e tjera të interesit për procesin e Integritimit Evropian, Këndi BE Shkodër.	-	-	Realizuar
P04130.O2.A1. Organizimi i një panairi pune dhe bizneseve në Bashkinë Shkodër	300	300	Realizuar
P04130.O2.A2. Panairi i produkteve agropërpunuese sipas njësive administrative	700	700	698
P04130.O2.A3. Panair i promovimit të vlerave artistiko- kulturore dhe i produkteve të territorit (për Njësitë Administrative)	1,440	1,440	1,440
P04130.O2.A4 Shërbimet e deleguara të QKB	1,567	1,723	1,521
P04130.O3.A2. Publikimi i materialeve promocionale për zonat zhvillimore (për investime vendase dhe të huaja).	200	200	Nuk është realizuar
P04130.O4.A1. Bashkëpunimi me Zonën e përmirësimit të biznesit (BID) në rrugën 13 Dhjetori dhe 28 Nëntori & Të trashëguara	1,600	2,346	1,531
P04130.O4.A2. Mbështetja e iniciativave të reja të zonave tregtare	1,000	1,000	Nuk është realizuar
P04130.O4.A3. Mbështetja dhe lehtësimi i bizneseve për aplikime në programet dhe skema të ndryshme financiare.	-	-	Realizuar
Të Trashëguara	4,249	1,665	-
TOTALI	12,099	10,417	5,691

Përshkrimi i aktiviteteve

P04130.O1.A1. Monitorimi dhe Vlerësimi i strategjisë së zhvillimit të Bashkisë Shkodër

Hartimi i Planit të Përgjithshëm Vendor konsiderohet si një instrument i rëndësishëm për zhvillim, i cili përfshin identifikimin dhe shfrytëzimin kryesisht të burimeve vendore, ideve dhe aftësive për të stimuluar rritjen dhe zhvillimin ekonomik. Ky proces shoqërohet me monitorimin dhe vlerësimin e tij, si mekanizëm tepër i vlefshëm për të treguar nëse burimet në dispozicion janë të mjaftueshme, janë përdorur me efektivitet dhe nëse po bëhet ajo që është planifikuar.

Monitorimi dhe vlerësimi i zbatimit të Planit të Përgjithshëm Vendor bëhet nga Drejtoria e Planifikimit Strategjik dhe Përmirësimit të Klimës së Biznesit. Monitorimi është realizuar në fund të vitit fiskal në zbatim të Planit të Përgjithshëm Vendor. Monitorimi i zbatimit të strategjisë territoriale Shkodër përbëhet nga dy pjesë. Njëra është monitorimi i ecurisë së zbatimit. Tjetra është monitorimi i rezultateve të zbatimit. Plani i Përgjithshëm Vendor i Bashkisë Shkodër përbëhet nga Vizioni, 5 objektiva strategjike, 28 programe strategjike dhe 198 projekte. Aktualisht programi buxhetor afatmesëm i Bashkisë Shkodër është instrumenti kryesor i financimit të planit të investimeve. Ndërsa disa nga projektet strategjike kanë gjetur mbështetjen financiare të partnerëve ndërkombëtarë të zhvillimit si Bashkimi Europian, Banka Botërore, UNDP, etj.

P04130.O1.A3. Vazhdimi i zbatimit të metodologjisë ReLoad si instrument financiar për forcimin e kapaciteteve të OSHC-ve.

Bashkia Shkodër ka shpallur Thirrjen e hapur për projekt propozime, për Organizatat e Shoqërisë Civile përmes metodologjisë LOD të Programit ReLOaD. Gjatë zhvillimit të procedurës i jemi referuar VKB nr. 69, datë 30.10.2017 për “Miratimin e Memorandumit të Mirëkuptimit ndërmjet Programit për Zhvillim të Kombeve të Bashkuara dhe Bashkisë Shkodër” si dhe miratimin e metodologjisë LOD për financimin e organizatave të shoqërisë civile”, Miratimin e shpalljes së Thirrjes së hapur publike për organizatat e shoqërisë civile nr. 1480/33, datë 30.04.2021. Prioritetet u propozuan nga Bashkia në përputhje me dokumentet strategjike që disponon. Nëpërmjet kësaj thirrjeje publike është synuar forcimi i partneritetit ndërmjet organizatave të shoqërisë civile dhe njërive të pushtetit vendor. Në këtë kuadër janë ftuar të gjitha OSHC- të e interesuara të cilat kanë dorëzuar projekt- propozime, të cilat duhet të adresojnë prioritetet strategjike të Bashkisë Shkodër. Në këtë thirrje aplikuan 9 OSHC nga të cilat 7 aplikime u shpallën fituese.

P04130.O1.A4. Pjesëmarrje në programet dhe projektet e financuara nga Bashkimi Europian dhe Organizata të tjera ndërkombëtare.

Procesi i integritit evropian është sfida dhe prioriteti kryesor për Shqipërinë, ku padyshim një rol të rëndësishëm në këtë proces luan edhe qeverisja vendore. Mjetet me të cilat BE mbështet Shqipërinë në rrugën e saj drejt anëtarësimit janë programet e BE-së. Në këtë kuadër njësitë e qeverisjes vendore kanë të drejtë të përfitojnë nga financimi i fondeve të BE-së. Shkalla e përfitimit të fondeve të BE- së në nivel vendor varet nga angazhimi i njërive vendore në këtë proces. Prandaj

është me shumë rëndësi që qeverisja vendore të fokusojë prioritetet e saj edhe në drejtim të forcimit të bashkëpunimit rajonal dhe ndër-rajonal duke aplikuar në programe të ndryshme të BE- së.

Duke marrë në konsideratë rëndësinë e bashkëpunimit ndërkufitar dhe rajonal, Bashkia Shkodër shpreh angazhimin e saj për marrjen pjesë në Programet e BE- së me qëllim rritjen e shërbimeve publike për qytetarët me standarde të përafuara evropiane. Konkretisht Bashkia Shkodër është aplikuese në disa nga programet e financuara nga BE dhe një ndër specifikat e thirrjeve për projekte është edhe bashkëfinancimi. Kështu për projektet e shpallura fituese nga Bashkimi Evropian, Bashkia Shkodër merr përsipër bashkëfinancimin e projekteve fituese sipas specifikave të programeve të BE- së. Në këtë kuadër lind e nevojshme parashikimi i një fondi për bashkëfinancim në zërat e buxhetit vjetor dhe afatmesëm.

P04130.O1.A5. Organizimi i aktiviteteve informuese dhe promovuese mbi programet dhe projektet e Bashkimit Evropian nëpërmjet Këndit të BE Shkodër

Në zbatim të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 450, datë 26.7.2018 “Për bashkërendimin dhe koordinimin e procesit të integritit evropian, ndërmjet qeverisjes qendrore dhe njësisve të vetëqeverisjes vendore”, janë krijuar strukturat e Integritit Evropian në 61 Bashkitë e Shqipërisë. Në këtë kuadër është krijuar struktura edhe në Bashkinë Shkodër, misioni i secilës është të mbështesë dhe koordinojë strukturat e Bashkisë, në realizimin e reformave për përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga procesi i Integritit Evropian. Të sigurojë programimin dhe zbatimin me efikasitet të gjithë financimeve në kuadër të programeve të BE-së dhe donatorëve të tjerë, nga të cilat përfiton Bashkia.

Një ndër objektivat e Bashkisë Shkodër është shndërrimi i saj në një aktor të rëndësishëm të bashkëpunimit ndërkufitar, me të gjithë partnerët vendor, të Ballkanit Perëndimor, evropianë dhe nga vende të tjera. Kjo lidhet jo vetëm me bashkërendimin e aksioneve dhe kontributeve në përputhje me synimet dhe interesat e partnerëve rajonalë dhe të komunitetit por edhe me promovimin e vlerave natyrore dhe kulturore të territorit.

Parë në këtë kontekst, Bashkia Shkodër vlerëson çdo bashkëpunim të mundshëm me partnerët tanë evropian dhe jo vetëm, me qëllim zhvillimin e qëndrueshëm të bashkëpunimit rajonal. Prandaj me qëllim mbështetjen e kohezionit territorial midis partnerëve të huaj dhe vendase dhe në veçanti nxitjen e iniciativave të bashkëpunimit ndërkufitar në mbrojtjen dhe vlerësimin e mjedisit, Bashkia Shkodër ndër të tjera ka organizuar aktivitetin “Një udhëtim përmes biodiversitetit dhe mrekullive natyrore të Shqipërisë- Snap in Flight”. Ky aktivitet ka për qëllim promovimin e biodiversitetit dhe atraksioneve të turizmit të liqenit të Shkodrës, përmes fotografimit të florës dhe faunës së Liqenit duke sjellë së bashku fotografë të botës së egër nga vende të ndryshme të BE (Itali, Francë, Greqi, Gjermani, Zvicër, Hungari, Finlandë, Izrael, etj) dhe Ballkanin Perëndimor (Serbia, Bullgaria, Maqedonia e Veriut, Mali i Zi, Kosova dhe Shqipëria).

Gjithashtu është bërë likuidimi i tarifës së pranimit për anëtarësimin e Bashkisë Shkodër në Forumin e qyteteve të Adriatikut dhe Jonit (FAIC).

P04130.O1.A6. Informimi në mënyrë periodike për publikun dhe grupet e tjera të interesit për procesin e Integrimit Evropian, Këndi BE Shkodër

Projekti “Bashkitë për në Evropë”, i mbështetur nga Bashkimi Evropian, synon fuqizimin e pushtetit vendor në Shqipëri gjatë procesit të integrimit. Në kuadër të këtij projekti është ngritur zyra e çështjeve të BE- së pranë 61 bashkive. Kjo zyrë luan një rol të rëndësishëm në promovimin e parimeve të BE- së në nivel vendor si dhe shërben si një urë për absorbimin e fondeve/ programeve të BE. Këtu bëhet informimi në mënyrë periodike i publikut dhe i grupeve të tjera të interesit për procesin e integrimit evropian, për politikatat e BE-së dhe mundësitë për përfitim nga asistenca e Bashkimit Evropian, nëpërmjet këndit të Bashkimit Evropian, i cili është krijuar dhe funksionon brenda Bashkisë.

Në këtë kuadër zyra e çështjeve të BE-së Shkodër ka siguruar dhënien e informacionit të nevojshëm për publikun dhe grupet e tjera të interesit për procesin e integrimit evropian, për politikatat e BE-së dhe mundësitë për përfitim nga asistenca e Bashkimit Evropian. Janë realizuar 40 aktivitete informuese të organizuara, nëpërmjet të cilave janë informuar rreth 220 persona. Njëkohësisht është bërë shpërndarja e materialeve promovuese mbi fondet, programet dhe projektet e BE- së. Përgjithësisht kërkesat e qytetarëve në këtë periudhë kanë qenë të lidhura me mundësitë e financimit të projekteve.

P04130.O2.A1. Organizimi i një panairi pune dhe bizneseve në Bashkinë Shkodër

Rajoni i Shkodrës, është i prekur nga një numër i lartë i të papunëve. Në Universitetin e Shkodrës si dhe në shkollat profesionale çdo vit diplomohen një numër i konsiderueshëm studentësh, të cilët kanë vështirësi të integrohen në tregun e punës. Nga ana tjetër në Bashkinë e Shkodrës operojnë një numër relativisht i mirë i aktiviteteve ekonomike të sektorëve të ndryshëm të cilët gjithashtu herë pas here kanë vështirësi në gjetjen e punonjësve e sidomos të atyre të kualifikuar. Kjo gjë ndodh nga mungesa e informacionit si për vendet e punës së disponueshme por gjithashtu edhe për mundësitë që kanë bizneset për të punësuar punonjës të kualifikuar. Për këtë arsye, Bashkia Shkodër realizon panairin e punës me pjesëmarrjen e aktorëve të rëndësishëm në këtë proces ku mund të përmendim Zyrën Rajonale të Punësimit Shkodër, Qendrën e Formimit Profesional, Universitetin e Shkodrës, shkollat e mesme profesionale dhe bizneset që kanë aktivitet në Shkodër e më gjerë. Ky panair synon të kontribuojë në zhvillimin e qëndrueshëm të tregut të punës, nëpërmjet forcimit të bashkëpunimit dhe shkëmbimit midis autoriteteve vendore, institucioneve, partnerëve socialë dhe të sektorit privat, në një partneritet lokal të qëndrueshëm për punësim. Ky aktivitet është realizuar, në bashkëpunim me Universitetin e Shkodrës, në pranverën e këtij viti.

P04130.O2.A2. Panairi i produkteve agropërpunuese sipas njësive administrative

Bashkia Shkodër për shkak të pozicionimit gjeografik dhe resurseve natyrore që disponon, ka potenciale të mëdha për zhvillimin ekonomik. Baza ekonomike është blegtoria, sidomos në zonën malore të saj, ndërsa në zonën fushore përparësi ka bujqësia, kryesisht drithërat e bukës. Përveç tyre, produkte të tjera tipike të zonës janë të lidhura me vreshtarinë, ullishtat dhe frutat/ perimet. Po ashtu, afërsia me liqenin ka nxitur edhe peshkimin. Sektori i agropërpunimit është një ndër

sektorët e ekonomisë e cila gërsheton potencialet e burimeve natyrore, pozitën gjeografike, traditën e rajonit por gjithashtu edhe interesin në rritje të aktorëve dhe partnerëve të rëndësishëm për rajonin. Si e tillë vërehet prania e bizneseve agro- përpunuese të lidhura drejtpërdrejt me tregtinë. Por përtej mundësive që vendi ofron ky sektor ndeshet me disa problematika që kanë të bëjnë kryesisht me investimet për modernizimin e teknologjisë, standardizimin, konkurrueshmërinë, nxitjen e promovimit të markave rajonale, kapacitetet menaxhuese etj. Në këtë kuadër me qëllim zhvillimin e biznesit të vogël nëpërmjet veprimtarive nxitëse, Bashkia ka parashikuar organizimin e panairove të produkteve agro- përpunuese. Në këtë panair janë prezantuar të gjitha njësitë administrative të Bashkisë Shkodër me produktet vendase, me pasuritë e tyre kulturore dhe ushqimin tradicional. Ky aktivitet është zhvilluar në fund të muajit tetor, dhe me vendim Nr.114 datë 7.4.2021 është bërë shpallja e projekteve fituese.

Kjo traditë do të vazhdojë edhe në vitet e ardhshme me më shumë prodhues e më shumë prodhime vendase pasi është gjithmonë në rritje edhe kërkesa e fermerëve për të marrë pjesë në panair.

P04130.O2.A3. Panair i promovimit të vlerave dhe produkteve të territorit (për Njësitë Administrative)

Territori i ri i Bashkisë Shkodër, si nga morfologjia e territorit dhe burimet natyrore ashtu dhe nga mënyra e zhvillimit është një territor shumë i larmishëm dhe dinamik. Si i tillë përveç potencialeve të shumta natyrore, paraqet edhe potenciale të trashëgimisë materiale dhe shpirtërore të zonës. Qyteti, rrethinat dhe malësitë e Bashkisë Shkodër janë dalluar për prodhimet artizanale si punimet prej thupre, bakri, argjendi e druri, qëndisimat, qilimat, etj. Gjithashtu e gjithë zona është karakterizuar nga veshje tradicionale funksionale për çdo ceremoni dhe për jetën e përditshme. Një larmi tejet të madhe edhe në shkallë vendi paraqet Bashkia për sa i përket pasqyrimin të shpirtit njerëzor përmes këngës. Po ashtu Bashkia e re është dalluar për një numër të madh prodhimesh tradicionale me bazë burimet dhe kushtet natyrore të saj. Me vendim Nr. 114 datë 7.4.2021 janë shpallur projektet fituese. Këtë vit promovimi i njësisve administrative është rikonceptuar nëpërmjet një fushate promovionale për promovimin e traditës, kulturës si dhe të produkteve vendase të njësisve administrative duke qenë kështu dhe një mbështetje për bizneset e zonës.

P04130.O2.A4 Shërbimet e deleguara të QKB

Pagesa e punonjësve të QKB pranë institucionit tonë bëhet në mbështetje të nenit 8, pika 1 dhe 2; dhe nenit 9, pika 2, të ligjit nr 131/2015 “Për Qendrën Kombëtare të Biznesit”.

Në zbatim ligjit, Bashkia Shkodër ka lidhur me QKB- në, marrëveshjen e bashkëpunimit nr 6074 datë 25.05.2016 ku në nenin 5 pika 1 përcaktohet:

“Niveli i pagave dhe shpërblimeve të nëpunësve në sportelet e shërbimit, pranë njësisë së qeverisjes vendore, përcaktohen me vendim të Këshillit Bashkiak duke marrë në konsideratë fondin e deleguar nga QKB– ja për këtë qëllim.

Këto funksione të deleguara tashmë kryhen nga Bashkia dhe gjithashtu me Vendimin e Këshillit Bashkiak “Për miratimin e nivelit të pagave të funksionarëve të zgjedhur ose të emëruar të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativë të Bashkisë Shkodër dhe të institucioneve të varësisë”. Janë përcaktuar disa nivele page në kategorinë e pozicionit ku paguhen nëpunësit e sporteleve të shërbimit të QKB- së.

Aktualisht janë dy punonjës që ofrojnë shërbimin pranë zyrës së QKB në Bashkinë Shkodër. Përmirësimi i vazhdueshëm i shërbimit është një nga pikat e forta të QKB dega Shkodër. Sot cdo kërkesë procesohet brenda 24 orëve dhe ka përfunduar procesi i likuidimit të pagave dhe sigurimeve shoqërore për muajt Janar– Dhjetor për vitin 2021.

P04130.O3.A2 Publikimi i materialeve promociionale për zonat zhvillimore (për investime vendase dhe të huaja)

Bashkia Shkodër ka tashmë një shtrirje territoriale të madhe dhe gjithashtu ka edhe detyrën e shpërndarjes së zhvillimit ekonomik në të gjithë territorin. Për të arritur këtë qëllim duhet bërë një klasifikim i zonave zhvillimore sipas pozicioneve përkatëse gjeografike dhe sipas sektorëve të zhvillimit. Një pikë e rëndësishme është seleksionimi i industrive dhe funksioneve ekonomike të zonave zhvillimore, duke zgjedhur industri të lehtë, zhvillim turizmi apo bujqësi që është jo-dëmtuese për mjedisin apo duke i bashkuar me industri të tjera plotësuese ose që ndajnë karakteristika të përbashkëta dhe mund të funksionojnë së bashku. Promovimi i zhvillimit në zonat ekonomike dhe në fashat e zhvillimit ekonomik të përcaktuara në strategjinë territoriale të Bashkisë Shkodër të cilat janë:

- Zona e ish- fushës së aviacionit- zonë e lirë ekonomike
- Ish- zonës industriale Shkodër (rikualifikim i Broënfield)
- Bypassi në një itinerar natyror
- Aksit Ura e Bahçallëkut- Bërdicë si aks ekonomik
- Fashat ekonomike: Bashkinë Shkodër Aksi Shkodër- Koplík
- Aksit rrugor Shkodër - Ana e Malit - Muriqan
- Fashat ekonomike - Aksi Shkodër - Vau i Dejës
- Rruga Shirokë- Zogaj
- Zona e Qendrës Shkodër
- Zona pranë By- Pass Perëndimor
- Terminali ujq
- Zona Velipojë- Rrjoll
- Etj.

Një nga masat e Bashkisë për të krijuar mundësinë e zhvillimit të këtyre zonave do të jetë edhe promovimi dhe tërheqja e investitorëve vendas dhe të huaj.

Përmes bashkëpunimit me drejtorinë e Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit dhe drejtorinë Juridike do të detajohen rregulloret dhe procedurat për zhvillimin e këtyre zonave. Publikimi i materialeve promociionale për zonat zhvillimore, nuk është realizuar pasi nuk janë bërë disa nga PDV (Planet e Detajuara Vendore).

P04130.O4.A1. Bashkëpunimi me Zonën e përmirësimit të biznesit (BID) në rrugën 13 Dhjetori dhe 28 Nëntori

Qëllimi i këtij bashkëpunimi është mbështetja e biznesit të vogël për t'u konsoliduar, nëpërmjet përmirësimit të cilësisë së shërbimeve të zonës së përmirësimit të biznesit, për ta kthyer atë në një vend tërheqës për vizitorin. Nga ky bashkëpunim përfitojnë rreth 120 biznese. Në zbatim të programit të bashkëpunimit, me qëllim zhvillimin dhe përmirësimin e klimës së biznesit në zonë është lidhur marrëveshja për vitin 2021 e cila është realizuar.

P04130.O4.A2. Mbështetja e iniciativave të reja të Zonave Tregtare

Një ndër prioritetet e Bashkisë Shkodër është zhvillimi i qëndrueshëm ekonomik dhe përmirësimi i klimës së biznesit në territorin e saj. Për këtë qëllim, Bashkia do të vazhdojë të mbështesë iniciativa të reja për zhvillimin e biznesit, në fusha që lidhen me vizionin e zhvillimit të saj. Iniciativa të tilla kanë të bëjnë me krijimin e lehtësirave infrastrukturore të nevojshme për zhvillimin e zonave të reja tregtare si dhe nxitjen e kulturës së sipërmarrjes duke ju përgjigjur zhvillimeve të reja në kohë dhe në mënyrë krijuese. Konkretizimi i ndërhyrjeve në zonat karakteristike të Shkodrës të cilat kanë një potencial të lartë për kthimin e tyre në atraksione turistike dhe integrimi i tyre me ofertën turistike, përfaqësojnë një potencial të rëndësishëm për zhvillimin e mëtejshëm të saj. Trashëgimia dhe kultura identifikohen si elemente të forta territoriale dhe Shkodra është një ndër destinacionet më të rëndësishme në Shqipëri. Prandaj është me shumë interes krijimi i një mjedisi të përshtatshëm për tërheqjen e investimeve në zonat e përmirësimit të biznesit dhe organizimin e veprimtarive kulturore- artistike në mënyrë që të rrisim numrin e vizitorëve dhe kohën e qëndrimit jo vetëm përgjatë sezonit veror, por gjatë gjithë vitit. Nisma të tilla nuk kanë munguar edhe më përpara, mjafton të përmendim projektin “BID Shkodra” përgjatë rrugëve “13 Dhjetori”, “28 Nëntori” dhe “Kolë Idromeno” por është e nevojshme shtrirja e tyre edhe në zona të tjera historike të Shkodrës, ku pa dyshim Shkodrës nuk i mungojnë. Të tilla mbështetje do të ndikojnë në përmirësimin e aksesit ndaj shërbimeve bazë, gjenerimin e të ardhurave dhe krijimin e vendeve të lira të punës.

P04130.O4.A3. Mbështetja dhe lehtësimi i bizneseve për aplikime në programet dhe skema të ndryshme financiare.

Bizneset ekzistuese në Shkodër kanë hasur vështirësi për të aplikuar në programet dhe në skemat e ndryshme financiare qeveritare. Kjo ka ardhur si rezultat i mungesës së informacionit dhe gjithashtu vështirësive që hasin në plotësimin e dokumantacionit ligjor, sipas udhëzimeve të përcaktuara nga ministria e linjës apo edhe nga rregulloret e programeve të ndryshme. Programet mbështetëse dhe instrumentat financiare qeveritare janë një mënyrë e mirë për rritjen e konkurrencës në sektorin e bujqësisë dhe industrisë ushqimore, në rritjen e qëndrueshmërisë ekonomike të zonave malore të disavantazuara, rritjen e ekonomisë lokale nga njëra anë dhe nga ana tjetër përforcimi i marrëdhënieve ekonomike me Bashkimin Europian, mbrojtjen e mjedisit, nxitjen e transportit të qëndrueshëm dhe të infrastrukturës publike etj. Në këtë kuadër Bashkia Shkodër jep asistencën e saj për plotësimin e dokumentacionit për aplikim për ato subjekte që kanë nevojë si dhe i mban të informuar ato për thirrje të ndryshme që hapen gjatë vitit.

Programi 04160: Shërbimi i tregjeve, akreditimi dhe inspektimi

Realizimi i qëllimit dhe objektivave të politikës së programit

Bashkia Shkodër gjatë vitit 2021 në programin 04160 “Shërbimi i tregjeve, akreditimi dhe inspektimi” ka fokusuar përpjekjet e saj në një funksion zhvillimi


- Shërbimi i tregjeve, akreditimi dhe inspektimi

Objektivat për përmbushjen e këtyre funksioneve për 12- mujin e vitit 2021 janë:

O1. Sistemimi dhe ngritja e tregjeve të shitjes me shumicë dhe pakicë në territorin e Shkodrës

Realizimi i buxhetit të planifikuar për programin :Shërbimi i tregjeve, akreditimi dhe inspektimi

Programi 04160	Shpenzime operative	Investime	Totali
PBA 2021	500	962	1,462
Plani fillestar 2021	1,856	962	2,818
Plani i rishikuar 2021	515	962	1,477
Realizimi viti 2021	126	-	126
% e realizimit	24.5%	0.0%	8.5%



Realizimi i shpenzimeve korente dhe kapitale për këtë program krahasuar me planifikimin është në total 8.5 % sipas zërave më poshtë:

Shpenzime korente	24.5%
Shpenzime kapitale	0.0%



Faktorët që kanë ndikuar në mosrealizimin e fondeve të planifikuara

Përsa i përket programit 04160 aktivitetet janë të shtrira në kohë përgjatë vitit kalendarik/ buxhetor dhe kemi aktivitete të cilat nuk janë realizuar. Covid- 19 ka vështirësuar punën në terren. Përsa i përket zërit të investimeve është hasur vështirësia në identifikimin e vendit të duhur për të bërë projektimin e planifikuar.

Realizimi i tregesve të performancës

Anëksi nr.4 Raporti i realizimit të objektivave të politikës së programit

Periudha e Raportimit: 01.01.2021-31.12.2021

Kodi i Programit	4160	Emertimi i programit:	Shërbimet e tregjeve, akreditimi dhe inspektimi						Komente
Qellimi 1	Synojmë që zhvillimi lokal i udhëhequr nga komuniteti të mobilizojë dhe të përfshijë komunitetet dhe organizatat lokale për të kontribuar në arritjen e qëllimeve të Strategjisë Europë 2020 për rritje të zgjuar, të qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse, duke nxitur kohezionin territorial dhe duke arritur objektiva të caktuara politikash.							
			**Treguesit e performancës/Produktet:					
Objektivat e politikës:	Kodi i Treguesit te Performances/Produktit	Emertimi i Treguesit te Performances***/Produktit	Niveli faktik i vitit paraardhes	Niveli i planifikuar ne vitin korent	Niveli i rishikuar ne vitin korent	Niveli faktik ne fund te vitit korent	% e Realizimit te Treguesit te Performances/Produktit		
Objektivi O1	Sistemimi dhe ngritja e tregjeve të shitjes me shumicë dhe pakicë në territorin e Shkodrës	1	Mirembajtja e tregjeve ekzistuese	1	1	1	1	100%	Jane likujduar ne kohe shpenzimet e parashikuara
		2	Ngritja e rrjetit te tregjeve	0	1	1	0	0%	Nuk eshte realizuar

Realizimi i produkteve

Anëksi nr.3 "Raporti përmbledhës i realizimit të tregësve të performancës/produkteve të programit"

Programi	Shërbimet e tregjeve, akreditimi dhe inspektimi	Kodi i Programit	4160
----------	---	------------------	------

Kodi	Emertimi i produktit	Njësia matëse	Sasia Faktike (v. 2020)	Shpenzimet (v. 2020)	I			II			III			IV			Luhatjet ne Koston per Njesi			Komente
					Kosto per Njesi (v. 2020)	Sasia (v. 2021)	Shpenzimet (v. 2021)	Kosto per Njesi (v. 2021)	Sasia Rishikuar (v. 2021)	Shpenzimet e Rishikuara (v. 2021)	Kosto per Njesi e Rishikuar (v. 2021)	Sasia Faktike (v. 2021)	Shpenzimet Faktike (v. 2021)	Kosto per Njesi Faktike (v. 2021)	V = IV - I	V = IV - II	V = IV - III			
1	Mirembajtja e tregjeve ekzistuese	nr tregjesh	1	144	144	1	500	500	1	515	515	1	126	126	-18	-374	-389	Jane likujduar ne kohe shpenzimet utilitare te parashikuara		
2	Ngritja e rrjetit te tregjeve	vlera investimit/treg	0	0	#DIV/0!	1	962	962	1	962	962	0	0	#DIV/0!	#DIV/0!	#DIV/0!	#DIV/0!	Nuk eshte realizuar		

Gjatë vitit 2021 është punuar për përmbushjen e objektivave nëpërmjet realizimit të aktiviteteve të parashikuara në Buxhetin e Bashkisë Shkodër për Programin 04160 Shërbimi i tregjeve, akreditimi dhe inspektimi.

Tabela e produkteve dhe realizimi i tyre nga pikpamja financiare.

Aktiviteti	Buxheti fillestar në 000/Lekë	Buxheti i rishikuar në 000/Lekë	Realizimi 12-mujori Viti 2021 në 000/Lekë
P04160.O1.A1. Mirëmbajtje e tregjeve ekzistuese	500	515	77
P04160.O1.A2. Tregu rajonal i peshkut	962	962	Nuk është realizuar
Të Trashëguara	1,356		
TOTALI	2,818	1,477	77

P04160.O1.A1. Mirëmbajtje e tregjeve ekzistuese

Tregjet ekzistuese dhe ato të reja që do ndërtohen e kanë të domosdoshme mirëmbajtjen e tyre sepse ato amortizohen. Më shumë duhet të bëhet në drejtim të përmirësimit të ambienteve fizike të tregjeve duke parashikuar riparime në infrastrukturën e tezgave, banakëve, lyerje. Mirëmbajtje të hapësirave për automjetët dhe këmbësorët gjithashtu duhen parashikuar mirëmbajtje të vazhdueshme në banjo publike, elektricitet, ujë etj. Riparime në ambientet e magazinimit të mallit etj. i njëjti model mirëmbajtjeje duhet të funksionojë pastaj edhe për tregjet e reja që do ndërtohen, në mënyrë që të qëndrojnë përherë brenda standarteve të mira të tregtimit. Për këtë arsye është planifikuar edhe aktiviteti në fjalë, i cili është i shtrirë edhe në vitet në vazhdim. Konkretisht këtë vit me buxhetin e programit 04160 janë likuiduar cdo muaj detyrimet e energjisë elektrike si dhe gjatë vitit nuk është kryer asnjë riparim, pasi nuk është paraqitur asnjë kërkesë për mirëmbajtjen e vend- tregtimeve të tregut të ri.

P04160.O1.A2. Tregu rajonal i peshkut

Nga vlerësimi i interesit dhe studimi i fizibilitetit për ndërtimin e tregjeve del i domosdoshëm ndërtimi i strukturave të reja për tregtim të produkteve të akuakulturës.

Bashkia Shkodër duke qenë një zonë bregdetare dhe liqenore njëkohësisht, e ka të domosdoshëm ndërtimin e një tregu rajonal peshku. Një treg sipas standarteve higjeno- sanitare, me tenda, me banakë për tregtimin e peshkut me higjienë. Të ketë dhe kushte frigoriferike për ruajtjen e peshkut të vecantë që nuk vjen gjallë tek ne në treg. Të ndërtohen basene të vegjël për mbajtjen e peshkut që tregtohet i gjallë. Të ketë elektricitet, ujë të pijshëm, sistem të rregullt kanalizimesh për qarkullimin e ujit gjithashtu dhe një vend të vecantë për grumbullimin e mbeturinave. Tregu të ketë shërbime të domosdoshme, hapësira me mjaftueshmëri për lëvizjen e automjeteve dhe për parkimin e tyre. Ndërtimi i tregut rajonal është një proces kompleks që kërkon investime kapitale të konsiderueshme. Ai duhet të mbështetet tek një studim në lidhje me kërkesat e përcaktuara qysh më parë në lidhje me ambientet dhe tek një vlerësim i plotë financiar. Përdoruesit e këtyre

ambienteve dhe kushteve për funksionimin e strukturave duhet të përfshihen në procesin e projektimit qysh në fillim. Kjo kërkon konsultime dhe një fushatë ndërgjegjësimit me furnizuesit, transportuesit, tregtarët, punonjësit e tregut dhe autoritetet lokale.

Pikërisht në kuadër të ndërhyrjeve të Bashkisë Shkodër për zhvillimin ekonomik duhet bërë planifikim për ndërtimin e tregut rajonal të peshkut për të zhvilluar tregti sipas formave të standartizuara. Ndërtimi i tregut rajonal të peshkut ku shërbimi dhe kontrolli nga ana e institucioneve janë më efektive, është një hap i nevojshëm që duhet ndërmarrë në mënyrë që të kemi një integrim dhe standartizim të kësaj ekonomie informale me sistemin ekonomik të Bashkisë Shkodër.

Për të përmbushur këtë qëllim është planifikuar që këtë vit të hartojmë projektin teknik për ndërtimin e tregut rajonal të peshkut. Me gjithë përpjekjet tona, meqenëse nuk është gjetur lokacioni i përshtatshëm për ndërtimin e tregut rajonal të peshkut sipas standardeve dhe kushteve të sipërpërmendura, ka sjellë mos hartimin e projektit teknik.

Programi 04220: Shërbimet bujqësore, inspektimi, siguria ushqimore dhe mbrojtja e konsumatorëve

Ky program përfshin institucionet:

1. Drejtoria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Trajtimit të AMTP-ve

Realizimi i qëllimit dhe objektivave të politikës së programit:

Qëllimi i programit të shërbimeve bujqësore është:

P04520.O3.A73. Sistemim - Asfaltim i rrugës Rragam – Sheldi, (Loti 3).(Investim në proçes nga viti 2020) & te trashaguara	2,655	2,934	2,934	Realizuar
P04520.O3.A74. Sistemim - Asfaltim i rrugëve të lagjeve, fshatit Juban (Rruga “Rragame”)(Investim në proçes nga viti 2020) & te trashaguara	4,665	10,210	9,341	Realizuar
P04520.O3.A76.Sistemi Asfaltim Rruga e Gështenjave Rrenc, Guri i Zi	1,206	1,206	1,181	Realizuar

P04520.O3.A78. Sistemim - Asfaltim i rruges Vukatanë – Guri i Kuq, (Loti 2).	2,000	2,000	1,955	Realizuar
P04520.O3.A79. Sistemim asfaltim rruga Qender Mes – Kullaj (Investim në proces nga viti 2019)& te trasheguara	4,301	4,325	4,300	Realizuar
P04520.O3.A80. Sistemim asfaltim rruga Qender Mes – Kullaj, faza II (Investim në proces nga viti 2020) & te trasheguara	3,000	10,394	9,362	Realizuar
P04520.O3.A82. Sistemim asfaltim rruga Qender Boks – Ura e Mesit	3,745	3,745	0	E perealizuar
P04520.O3.A83. Sistemim asfaltim rruga Qender Mes – Kullaj faza III,	1,995	1,995	0	Ne proces
P 04520.O3.A87 Rikonstruksion Rrugë (Investime të pa detajuara)" këto fonde të perdoren për investime të paplanifikuara në projekte sipas PBA 2021 - 2023	0	24	0	E palikuiduar
P 04520.O3.A87.1 Kontrate kolKol SARR Shtoj i Ri - Grude e Re (TRASHEGUARA)	0	27	0	E palikuiduar
P 04520.O3.A87.2 Kontrate mbikqyrje Sup SARR Bardhaj Koder II (TRASHEGUARA)	0	48	0	E palikuiduar
P 04520.O3.A87.3 Shpronësime (TRASHEGUARA)	0	23,122	398	Ne proces
P 04520.O3.A87.4 Kontrate kol Kol SARR Bardhaj Koder II (TRASHEGUARA)	0	15	0	E palikuiduar
P 04520.O3.A87.5 Kontrate Kolaudimi Kol Investim Gjelberim (TRASHEGUARA)	0	15	0	E palikuiduar
P 04520.O3.A87.6 Kontrate Kolaudimi Kol SARR Dobraq-Rus II (TRASHEGUARA)	0	20	0	E palikuiduar
P 04520.O3.A87.7 Kontrate Kol SARR Grude Vinoteke (TRASHEGUARA)	0	84	0	E palikuiduar
P 04520.O3.A87.8 Kontrate mbikqyrje SARR RR,Na - Golem (TRASHEGUARA)	0	250	0	E palikuiduar

P 04520.O3.A87.9 Kontrate Kol SARR RR,Na - Golem (TRASHEGUARA)	0	34	0	E palikuiduar
P 04520.O3.A87.10 Kontrate kolaudimi Kol SARR Bardhaj Koder i (TRASHEGUARA)	0	16	0	E palikuiduar
P 04520.O3.A87.11 Rikonstruksion Rruga Gjergj Jakin Berdice e Siperme,rruga e Palokajve Berdice e Madhe (TRASHEGUARA)	0	7	0	E palikuiduar
P 04520.O3.A87.12 Sistemim asfaltim rruga permes fshatit Ganjolle (TRASHEGUARA)	0	8	0	E palikuiduar
P 04520.O3.A87.13 Rikonstruksion rruga "Myzyrit" (TRASHEGUARA)	0	2,312	2,303	Realizuar
P 04520.O3.A87.14 Rikonstruksion rruga "Imzot Zef Simoni" (TRASHEGUARA)	0	3,255	3,241	Realizuar
P 04520.O3.A87.15 Sistemim asfaltim rruga Drini në Zues (TRASHEGUARA)	0	679	666	Realizuar
P 04520.O3.A87.16 Supervizim Rr.Pjeter Gjoka (TRASHEGUARA)	0	11	0	E palikuiduar
P 04520.O3.A87.17 Kontrate shtese Bardhaj koder II 20% (TRASHEGUARA)	0	1,109	0	E palikuiduar
P 04520.O3.A88 Sistemim asfaltim rruga Varrezat e Deshmorev e - Bardhaj	0	10,170	0	Ne proces
P 04520.O3.A89 Sistemim asfaltim dhe punime mbrojtese ne segmentin Ura Bardhaj - Shkolla Bardhaj" faza II	0	6,700	0	Ne proces
P 04520.O3.A90 Rikonstruksion rruga "Bajri"	0	7,961	0	Ne proces
04520 Rrjeti rrugor	332,532	544,927	386,652	
P04520.O4.A1.Projektim Rikonstruksion rruge Shkoder Qender	3,262	3,262	2,820	Realizuar
P04520.O4.A2.Projektim Rikualifikim Urban blloqe Shkoder Qender	591	591	496	Realizuar
P04520.O4.A3. Projekti PARK4SUMP & te trasheguara	758	2,527	0	Ne proces

P04520.O4.A4. Projektim Rehabilitim, shtrim dhe asfaltim i rrugeve ne Njesi Administrative	2,303	2,303	1,982	Realizuar
P 04520.O4.A4.1 Studim Projektim Rikonstruksion rruga memorandumi i Greces (TRASHEGUARA)	0	70	0	E palikuiduar
P 04520.O4.A4.2 Studime dhe projektme ne bashkefinancim (TRASHEGUARA)	0	1,070	30	Ne proces
04520 Studime për rrugët	6,914	9,823	5,328	
04520 Rrjeti rrugor rural	339,446	554,750	391,980	
Të trashëguara	196,022	5,202	-	
Totali	535,468	559,952	391,980	

Programi 04570: Transporti publik dhe lëvizshmëria

Ky program përfshin institucionin e Bashkisë

Realizimi i qëllimit dhe objektivave të politikës së programit

-Qëllimi i programit të Transportit publik është:

Për të favorizuar përdorimin e rrugës nga këmbësorët dhe biçikletat, si dhe për të promovuar njëkulturë të re për përdorimin e mjeteve të transportit publik ne do të përcaktojmë zonat me shpejtësi të limituar 30 km /orë.

-Objektivat e programit buxhetor për përmbushjen e këtij qëllimi për 12-mujorin 2021 kanë qënë:

O1. Përmirësimi i lëvizshmërisë urbane për një siguri dhe cilësi jetese më të mirë.

Shpenzime për karburant e përfunduar.

Blerje materiale sinjalistike horizontale dhe vertikale e përfunduar.

Shërbim mirëmbajtje për makinat e vijëzimit është lidhur kontrata.

Investim përmirësimin rrugore horizontale dhe vertikale është lidhur kontrata

O2. Ofrimi i një shërbimi transporti publik cilësor në shërbim të qytetarëve të Bashkisë Shkodër.

- Janë në funksion dy linja të transportit publik qytetas të udhëtarëve Fermentim-Bahçallek dhe Shkodër-Zogaj.


Krahas shërbimit qytetas në Bashkinë Shkodër realizohet shërbimi rrethqytetës me linja të rregullta që lidhin Njësitë Administrative me Bashkinë Qendër. Shërbimi kryhet me operatorë ekonomik të liçencuar nga Bashkia Shkodër sipas

- frekuencave të miratuara:
 - Shkodër – Velipojë miratuar me Vendimin e Këshillit të Qarkut nr 32 datë 19.08.2004
 - Shkodër – Dajç miratuar me VKB nr. 11, datë 09. 06 .2016
 - Shkodër–Trush miratuar me Vendimin e Këshillit të Qarkut nr 45 datë 30.12.2014
 - Shkodër – Gur i Zi miratuar me Vendimin e Këshillit të Qarkut nr 5 datë 24.02.2009

- • Shkodër – Ana e Malit miratuar me Vendimin e Këshillit të Qarkut nr 14 datë 17.06.2013
- • Shkodër – Postribë miratuar me VKB nr. 11, datë 09. 06 .2016
- • Shkodër – Shalë miratuar me VKB nr. 11, datë 09. 06 .2016
- • Shkodër – Rrethina me 3 linja (Shkodër - Bleran – Bardhaj, Shkodër – Grudë e Re – Gucijë e Re, Shkodër –
- Shtoj i Ri – Shtoj i vjetër) miratuar me VKB nr. 56, datë 02. 11 .2016.

Realizimi i Buxhetit të planifikuara

Programi 04570	mijë lekë			
	Shpenzime operative	Subvencione	Investime	Totali
PBA 2021	3,637	3,000	4,000	10,637
Plani fillestar 2021	4,471	6,000	13,622	24,093
Plani i rishikuar 2021	3,774	3,000	4,000	10,774
Realizimi viti 2021	3,047	-	-	3,047
% e realizimit	80.7%	0.0%	0.0%	28.3%



Realizimi i shpenzimeve për shpenzime operative, subvencion dhe kapitale për këtë program, duke e krahasuar me planifikimin është 28.3 %, sipas zërave kryesorë si më poshtë:

Shpenzimet korrente 45%

Shpenzime kapitale 0%



Faktorët që kanë ndikuar në mosrealizimin e fondeve të planifikuara:

Subvencione për abonetë e transportit urban nuk është sepse nuk ka pasur aplikim për abone nga kategoritë përfituese (nxënës dhe studentë).

Aneksi nr.4 Raporti i realizimit të objektivave të politikës së programit

Periudha e Raportimit: 01.01.2021-31.12.2021

Kodi i Programit	4570	Emertimi i programit:	Transporti publik						Komente
Qellimi 1	Levizshmeri e sigurt, e mire orientuar per banoret dhe vizitoret. Ofrimi i një shërbimi transporti publik cilësor ne sherbim te qytetarëve te Bashkisë Shkodër. Permiresim te impaktit mjedisor nepermjet stimulimit te transportit publik dhe tradites se perdorimit te bicikletes								
			**Treguesit e performancës						
Objektivat e politikës:		Kodi i Treguesit te Performances/Produktit	Emertimi i Treguesit te Performances***	Niveli faktik i vitit paraardhes	Niveli i planifikuar ne vitin korent	Niveli i rishikuar ne vitin korent	Niveli faktik ne fund te vitit korent	% e Realizimit te Treguesit te Performances/Produktit	
Objektivi 1	Permiresimi i levizshmerise urbane për një siguri dhe cilësi jetese më të mirë	1	Numri i tabelave për sinjalistikën vertikale (rritja vjetore në %)	8%	16%	16%	6%	38%	
		2	Numri i bumpeve për sinjalistikën vertikale (rritja vjetore në %)	24%	28%	0%	0%		
Objektivi 2	Ofrimi i një shërbimi transporti publik cilësor ne sherbim te qytetarëve te	3	Numri i linjave të transportit publik urban dhe interurban (rritja vjetore në %)	25%	0%	0%	0%		
		4	Numri i mjeteve të transportit publik urban dhe interurban (rritja vjetore në %)	15%	0%	0%	0%		

	Bashkisë Shkodër	5	Numri i biletave te shitura në vit (ritja ne %)	-19%	-24%	-24%	-16%	67%	
		6	Përkrahja e kategorive si nxënës, studentë dhe kategorive të veçanta që përfitojnë sipas dispozitave ligjore (ritja në %)	3%	3%	0%	0%		

ANEKSI nr.3 "Raporti permbledhes i realizimit te treguesve te performances/produkteve te programit"

Emri i Grupit	Bashkia Shkodër	Kodi i Grupit	141
Programi	Transporti publik	Kodi i Programit	4570

Kodi	Emertimi i Produktit	Njësia matese	Sasia Faktike (v. 2020)	Shpenzimet (v. 2020)	I			II			III			IV			Luhatjet ne Koston per Njesi			Komente
					Kosto per Njesi (v. 2020)	Sasia (v. 2021)	Shpenzimet (v. 2021)	Kosto per Njesi (v. 2021)	Sasia e Rishikuar (v. 2021)	Shpenzimet e Rishikuara (v. 2021)	Kosto per Njesi e Rishikuar (v. 2021)	Sasia Faktike (v. 2021)	Shpenzimet Faktike (v. 2021)	Kosto per Njesi Faktike (v. 2021)	V = IV - I	V = IV - II	V = IV - III			
1	Rruge lokale urbane me sinjalistike rrugore.	km	145	4,450	31	150	7,637	51	150	7,774	52	150	3,047	20.31	-10	-31	-32			
2	Udhëtarë që përdorin linjat e transportit publik	Numri i njerëzve të mbështetur /subvencionuar				500	3,000	6	500	3,000	6	0	0	0	0	-6	-6			

Drejtuksi i Ekipit Menaxhues të Programit	Emri	Alfred Luleta	Kryetari i Njesisë së Vetëqeverisjes Vendore	Emri	Voltana Ademi
	Firma			Firma	
	Data			Data	

Për vitin 2021 në Programin " Transporti publik dhe lëvizshmëria" në funksion të veprimtarisë kryesore dhe përmbushjen e objektivave të përcaktuara, janë parashikuar 2 aktivitete.

-Aktivitetet janë analizuar si me poshtë:

P04570.O1.A1:Lëvizshmëria dhe sinjalistika.

P04570.O2.A1: Shërbimi i transportit urban.

Aktiviteti	Buxheti Fillestar në mijë lekë	Buxheti i Rishikuar në mijë lekë	Realizimi i 12 Mujorit 2021 në mijë lekë
P04570.O1.A1 Lëvizshmëria dhe sinjalistika & të trashëguara.	7,637	7,774	3,047
P04570.O2.A1 Shërbimi i transportit urban.	3,000	3,000	-
04570 Transporti Publik	10,637	10,774	3,047
Të trashëguara	13,456	-	-
Totali	24,093	10,774	3,047

Programi 04760: Zhvillimi i Turizmit

Ky program përfshin:

1. Drejtorinë e Turizmit

Turizmi, si aktivitet ndërsektoral, është i lidhur me shumë aktivitete ekonomike me ndikim të jashtëzakonshëm në sektorë të ndryshëm, duke ofruar shërbime të lidhura me kohën e lire dhe me udhëtimet e biznesit. Ai luan një rol të madh në zhvillim, pasi kontribuon në zhvillimin lokal, krijimin e vendeve të punës, zhvillimin e zonave në rënie industriale apo rurale, si dhe në rigjenerimin urban.

I. Përshkrimi i funksioneve dhe objektivave

F1. Zhvillimi i Turizmit

Objektivat për secilin funksion janë:

F1.O1. Promovim i territorit të Bashkisë nëpërmjet prodhimit dhe botimit të materialeve promociionale dhe informative.

F2.O2. Organizim dhe pjesëmarrje në panairë lokale, kombëtare dhe ndërkombetare.

F3. O3 Organizimi i aktiviteteve për promovimin e ofertave dhe produkteve turistike të Bashkisë Shkodër.

F4. O4 Forcimi institucional nëpërmjet ngritjes së strukturave të dedikuara për zhvillimin e turizmit.


F5. O5 Hartim i planeve dhe studimeve të zhvillimit të turizmit nga bashkëpunimi me struktura të interesuara dhe universitetin.

F6. O6 Ngritje e kapaciteteve të bizneseve që operojnë në fushën e turizmit me qëllim rritjen e cilësisë së shërbimit nga ana e tyre.

F6. O7. Përmirësim i infrastrukturës turistike dhe i aksesit.


II. Rezultatet e programit 04760: Zhvillimi i turizmit mijë lekë

Programi 04760	Shpenzime operative	Transferta	Investime	Totali
PBA 2021	1,860	2,750	1,550	6,160
Plani fillestar 2021	4,603	4,000	1,883	10,486
Plani i rishikuar 2021	2,360	2,350	1,550	6,260
Realizimi viti 2021	863	2,346	951	4,160
% e realizimit	36.6%	99.8%	61.4%	66.5%



Realizimi i shpenzimeve për paga, shpenzime operative, transferime dhe kapitale për këtë program, duke e krahasuar me planifikimin është 66.5 %, sipas zërave kryesorë si më poshtë:

Shpenzime korrente	36.6%
Shpenzime kapitale	61.4%



Faktorët që kanë ndikuar në mosrealizimin e fondeve të planifikuara:

1. Situata e krijuar nga pandemia e COVID-19 dhe anulimi mjaft aktiviteteve.
2. Mungesa e interesit nga ana e operatorëve ekonomikë për disa nga aktivitetet e parashikuara.

Aneksi nr.4 Raporti i realizimit të objektivave të politikës së programit

Periudha e Raportimit: 01.01.2021-31.12.2021

Kodi i Programit	4760	Emertimi i programit:	Zhvillimi i turizmit						Komente
Qellimi 1	Zhvillimi i Turizmit							
			**Treguesit e performancës/Produktet:					
Objektivat e politikës:	Kodi i Treguesit te Performances/Produktit	Emertimi i Treguesit te Performances***/Produktit	Niveli faktik i vitit paraardhes	Niveli i planifikuar ne vitin korent	Niveli i rishikuar ne vitin korent	Niveli faktik ne fund te vitit korent	% e Realizimit te Treguesit te Performances/Produktit		
Objektivi 1	Promovim i territorit të Bashkisë nëpërmjet prodhimit dhe botimit të materialeve promovuese dhe informative.	1	Numri i materialeve promovuese të prodhuara. (harta dhe guida)	7100	6100	6100	5000	82%	
		2	Numri i platformave promovuese të prodhuara	0	0	0	0		
Objektivi 2	Organizim dhe pjesëmarrje në panaire lokale, kombëtare dhe ndërkombetare.	3	Numri panaireve të organizuara dhe ku është marrë pjesë	1	4	3	0	0%	
Objektivi 3	Organizimi i aktiviteteve për promovimin e ofertave dhe produkteve turistike të	4	Numri i aktiviteteve të organizuara	6	8	8	6	75%	

	Bashkisë Shkodër.								
Objektivi 4	Forcimi institucional nëpërmjet ngritjes së strukturave të dedikuara për zhvillimin e turizmit.	5	Numri i turistëve (i personave) të akomoduar në hotele.	105,425	214,286	214,286	185,243	86.4%	
		6	Rritja e të ardhurave të bashkisë nga turizmi.(ne mije leje)	7,380	15,000,	15,000,	12,967	86.4%	
		7	Numri i turistëve që marrin informacion / shërbehen në zyrën e informacionit	2,500	3,800	3,800	7,200	189.5%	
Objektivi 5	Hartim i planeve dhe studimeve të zhvillimit të turizmit nga bashkëpunimi me struktura të interesuara dhe universitetin.	8	Numri i Planeve/studimeve në funksion të zhvillimit të turizmit.	-	1	1	-	0.0%	
Objektivi 6	Ngritje e kapaciteteve të bizneseve që operojnë në fushën e turizmit me qëllim rritjen e cilësisë së shërbimit nga ana e tyre.	9	Numri i personave të trajnuar	0	0	0	0		
Objektivi 7	Përmirësim i infrastrukturës turistike dhe i aksesit.	10	Tabela të vendosura	0	6	6	6	100%	

ANEKSI nr.3 "Raporti permbledhes i realizimit te treguesve te performances/produkteve te programit"

Emri i Grupit	Bashkia Shkodër	Kodi i Grupit	141
Programi	Zhvillimi i turizmit	Kodi i Programit	4760

Kodi	Emertimi i Produktit	Njësia matese	Sasia Faktike (v. 2020)	Shpenzi met (v. 2020)	I	Kosto per Njesi (v. 2020)	Sasia (v. 2021)	Shpenzi met (v. 2021)	II	Kosto per Njesi (v. 2021)	Sasia e Rishikuar (v. 2021)	Shpenzi met e Rishikuar (v. 2021)	III	Kosto per Njesi e Rishikuar (v. 2021)	Sasia Faktike (v. 2021)	Shpenzi met Faktike (v. 2021)	IV	Kosto per Njesi Faktike (v. 2021)	Luhatjet ne Koston per Njesi			Komente
																			V = IV - I	V = IV - II	V = IV - III	
1	Dizenjim dhe publikim i materialeve promovionale në platforma të ndryshme elektronike	muaj	0	0			24	160	6.67		24	160	6.67		0	0	0	0	0	-7	-7	
2	Materiale promovionale të publikuara dhe të prodhuara.	copë	7,100	367	0.05		6,100	1,150	0.19		6,100	1,150	0.19		5,000	497	0	-0.05	-0.19	-0.19		
3	Organizim dhe pjesëmarrje në panairë	numër	1	450	450.00		4	600	150.00		4	700	175		1	396	0	-450	-150	-175		
4	Organizim i aktiviteteve	numër	3	1,100	366.67		8	2,700	337.50		8	2,700	338		6	2,316	0	-367	-338	-338		
5	Rrjeti i Zyrave të informacionit turistik Qyteti Shkodër, Velipojë, Theth	numër	1,200	0	0.00		3,800	450	0.12		3,800	450	0.12		3,800	393	0	0	0	0		
6	Plani i marketingut të produktit turistik të territorit të Bashkisë Shkodër	numër	0	0			1	500	500.00		1	500	500		0	0	0	0	-500	-500		
7	Tabela informuese dhe orientuese	numër	0	0			6	600	100.00		6	600	100		6	558	0	0	-100	-100		

Drejtuuesi i Ekipit Menaxhues të Programit	Emri		Kryetari i Njësise	Emri	Voltana Ademi
---	------	--	---------------------------	------	---------------

	Firma		së Vetëqeverisjes Vendore	Firma	
	Data			Data	

Aktiviteti	Buxheti Fillestar në mijë lekë	Buxheti i Rishikuar në mijë lekë	Realizimi i 12 Mujorit 2021 në mijë lekë
P04760.O1.A1. Hostim, mirembajtje, përditësim dhe shërbime shtesë për ëeb sitin e turizmit.	80	80	-
P04760.O1.A2.Hostim , mirëmbajtje , përditësim dhe shërbime shtesë për aplikacionin e turizmit	80	80	-
P04760.O1.A3. Përditësim dhe ribotim i guidës turistike të Bashkisë Shkodër.	200	200	-
P04760.O1.A4. Ribotim i hartave turistik të Bashkisë Shkodër	300	300	-
P04760.O1.A5. Publikimi i kalendarit vjetor të aktiviteteve kulturore të Bashkisë	150	150	-
P04760.O1.A6.Prodhimi i materialeve promocionale te tilla si dosje, stilolapsa, canta, cakmakë etj.	200	200	197
P04760.O1.A7. Përgatitja dhe publikimi i itinerareve turistike	300	300	300
P04760.O2.A1.Panairi i artizanatit në ditën ndërkombëtare të artizanatit.	400	400	396
P04760.O2.A3. Pjesëmarrje në panairë kombetare dhe ndërkombëtare për ofertën turistike të Shkodrës & të trashëguara	200	300	-
P04760.O3.A1. Festa e Liqenit	400	400	400
P04760.O3.A2. Dita e turizmit	150	150	E realizuar pa kosto
P04760.O3.A3. Hapja e sezonit turistik Velipoje	450	450	450
P04760.O3.A4. Festë e Thethit	500	500	500
P04760.O3.A5. Dita e biçikletave	300	300	300
P04760.O3.A6. Triathlon	400	400	366
P04760.O3.A7.Mbështetje për Panairin e Ornitologjisë	200	200	-
P04760.O3.A8. Lojra Popullore Fest	300	300	300
P04760.O4.A1. Rrjeti i Zyrave të informacionit turistik Qyteti Shkodër, Velipojë, Theth	450	450	393
P04760.O5.A1.Hartimi i planit të marketingut të produktit turistik të territorit të Bashkisë Shkodër në	500	500	-

bashkëpunim me Universitetin Shkodrës			
P04760.O7.A2. Vendosja e tabelave orientuese dhe informuese në Shkodër	600	600	558
04760 Zhvillimi i Turizmit	6,160	6,260	4,160
Të trashëguara	4,326	-	-
Totali	10,486	6,260	4,160

Gjatë 12 mujorit të vitit 2021 është punuar për përmbushjen e objektivave nëpërmjet realizimit të aktiviteteve të parashikuara në Buxhetin e Bashkisë Shkodër për Programin 04760:

P04760.O1.A1. Hostim, mirembajtje, përditësim dhe shërbime shtesë për ëeb sitin e turizmit.

Një ndër instrumentët më të fuqishëm të marketingut territorial, është promovimi online. Promocioni online ofron avantazhe të shumta dhe është lehtësisht i arritshëm nga çdo pikë e globit, mund të përditësohet shpejt dhe nuk ka kosto të madhe. Mundësia unike që ka ëeb-i për të bashkuar shumë element në një dokument multimedia, kanë rritur përdorimin në një shkallë të lartë kundrejt mediave të tjera tradicionale, duke e kthyer atë në një media globale. Aktualisht Bashkia Shkodër ka një ëeb-site zyrtar që i dedikohet turizmit. Drejtoria e Turizmit ka hartuar termat e referencës për ndërtimin e ëebit të dedikuar, është bërë hostimi, blerë domani bashkë me 8 modulet shtesë. Ëëbi i dedikuar për turizmin është: ëë.visitshkodra.gov.al. Ky portal përmban materiale promocionale dhe të gjithë informacionin e nevojshëm për vizitorët që dëshirojnë të vinë në Shkodër. Duke pasur parasysh ritmet e zhvillimit të turizmit, tendencat e vazhdueshme për produkte të reja, do të jetë i nevojshëm azhurnimi i vazhdueshëm i informacioneve të faqes ëeb për turizmin e Bashkisë Shkodër. Gjatë kësaj periudhe të raportimit është punuar në përditësimin dhe pasurimin e këtij ëeb site.

P04760.O1.A2. Hostim , mirëmbajtje, përditësim dhe shërbime shtesë për aplikacionin e turizmit

Numri i lartë i përdoruesve të internetit në ditët e sotme, bën që marketingu online të jetë i një rëndësie shumë të lartë. Mendimi i parë i çdo individ, kur kërkon të ketë një shërbim apo informacion, është ta kërkojë në internet. Për të promovuar territorin e Bashkisë Shkodër si destinacion turistik dhe përmirësuar cilësinë e shërbimit për turistët, krijimi i një aplikacioni për smartphone, i cili deri tani mungonte, me informacionet dhe orientimet e nevojshme drejt nevojave të vizitorëve, është i domosdoshëm. Ofrimi i informacionit online përmes rrjeteve socialeve, ëeb-it, aksesit për shkarkimin falas të gjithë materialeve promocionale të territorit përmes aplikacionit do të ketë një impakt pozitiv në rritjen e numrit të vizitorëve dhe do ndikojë në zhvillimin e turizmit të qëndrueshëm. Aplikacioni i realizuar përmban informacione të cilat duhen përditësohen dhe pasurohen here pas here.

P04760.O1.A3. Përditësim dhe ribotim i guidës turistike të Bashkisë Shkodër.

Bashkia Shkodër ka potencial të madh për zhvillimin e turizmit. i gjithë territori karakterizohet nga një shumëllojshmëri atraksionesh turistike, që nga bukuritë natyrore të ndërtesat historike dhe identitetet kulturore. Pozita e favorshme gjeografike është pa dyshim një pasuri e rëndësishme për zhvillimin turistik të saj. Traditat njerëzore, kulturore dhe historike ia shtojnë më shumë vlerën këtij potenciali. Gjatë viteve të fundit, numri i turistëve që vizitojnë Shkodrën është rritur në mënyrë të qëndrueshme. Si rezultat i zgjerimit të territorit të Bashkisë Shkodër, një vëmendje e veçantë i është kushtuar pritjes

së turistëve dhe marketingut të ofertës turistike. Në këtë kuadër Bashkia Shkodër ka përgatitur dhe botuar guidën turistike të territorit, material i cili kërkon përditësim të të dhënave dhe shtim informacioni të herëpashershëm. Me hapjen e zyrave të informacionit, interesimi i vizitorëve pranë këtyre zyrave është gjithnjë e në rritje dhe përgatitja e materialeve promociionale dhe shpërndarja e tyre, është shumë e rëndësishëm. Për këtë arsye, është e nevojshme që ky produkt të ribotohet herë pas here. Në vitin 2017 janë botuar 3 800 guida në gjuhën angleze dhe në vitin 2018 janë botuar 1 200 copë guida të destinuar për turistin shqipfolës, ndërsa për vitin 2019 është përditësuar informacioni dhe është përmirësuar paraqitja e guides dhe gjithashtu është printuar në 1 000 kopje. Gjate vitit 2020 dhe 2021 duke pasur parasysh periudhen e pandemisë, nuk ka qënë e nevojshme ri printimi i këtij produkti, pasi kemi pasur sasi të mjaftueshme gjendje të guidës.

P04760.O1.A4. Ribotim i hartave turistike të Bashkisë Shkodër

Zona e Shkodrës gjithnjë e më tepër po tërheq vizitorë nga shtete të ndryshme të botës. Këto vizitorë shpesh kanë nevojë për të marrë informacion për vendet me interes dhe mënyrën se si mund të arrihet atje. Është realizuar botimi i disa materialeve promociionale të tilla si broshura e Thethit (1000 copë) dhe broshura e Velipojës (500 copë) të cilat përmbajnë hartën përkatëse dhe informacionet e nevojshme për një vizitor në këto zona. Nevoja për të pasur një hartë turistike të gjithë territorit të Bashkisë Shkodër, për të plotësuar nevojat e vizitorëve potencial të Bashkisë, ka qënë i domosdoshëm. Në këtë kuadër, Drejtorja e Turizmit ka bërë përzgjedhjen e modelit dhe përmbajtjes së informacionit që do të ketë harta turistike e Bashkisë Shkodër dhe ka përcaktuar termat e referencës për shërbimin e konsulencës. Janë publikuar 1550 kopje të hartës të të gjithë territorit të bashkisë Shkodër dhe janë printuar harta të destinacioneve të veçanta për qytetin e Shkodrës dhe për zonën e Thethit. Gjate vitit 2020 dhe 2021 duke pasur parasysh periudhen e pandemisë, nuk ka qënë e nevojshme ri printimi i këtij produkti, pasi kemi pasur sasi të mjaftueshme gjendje të hartave.

P04760.O1.A5. Publikimi i kalendarit vjetor të aktiviteteve kulturore të Bashkisë

Në territorin aktual të Bashkisë Shkodër zhvillohen një seri ngjarjesh dhe aktiviteteve social-kulturore, sportive etj. Pjesa më e madhe e tyre organizohet në mënyrë të drejtpërdrejtë ose e mbështetur në mënyra të ndryshme nga Bashkia. Një pjesë e tyre janë aktivitete me pjesëmarrje të gjërë dhe me potencial të konsiderueshëm për të tërhequr vizitorë edhe nga trevat e tjera të Shqipërisë e më gjërë. Staf i Drejtorisë së Turizmit, ka konceptuar modelin, përmbajtjen, hartuar termat e referencës dhe mbledhur informacionin e nevojshëm si dhe ka bërë përkthimin në anglisht të tekstit të kalendarit. Është realizuar publikimi i këtij kalendarit në gjuhën shqipe dhe angleze për çdo vit. Gjatë vitit 2021, si rezultat i anulimit të shumë aktiviteteve për shkak të situatës së pandemisë, nuk është parë e arsyeshme të realizohet ky aktivitet.

P04760.O1.A6. Prodhimi i materialeve promociionale të tilla si dosje, stilolapsa, çanta, çakmakë etj.

Materiale të ndryshme promociionale si dosje, stilolapsa, çanta, çakmakë etj, janë materiale që kanë kosto të lirë por ndikim të madh në promovimin e një destinacioni të caktuar. Për të promovuar turizmin në destinacion, janë mjaft me vlerë edhe materialet promociionale, të cilat në shpërndarjen e tyre lënë një imazh të destinacionit. Është e rëndësishme që prezantimet apo takimet që do bëhen nga stafi i drejtorisë së turizmit, të kenë mjetet e nevojshme identifikuese. Janë realizuar prodhimi i materialeve të branduara mbajtëse çelësash, çanta kartoni, blloqe axhendë, çakmakë, usb dhe flamuj promociional.

P04760.O1.A7. Përgatitja dhe publikimi i itinerareve turistike

Një ndër mangësitë më të mëdha të identifikuar për sa i përket zhvillimit të turizmit në shqipëri është mungesa e zhvillimit të produktit turistik gjë e cila bëhet faktor pengues për rritjen e numrit të turistëve në territorin e Bashkisë Shkodër. Për këtë arsye është realizuar konceptimi, dizenjimi dhe publikimi i 5 itinerareve turistike me biçikleta (1000 copë) të cilat do të vihen në dispozicion të operatorëve turistikë me qëllim që të integrohen në paketat e tyre turistike.

P04760.O2.A1. Panairi i artizanatit ne ditën nderkombetare te artizanatit.

Një pikë e fortë e ofertës turistike të Bashkisë Shkodër me të cilën mund të konkurojmë denjësisht edhe në nivele ndërkombëtare, është artizanati. Në një situatë në të cilën zhvillimi ekonomik dhe rritja e mirëqënies po çojnë dalëngadalë drejt humbjes së interesit për punimet artizanale dhe zbehjen e rëndësisë së tyre si aktivitet ekonomik, për shkak të rritjes së interesit të vizitorëve dhe të turistëve të shumtë që vizitojnë qytetin për punimet artizanale dhe suvenirët, lind nevoja që këto zeje dhe zanate të promovohen dhe të mbështeten si një element tërheqës dhe burim turistik. Punimet e qytetit të Shkodrës dhe të zonave përreth mbeten një suvenir i mrekullueshëm sapo viziton këtë qytet. Panairi është një instrument i fuqishëm që ndikon drejtpërdrejt në promovimin e ketyre vlerave që ka territori. Panairi i Artizanatit zhvillohet cdo vit me datë 10 Qershor, Ditën Ndërkombëtare të Artizanatit. Janë zhvilluar procedurat sipas metodologjisë LOD dhe këtë vit aktiviteti u zhvillua në dt. 05.08.2021 në Pedonalen përballë Bashkisë Shkodër me pjesëmarrjen e gjerë të artizanëve nga Bashkia Shkodër, Malësia e Madhe, Lezha, Puka, Tirana, Mirdita, Saranda, Gjirokastra, Berati etj.

04760.O2.A3. Pjesëmarrje në panairë kombetare dhe ndërkombëtare për ofertën turistike të Shkodrës

Për të promovuar ofertën turistike të territorit, në fillim të muajit Prill, Bashkia Shkodër kishte planifikuar të merrte pjesë në “Panairin e Turizmit Mesdhetar”- Tiranë, panairi i cili për momentin është anuluar për shkak të situatës së pandemisë Covid19. Nuk zhvillohet këtë vit pasi nuk është parashikuar për shkak të situatës së COVID 19.

P04760.O3.A1. Festa e Liqenit

Ky është një aktivitet promovues social kulturor dhe sportiv që organizohet me qëllim ruajtjen, mbrojtjen dhe zhvillimin e trashëgimisë së pasur natyrore të qytetit si dhe promovimin e produkteve rajonale dhe bizneseve lokale të Shkodrës. Në vite janë organizuar gara të ndryshme noti (të rritur, të rinj & fëmijë), gara me kanoe, ski board, ndeshje vaterpoli me pjesëmarrjen e ekipeve të notit dhe fshatrave Zogaj dhe Shirokë dhe shkollave 9 vjeçare dhe të mesme të qytetit. Me anë të organizimit të këtij aktiviteti Bashkia synon të ruajë dhe të forcojë këtë traditë me qëllim tërheqjen e vizitorëve dhe ndërgjegjësimin qytetar për vlerat ekoturistike, ekonomike dhe mjedisore të Liqenit të Shkodrës. Sivjet kjo festë u realizua nëpërmjet një eventi on line promocional për shkak të kushteve të pandemisë së COVID 19. Aktiviteti u zhvillua me dt.19 Qershor 2021.

P04760.O3.A2. Dita e turizmit

Zhvillimi i turizmit ka ecur me hapa të shpejtë në vitet e fundit. Numri i vizitorëve ka ardhur vazhdimisht në rritje nga viti në vit dhe po ashtu edhe shtrirja gjeografike e prejardhjes së tyre.

Gradualisht sektori i turizmit po shndërrohet në një ndër sektorët lider të zhvillimit ekonomik të Shkodrës. Bashkia Shkodër, duke kuptuar rëndësinë e zhvillimit të turizmit, i ka dhënë përparësi të veçantë zhvillimit të tij, duke forcuar kuadrin institucional që punon në këtë drejtim. Gjithashtu për të ndërgjegjësuar edhe më shumë komunitetin dhe biznesin, për të rritur përpjekjet dhe bashkëpunimin në këtë drejtim, Bashkia Shkodër organizon çdo vit një festë kushtuar turizmit në ditën botërore të turizmit me datë 27 Shtator, duke zhvilluar aktivitete të ndryshme me qëllim evidentimin dhe promovimin më tej të vlerave dhe potencialeve turistike që ka territori i Bashkisë Shkodër. Tema e këtij viti ishte “Tourism for inclusive growth”. Në këtë kuadër, Drejtoria e turizmit të Bashkisë Shkodër me datë 27 shtator, organizoi një takim informues me studentë të universitetit të Shkodrës, përfaqësues të shoqatës mjedisore Ëell Point dhe specialistë nga DRKK.

P04760.O3.A3. Hapja e sezonit turistik Velipoje

Velipoja është një ndër destinacionet e më të njohura të bregdetit shqiptar me vlera dhe potenciale të konsiderueshme për zhvillimin e turizmit të diellit e rërës. Aktualisht frekuentohet nga një numër i madh pushuesish gjatë sezonit të verës të përqëndruar kryesisht vetëm në muajt korrik e gusht, por Velipoja zotëron potenciale të tilla, që ky sezon të jetë më masiv dhe më i shtrirë në kohë. Dita e hapjes së sezonit turistik është zhvilluar çdo vit këto vitet e fundit me pjesëmarrjen e banorëve të zonës dhe qytetarë nga Shkodra. Në 2019, ky aktivitet u realizua me datë 1 maj dhe konsistoi në organizimin e një koncerti të madh festiv të mbajtur në qendër të plazhit të Velipojës në të cilin performuan live një rockband i përbërë nga artistë të qytetit të Shkodrës si edhe një grup valltarësh, lojra sportive (volejball, futboll dhe hemboll dhe gara me varka me vela dhe kanoë. Sivjet kjo festë u realizua nëpërmjet një eventi on line promociional për shkak të kushteve të pandemisë së COVID 19. Organizata fituese për realizimin e këtij aktiviteti “Mandarina Project”, punoi në krijimin e një imazhi kryesor i cili fton të gjithë pushuesit nën sloganin “Velipoja ju fton” dhe imazheve të tjera mbështetëse të fushatës. Si elementë të fushatës u konceptua edhe një imazh grafik informues mbi idenë e aktiviteteve që ofron Velipoja për të gjithë turistët vendas e të huaj dhe disa gifte që pasqyrojnë bukuritë e natyrës dhe mikpritjen vendase që ofron Velipoja gjatë gjithë vitit. Pjesa e komunikimit të fushatës është ndarë në dy plane, para hapjes së sezonit, me “hapni momentet”, “hapni menutë”, “hapni mikpritjen”, “hapni freskinë”, “hapni cadrat”, etj. dhe vazhdimin e fushatës së komunikimit edhe pas lancimit të sezonit turistik. Aktiviteti përmbyllës u zhvillua me dt.05 Qershor 2021.

P04760.O3.A4. Festë e Thethit

Në datën 10 korrik u realizua event i live nga Thethi me plot 9 lidhje live gjatë gjithë ditës mundësuar nga stafi i projektit. Në live u përfshinë turistë, banorë vendas si edhe kryetarja e Bashkisë Shkodër, live u percoll si një ftesë ndaj të gjithë qytetarëve nga vetë njësitë mikpritëse, ofrues të shërbimeve dhe operatorë turistik në destinacion. Në po atë ditë u lancuan edhe 10 video intervistat e realizuar me operatorët turistik në zonën e Thethit, si edhe spoti me gjatësi 96 sec, pra të gjithë elemente të paketës promovuese.

P04760.O3.A5. Dita e biçikletave.

Shkodra është qyteti numër një në Shqipëri për përdorimin e biçikletës me një traditë të hershme të përdorimit të saj që zë fill që në shekullin e XIX. Gjithashtu Shkodra renditet në 10 qytetet që përdorin

më shumë biçikletën në shkallë europiane. Gjatë periudhës së dikaturës biçikleta ishte mjete kryesor i transportit në Shkodër pasi numri i makinave ishte shumë i kufizuar. Me ardhjen e demokracisë dhe zhvillimin ekonomik numri i makinave ka ardhur vazhdimisht në rritje duke kërcënuar kështu zbehjen e kësaj tradite. Gjithashtu rritja e numrit të makinave rrezikon edhe ndotjen e ajrit nga gazrat dhe elementëve të tjerë të mjedisit nga mbetjet e tyre. Me organizimin e ditës së biçikletave dhe shndërrimin e saj në një festë të përvitshme synohet ripërtëritja e traditës si edhe promovimi i mënyrës së shëndetshme të jetesës por synohet edhe gjallërimi i jetës kulturore të qytetit duke rritur atraktivitetin e tij. Organizata fituese për realizimin e këtij aktiviteti për 2021 u përzgjedh OSHC dhe aktiviteti u zhvillua me dt. 25/09/2021. Këtë vit ky aktivitet filloi me një ëorkshop, punime kreative me të rinj të projektit Yeep. Të cilët gjatë muajit Shtator përmes disa seancave të riciklueshme të ëorkshopit realizuan biçikletën e cila u ekspozua te ura e Bunës së Vjetër. Por, ky projekt synoi të promovojë dhe pika turistike të tjera të Shkodrës, ku simboli i biçikletës do lëvizë dhe do vendoset në Shirokë, Drin dhe në Velipojë. Më pas eventi vijoi drejt Urës së Bunës së Vjetër ku u vendose përmes një ceremonie dhe monumenti simbol i biçikletës. Kësaj feste iu bashkuan dhe fëmijë të kopështit “Bep Tusha”. Më pas grupi i biçikletave i cili është përbërë nga grupe fëmijesh, të rinj, të reja si dhe përfshirjen e moshave të ndryshme si: 1. Shkolla Luce Agraja Dajc, 2. Taraboshi Junior, 3. Taraboshi Shkodër, 4. Famullia Dajc 5. Ciklista amator nga Ulqini, Norvegjia, Argjentina . Me pas grupi vazhdoi rrugëtimin nga Ura e Bunës e Vjetër drejt fshatit të bukur të Njësisë Administrative Dajc ku dhe shijuan drekën me produkte zgare te Restorant “Lumi i jetës”.

P04760.O3:A6. Triathlon

Triathlon është një aktivitet tre-garësh në tre disiplina sportive të ndryshme, si gara e notit, ciklizmi dhe vrapimi, për të cilat ne jemi shumë krenarë për traditën dhe rezultatet e shkëlqyera që sportistët tanë profesionistë dhe amatorë kanë dhene ndër vite. Aktiviteti zhvillohet në një nga zonat më të bukura të Bashkisë Shkodër, që shtrihet në të gjithë gjatësinë e bregut perëndimor të Liqenit të Shkodrës: Shirokë - Zogaj. Ky aktivitet, që zhvillohet gjatë muajit shtator, ngjall interes të shumtë për pjesëmarrje jo vetëm nga Shkodra, por dhe nga qytete të tjera të Shqipërisë. Interes të madh kishte vitin e kaluar dhe nga Kosova dhe nga shtete të tjera të Europës. Duke qenë se është një garë në 3 disiplina, u mendua që këtë vit të pranohen në garë jo më shumë se 55 persona, për arsye mirë organizimi dhe sigurie. Ky aktivitet u zhvillua me datën 8 shtator dhe në të morën pjesë rreth 70 pjesëmarrës nga Shqipëria, Kosova, Mali i Zi dhe Maqedonia. Aktiviteti është zhvilluar me dt. 29 Gusht.

P04760.O3.A7.Mbështetje për Panairin e Ornitologjisë

Ornitologjia është fusha shkencore e dedikuar për studimin dhe mbarështimin e zogjve. Shkodra është e njohur për traditën e saj të vecantë në rritjen dhe mbarështimin e zogjve të kafazit. Vitin e kaluar, ne Shkodrën u organizua për herë të tretë, “Panairi i Ornitologjisë” me iniciativën e Shoqatës “Meraklinjtë e zogjve të kafazit” në këtë panair kishte pjesëmarrës nga e gjithë Shqipëria, Kosova, Mali Zi, Maqedonia dhe Italia. Aktiviteti u zhvillua në datat 30 Nëntor dhe 1 Dhjetor me ekspozimin e rreth 800 ekzemplarëve. Ky aktivitet nuk u arrit të realizohej në 2021, për shkak të kushteve të vendosura në kuadër të pandemisë.

P04760.O3.A8. Lojra Popullore Fest.

Lojra Popullore Fest është një aktivitet me karakter social kulturor. Për të rinjtë i cili synon jo vetëm të pasurojë jetën e të rinjve, por edhe ti njohë ato me traditat tona kombëtare me anë të këngëve,

valleve dhe lojrave popullore. Qëllimi i aktivitetit të promovojë paqen, tolerancën, miqësinë në mes të trupave pjesëmarrësve. “Lojra Popullore Fest” gjithashtu synon të pasurojë jetën e të rinjve duke i angazhuar ato në identifikimin e vlerave njerëzor, folklorike kombëtare dhe ndërkombëtare. Vetë të rinjtë konkurrojnë me performaca dhe lojra popullore, këngë e valle tradicionale kombëtare dhe etnografike. Aktiviteti shërben edhe për promovimin e vlerave dhe potencialeve turistike. Aktiviteti “Lojra popullore fest” edicioni i 14-të, u zhvillua me datën 02 tetor 2021 me pjesëmarrës 80 fëmijë e të rinj nga Bashkia Shkodër si dhe në rang Qarku Shkodër, apo dhe shqiptarë të trojeve e diasporës.

P04760.O4.A1. Rrjeti i Zyrave të informacionit turistik Qyteti Shkodër, Velipojë.

Vitet e fundit, gjithnjë e më tepër, territori i Bashkisë Shkodër ka një numër në rritje të vizitorëve me origjinë nga vende të ndryshme por edhe nga kontinente të ndryshme. Të ndryshme janë jo vetëm vendet e origjinës por edhe tipologjia e udhëtimit të tyre. Një pjesë vijnë në mënyrë të organizuar nga agjensi të ndryshme shqiptare por edhe të huaja, por një pjesë e mire e tyre vijnë në mënyrë të paorganizuar. Kjo tipologji vizitorësh ka nevojë më shumë se të tjerët për informacion. Ka 3 vjet tashmë që në territorin e Bashkisë Shkodër janë hapur një rrjet zyrash të informacionit turistik me dy zyra, në Shkodër dhe Velipojë. Në këto zyra ofrohet informacion sipas nevojës së vizitorëve që vizitojnë destinacione të veçanta të territorit të bashkisë. Gjatë 2021, janë realizuar disa punime për mbarëvajtjen e punëve të tilla si: hidroizolim, zëvendësim pllakash, zëvendësim vetratash me materiale plastike, ndricues, lyerje etj.

P04760.O5.A1. Hartimi i planit të marketingut të produktit turistik të territorit të Bashkisë Shkodër në bashkëpunim me Universitetin Shkodrës

Vitet e fundit, turizmi në territorin e Bashkisë Shkodër është zhvilluar me shpejtësi me rritje të konsiderueshme të numrit të turistëve nga viti në vit. Deri më tani kjo rritje ka ardhur si pasojë e punës dhe përpjekjeve të të gjithë aktorëve që janë të interesuar në zhvillimin e turizmit, por pa pasur si linjë guide një dokument strategjik si në nivel lokal ashtu edhe kombëtar. Duke pasur parasysh mungesën e një dokumenti të tillë rezulton e domosdoshme hartimi i këtij dokumenti strategjik, në bashkëpunim edhe me Universitetin e Shkodrës në mënyrë që përpjekjet e të gjithë aktorëve të jenë të koordinuara dhe të orientuara drejt qëllimeve dhe objektivave specifike për sa i përket marketingut turistik dhe në këtë mënyrë edhe zhvillimi i turizmit të njohë arritje të reja. Ky aktivitet nuk është realizuar pasi nuk ka pasur interes nga ofruesi i shërbimit.

P04760.O7.A2. Vendosija e tabelave orientuese dhe informuese në Shkodër

Shkodra është kryeqendra nga mund të nisë udhëtimi për të vizituar veriperëndimin e Shqipërisë. Një numër i konsiderueshem i turistëve vinë në Shkodër në mënyrë të paorganizuar. Një rrjet i përhapur i informacionit lejon të arrihet shpejt dhe me siguri në destinacionin e dëshiruar. Në kuadër të bashkëpunimit me GIZ, janë vendosur 5 tabela informuese nga të cilat 2 janë dëmtuar nga dukuri natyrore dhe duhet të riparohen dhe rivendosen në hapësirat që kanë qenë më parë. Vihet re se sinjalistika turistike dhe orientuese për në vendet e interesit turistik, aktualisht është e pamjaftueshme. Vendosija e tabelave informuese dhe orientuese në qytetin e Shkodrës do të përmirësonte ndjeshëm shërbimin dhe më konkretisht informacionin që u jepet vizitorëve. Kjo do të rriste ndjeshëm lehtësinë për të vizituar Shkodrën dhe në këtë mënyrë do të cojë në rrijen e numrit të vizitorëve të destinacionit. Janë vendosur 6 tabela te reja dhe riparuar 3 ekzistuese.

FUNKSIONI 05: MBROJTJA E MJEDISIT

Programi 05100: Menaxhimi i mbetjeve

Ky program përfshin institucionin e Bashkisë

Realizimi i qëllimit dhe objektivave të politikës së programit:

-Qëllimi i programit të Menaxhimit të mbetjeve është:

Përmirësimi i cilësisë së shërbimit, menaxhimi i mbetjeve të ngurta duke filluar ndarjen në burim të atyre të riciklueshme nëpërmjet ndërgjegjësimit dhe edukimit mjedisor që bën të mundur përmirësimin e situatës mjedisore dhe reduktimin e sasisë së mbetjeve që depozitohet në landfill.

-Objektivat e programit buxhetor për përmbushjen e këtij qëllimi për 12-mujorin e vitit 2021 kanë qënë:

O1. Rritja e mbulimit me shërbim.

Zona e mbulimit është rritur duke përmbushur objektivin e ofrimit të shërbimit sipas planit të miratuar dhe mbulimi i territorit administrativ të Bashkisë Shkodër. Me kontratat e reja që mbulojnë shërbimin e pastrimit për zonën lindore dhe perëndimore janë shtuar edhe teritorie ku sot është sistemuar infrastruktura janë shtuar pika grumbullimi dhe i ofrohet shërbimi në Sheldi, Rragam, Prekal, Theth.

O2. Përmirësimi i administrimit të shërbimit të menaxhimit të mbetjeve urbane:

Me miratimin e Procedurës standarte të veprimit për administrimin e ofrimit të shërbimit të pastrimit për të gjithë territorin e Bashkisë Shkodër dhe njësitë administrative realizohet më së miri përmirësimi i cilësisë të shërbimit duke rritur standartin e kontrollit dhe monitorimit të ofrimit të shërbimit të pastrimit për zonat funksionale bazuar në kontratat e ofrimit të shërbimit të pastrimit. O3. Eficienca buxhetore për ofrimin e shërbimit:

O3. Rritja e frekuencës së mbledhjes së mbetjeve bashkiake.

Nën vëmendje përdorimi me efikasitet të burimeve financiare dhe rritja e transparencës dhe përfshirja e hallkave administrative, që sigurojnë administrimin e plotë të shërbimit, planifikimin, zbatimin, kontrollin dhe verifikueshmërinë e shërbimit të ofruar.


Është shtuar shërbimi dhe strukturuar me frekuenca të përcaktuara, sipas standartit të dakordësuar, me pika grumbullimi të përcaktuara dhe me kontenierë shtesë edhe në të gjitha Njësitë Administrative.

Gjatë vitit 2021 vazhdohet me kontratat e reja për të gjitha njësitë administrative në dy zona funksionale respektivisht për zonën Perëndimore njësite Velipoje, Dajc , Bërdicë Ana e Malit dhe për zonën lindore Njësitë administrative Rrethina Postribë Shalë dhe Gur i Zi. Procedurat këto të realizuara në zbatim të detyrimit ligjor sipas zbatimit të detyrimit ligjor për një menaxhim të drejtë, transparent dhe me efikasitet financiar në përmirësimin e administrimit dhe menaxhimit të sektorit të mbetjeve me zbatimin e VKM 319/2018 “Për miratimin e masave për kostot e menaxhimit të integruar të mbetjeve”. Kjo ka ndikuar në përmbushjen e synimit të rritjes së performancës dhe standartit të shërbimit përmes përmirësimit teknologjik, të rritjes së frekuencave të shërbimit dhe sistemit të monitorimit dhe penaliteteve.

Realizimi i Buxhetit të planifikuar

mijë lekë

Programi 05100	Shpenzime operative	Investime	Totali
PBA 2021	192,885	4,455	197,340
Plani fillestar 2021	286,499	4,820	291,319
Plani i rishikuar 2021	286,499	4,455	290,954
Realizimi viti 2021	121,314	-	121,314
% e realizimit	42.3%	0.0%	41.7%



Realizimi i shpenzimeve operative dhe kapitale për këtë program, duke e krahasuar me planifikimin është 41.7 %, sipas zërave kryesorë si më poshtë:

Shpenzime korrente	42.3%
Shpenzimet kapitale	0



Faktorët që kanë ndikuar në mosrealizimin e fondeve të planifikuara:

Është realizuar shpenzimi i fondeve të planifikuara për zonën perëndimore, ndërsa mungon realizimi deri në fund të muajit prill për zonën qendër dhe atë lindore për shkak të realizimit të shpenzimit të shërbimit të dy zonave në fillim të muajit Maj 2021 për arsye të dokumentacionit të shtuar të dy zonave sepse pagesa është realizuar për tre muaj bashkë dhe kërkohej më shumë kohë nga strukturat për verifikimin e dokumentacionit të ardhur nga operatori i shërbimit të pastrimit për zonat qendër bashkia shkodër dhe zona lindore .

Për shkak të observacioneve të ardhur në adresë të Bashkisë Shkodër nga operatori i ofrimit të shërbimit të pastrimit për zonën perëndimore mbi dokumentacionin e likuidimit të muajit

Korrik –Gusht 2021 nuk është realizuar shpenzimi për këto dy muaj në muajin shtator 2021.
Shpenzimi do të realizohet në vazhdim.

Aneksi nr.4 Raporti i realizimit të objektivave të politikës së programit

Periudha e Raportimit: 01.01.2021-31.12.2021

Kodi i Programit	5100	Emertimi i programit:	Menaxhimi i mbetjeve					Komente
Qellimi 1	Administrim, mbikëqyrje, inspektim organizim ose mbështetje e sistemeve të grumbullimit, trajtimit dhe eliminimit të mbetjeve; Mbledhja, largimi dhe trajtimi i mbetjeve të ngurta dhe shtëpiake. Grante, hua ose financime për të mbështetur ndërtimin, mirëmbajtjen ose përmirësimin e këtyre sistemeve; Pastrimi i rrugëve,parqeveve etj.							
			**Treguesit e performancës/Produktet:					
Objektivat e politikës:	Kodi i Treguesit te Performances/Produktit	Emertimi i Treguesit te Performances***/Produktit	Niveli faktik i vitit paraardhes	Niveli i planifikuar ne vitin korent	Niveli i rishikuar ne vitin korent	Niveli faktik ne fund te vitit korent	% e Realizimit te Treguesit te Performances/Produktit	
Objektivi 1	Përmirësimi i menaxhimit të integruar të mbetjeve urbane	1	- Popullata e mbuluar me shërbim kundrejt totalit të popullatës në qytet në %	100%	100%	100%	100%	
		2	- Popullata e mbuluar me shërbim kundrejt totalit të popullatës në njësinë administrative në %	77%	82%	82%	82%	100%

		3	Të ardhura nga tarifat e shërbimit për 1 ton mbetje të menaxhuar (mbulimi koston së shërbimit nga tarifa)	133%	88%	59%	130%	220%	
		4	Të ardhura nga tarifat e shërbimit për 1 ton mbetje të menaxhuar (mbulimi koston së shërbimit nga tarifa)	3728	4243	4243	4711	111%	
		5	Buxheti për menaxhimi e mbetjeve kunderjt sasisë totale të mbetjeve të menaxhuar (lekë për 1 tonë mbetje kosto operative dhe mirëmbajtje plus investime)	2796	4822	7162	3627	51%	
		6	Frekuenca e grumbullimit dhe transportimit të mbetjeve urbane në qytet dhe Nj.Administrative - Herë ne dite / Herë në Javë;	2	2	2	2	100%	
		7	Sasia e mbetjeve urbane të grumbulluara dhe të transportuara ne vendet e miratuar kundrejt numrit total të banorëve (tonë për frymë në ditë)	0.0006	0.0006	0.0006	0.0006	100%	

ANEKSI nr.3 "Raporti permbledhes i realizimit te treguesve te performances/produkteve te programit"

Emri i Grupit	Bashkia Shkodër	Kodi i Grupit	141
Programi	Menaxhimi i mbetjeve	Kodi i Programit	5100

Kodi	Emertimi i Produktit	Njësia matese	Sasia Faktike (v. 2020)	Shpenzimet (v. 2020)	I	Sasia (v. 2021)	Shpenzimet (v. 2021)	II	Sasia e Rishikuar (v. 2021)	Shpenzimet e Rishikuara (v. 2021)	III	Sasia Faktike (v. 2021)	Shpenzimet Faktike (v. 2021)	IV	Luhatjet ne Koston per Njesi			Komentet
															V = IV - I	V = IV - II	V = IV - III	
1	Shërbimi i pastrimit në qytet + Nj.A	ton/mbetje	40,000	119,470	3	40,000	197,340	5	40,000	290,954	7	33,451	121,313	4	1	-1	-4	

Drejtuuesi i Ekipit Menaxhues të Programit	Emri	Alfred Luleta	Kryetar i Njesisë së Vetëqeverisjes Vendore	Emri	Voltana Ademi
	Firma			Firma	
	Data			Data	

Për vitin 2021 në Programin "Menaxhimi i mbetjeve" në funksion të veprimtarisë kryesore dhe përmbushjen e objektivave të përcaktuara, është parashikuar 1 aktivitet.

-Aktiviteti është analizuar si më poshtë:

P.05100.O1.A1-A2. Shërbimi i pastrimit

Aktiviteti	Buxheti Fillestar në mijë lekë	Buxheti i Rishikuar në mijë lekë	Realizimi i 12 Mujorit 2021 në mijë lekë
P05100.O1.A1-A8. Shërbimi i pastrimit & të trashëguara	197,340	290,954	121,314
05100 Menaxhimi i mbetjeve	197,340	290,954	121,314
Të trashëguara	93,979	-	-
Totali	291,319	290,954	121,314

Programi 05200: Menaxhimi i ujërave të zeza

Ky program përfshin institucione dhe konkretisht:

1. Aparatin e Bashkisë
2. Ujësjetës

Realizimi i qëllimit dhe objektivave të politikës së programit

-Qëllimet e programit të Menaxhimit të ujërave të zeza janë:

1. Rritja e numrit të lidhjeve të shkarkimeve të ujërave të zeza të popullsisë urbane dhe rurale si dhe mirëmbajtja e rrjetit ekzistues.
2. Sigurimi i funksionimit normal të rrjetit të kanalizimeve të ujërave të bardha (shiut) në qytet dhe grykëderdhjet kryesore për të evituar problematikat e ndryshme.

-Objektivat e programit buxhetor për përmbushjen e këtyre qëllimeve për 12-mujorin e vitit 2021 kanë qënë:

O1. Përmirësimi i sistemit të kanalizimit të ujërave të zeza në të gjithë zonat urbane të Nj.A të Bashkisë.

Ky shërbim realizohet nga Ujësjetës Kanalizime Shkodër, sh.a:

- Rreth 23,137 familje janë të lidhur me rrjetin KUZ në Shkodër qytet + Nj.A
- 3,257 biznese në të gjithë Bashkinë janë të lidhura në sistemin e KUZ;
- Rrjeti i kanalizimeve të ujërave të zeza në qytet është rreth 150 km;
- Mbulimi me shërbimin e kanalizimeve të ujërave të ndotura për zonën urbane dhe rurale, është përkatësisht 78% për qytetin Shkodër dhe 4% për popullsinë e njësive administrative. Kryesisht janë të pa lidhur me rrjetin KUZ zonat periferike të qytetit, të cilat funksionojnë me gropa septike.
- Në Bashkinë Shkodër ka 2 impiante të pastrimit të ujërave të zeza në Velipojë, dhe në Shirokë;
P08220.O1.A3: Materiale promocionale për rrjetin muzeal.

U realizuan Guida dhe fletëpalosje të Muzeut Historik .

P08220.O1.A4: Publikime promocionale, fletëpalosje e guidë për Vendin e Dëshmisë e Kujtesës

Realizohet 1 herë në 2 vite , dhe këtë vit nuk ka qënë i planifikuar të realizohet.

P08220.O1.A5: Cikël takimesh dhe bisedash mbi historinë dhe të kaluarën e Shqipërisë dhe Shkodrës në veçanti.

Duke marrë parasysh situatën e krijuar nga Covid-19, ka qënë e pamundur realizimi i këtij aktiviteti në këto muaj.

Info shitesë

Letërsia Shqipe Dhe Tranzicioni ka zhvilluar në këtë muze Diskurs kulturor.

Departamenti i letërsisë në Fakultetin e Shkencave Shoqërore në Universitetin e Shkodrës “Luigj Gurakuqi” organizoi në datat 5, 8, 9 dhe 12 korrik 2021 aktivitetin: “Letërsia shqipe dhe tranzicioni”.

Takimi i parë u realizua më 5 korrik, ora 11.00 tek Vendi i Dëshmisë dhe Kujtesës, në Shkodër dhe me moderatore prof.as.dr. Valbona Karakaçi, anëtare e departamentit të letërsisë. Në këtë takim paraqiten tezat e tyre për tranzicionin në letërsi dhe në antropologji, studiuesit: Arben Prendi, përmes studimit “Fatos Kongoli” dhe Albert P. Nikolla përmes studimit “Njeriu i ri shqiptar”. Në këtë aktivitet morën pjesë edhe studentët: Elsaida Zhejani, Deada Smajlaj, Klevisa Bardeli, Laura Kasteri në vitin e dytë të programit të studimit Bachelor në Gjuhë-Letërsi.

P08220.O1.A6: Mirëmbajtje e ndërtesave të muzeve.

Këtë vit në fokusin e Bashkisë Shkodër është mirëmbajtja e ndërtesës së Muzeut Historik, banesa “Oso Kuka”.

Është hartuar dokumentacioni përkatës, përgatitja e preventivit, specifikimet teknike nga ana e specialistëve të fushës. Është realizuar mirembajtja e këtij muzeu që nga lyerja e elementeve me material dru, riparuar e lyer muret e brendshme dhe mirembajtur elemente të vecante kryesisht në katin e parë të godinës.

Info shitesë:

Me 9 mars 2021 u hap në Muzeun Historik Shkodër ekspozita "Xhubleta, nje gjuhë femërore". Në këtë ekspozitë u paraqitën objekte nga fondi etnografik i Muzeut Historik Shkodër. U ekspozuan xhubleta të zonave gjeo- etnografike të Malësisë së Madhe e të Dukagjinit. Për vëmendje të veçantë ju kushtua aksesorëve të xhubletave, si pjesë të panjohura për publikun e gjerë. Kjo ekspozitë qëndroi e hapur për publikun deri në fund të muajit prill 2021.

P08220.O1.A7: Dita Ndërkombëtare e Muzeumeve

Në kuadër të 18 majit, “Ditës Ndërkombëtare të Muzeumeve”, Muzeu Historik Shkodër organizoi një takim me temë “Libri në kujtesën e një muzeu”.

Të ftuar ishin Dr. Gëzim Puka, pedagog i letërsisë në Universitetin e Shkodrës “Luigj Gurakuqi”, i cili paraqiti temën “Një panoramë për kuptimin dhe domethënien e librit në muze”, si dhe Z. Gjovalin Çuni me temën “Bashkohësia në muze, vështrim mbi një bibliotekë”.

P08220.O2.A1: Zhvillimi dhe pasurimi i fondit të bibliotekës

Zhvillimi dhe pasurimi i bibliotekës është një nga synimet paresore të institucionit tonë, i cili synon pasurimin me libra dhe shtypin e shkruar sa më bashkohore dhe të rëndësishëm, tituj të cilët zgjedhen me kujdes nga stafi i bibliotekës, në bazë të kërkesave të lexuesve dhe botimeve të fundit nga shtëpitë e ndryshme botuese të librit. Është realizuar blerja e librave me shumën 560 740 lekë, janë blerë 235 tituj librash, në total 602 libra dhe është realizuar blerja e shtypit të shkruar në shumën 63.070 lekë.

P08220.O2.A2: Administrimi dhe menaxhimi i Degës Ekonomike të Kulturës.

Janë realizuar pagesat për pagat e personelit dhe pagesat e sigurimeve shoqërore si dhe shpenzime për shërbime nga të tretë (Energji, ujë);

Në mirëmbajtjen e ndërtesës së bibliotekës, është realizuar ndërhyrja në izolimin e tarraces, është punuar në sallën e mediatekes dhe është ndryshuar komplet ambienti, në mënyrë që të bëhet i mundur krijimi i “Muzeut të Librit”, është rikrijuar sistemi i ndricimit të sallës, është riaftësuar parketi i drurit në dy salla të bibliotekës. Është lidhur kontrata vjetore për shërbimin telefon dhe internet dhe është realizuar për periudhën deri më 31.12.2021.

Janë paguar pagat për 29 punonjës të DEK për periudhën 12-Mujore në shumën totale **16,772,326** lekë nga ku 14,365,051 lekë janë paga dhe 2,407,275 lekë janë shpenzime për sigurime Shoqërore dhe shëndetësore.

Është realizuar Sigurimi i Ndërtesës për të gjitha godinat e DEK.

Është realizuar procedura për Rimbushje fikse Zjarri për të gjitha ambientet e DEK.

Është realizuar nepermjet zyrës së prokurimit në Bashkinë Shkodër procedura e “Blerje Kancelarie”. Është realizuar procedura për mirëmbajtjen, domein dhe hostimin e 4 ëeb-pageve të DEK. U blene materiale patrimi/sanitare etj për gjitha godinat e Dek.

U realizua mirëmbajtja e sistemit të kamerave/veshgimit për Galerine e Arteve. U realizua blerja e Paisjeve TIK për Bibliotekën Marin Barleti (të tillë, si Nas, hardDrive, Q.Zeri, stative, dhe kompjuter) që ndihmojnë në përmirësimin e shërbimit në të gjithë këto institucione.

P08220.O2.A3: Periodiku Gegnia

Është realizuar mbledhja e materialeve për botimin e ri të revistës. Redaksia është angazhuar në përzgjedhjen dhe klasifikimin e artikujve. Është realizuar kontrata për shtypjen dhe publikimin e revistës. Jane publikuar numrat 14-15-16 të Revistës “Gegnia” duke realizuar objektivin e venë për tre numra të rinj në vit.

Info shitesë :

Në kuadër të javës së veprimtarive që organizohen nga Bashkia Shkodër për ditën Ndërkombëtare të Gruas, me datën 6 mars 2021, Biblioteka “Marin Barleti” zhvilloi aktivitetin “Gruaja në fokusin e letërsisë”. Në këtë aktivitet ishte e ftuar shkrimtarja Elektra Çapaliku e cila foli dhe prezantoi librin e saj më të ri “Bukë e Krypë e Zemër”.

P08220.O2.A4: Festivali letrar i Shkodrës, edicioni i 14-të.

Në kuadrin e festivalit Letrar të Shkodrës, Biblioteka Publike “Marin Barleti” organizoi në muajin nëntor 2021, për katër javë rresht, veprimtari ku ishin të ftuar shkrimtarë shumë të

njohur shqiptarë. Këto veprimtari ishin konceptuar në formën e një bashkëbisedimi për veprat e autorëve, por edhe për çështje të letërsisë dhe të artit në përgjithësi.

Takimi i datës 6 nëntor 2021 kishte të ftuar shkrimtarin Virion Graçi, poet, romancier e studiues, i cili ka prej më shumë se 30 vite një veprimtari intensive letrare. Është shkrimtar që lëndën letrare e merr nga historitë e përditshme të Shqipërisë së pas '90-ës. Boton në moshën 23 vjeç romanin e parë “Të çmendur në parajsë”, përkthyer nga Gallimard në Francë, duke pasuar me dymbëdhjetë romane, mes të cilave “Stina e hijeve” shpallet romani më i mirë i vitit 2014. “800 hapa larg Venerës” është romani i fundit i tij, botuar më 2020.

Autori paraqiti aspekte të veçanta të punës së tij si krijues letrar si dhe mendime rreth zhvillimeve dhe sfidave të letërsisë bashkëkohore shqiptare.

Takimi u moderua nga Dr. Ermira Alija, pedagoge në Departamentin e Letërsisë.

Në bisedën e datës 13 nëntor 2021, protagonist ishte shkrimtari i mirënjohur Virgjil Muçi, veprimtaria letrare e të cilit është tejet e gjerë dhe e larmishme. Autor i më se 10 librave, me një krijimtari që zë fill me prozën e shkurtër e të gjatë, për të vijuar më pas me poezinë, kinematografinë dhe, së fundi, edhe në lëmin e kritikës letrare. Kontributi i tij është i ndryshëm edhe në fushën e përkthimit me rreth 13 tituj nga gjuhë dhe autorë të ndryshëm, si: Sontag, Lindgren, Bukoëski, Albahari, Kagan, Edgar, Rothschild, Dickens, Christie, Candito, Salleo etj. Gjithashtu ai është aktiv edhe në shtypin e përditshëm e atë periodik me shkrime kryesisht nga fusha e kulturës.

Gjatë bisedës që u moderua nga Dr. Ermira Alija, shkrimtari Virgjil Muçi, krahas përvojës së tij të gjërë në krijimtarinë letrare, paraqiti veprën e fundit “Fajin ma ka gjuha”, një cikël me tregime që siç e cilëson ai i kushtohet dashurisë dhe jetës. Autori theksoi nevojën rritjes dhe diversifikimit të kanaleve të komunikimit ndërmjet lexuesve dhe shkrimtarëve dhe vlerësoi festivalin si kontributor në këtë aspekt.

Me datën 20 nëntor 2021 u zhvillua biseda me shkrimtarin Ylljet Aliçka. Ai është autor i librave: “Tregime”, “Kompromisi”, “Parullat me gurë”, 2003, “Rrëfenje me ndërkombëtarë”, “Koha e puthjeve”, “Valsi i lumturisë”, “Metamorfoza e nje kryeqyteti”. Përkthimet e librave të tij janë shfaqur gjithashtu në frëngjisht si “Les slogans de pierres, Castelnau-Le-Lez” dhe në polonisht si “Kompromis”, Sejny. Veprat e tija janë nderuar me shumë çmime kombëtare e ndërkombëtare. Ndër të tjera, tregimi “Parullat në gur”, u filmua dhe u nderua me Çmimin e Rinisë në Festivalin e Filmit në Kanë, 2001. Përveç profilit si shkrimtar, ai ka një karrierë të pasur si doktor i shkencave natyrore por edhe si diplomat, përfaqësues i vendit tonë në shtete dhe në organizma të ndryshme ndërkombëtare. Autori me një gjuhë të thjeshtë dhe tërheqëse paraqiti para lexuesve shkodrën përvojën e tij origjinale si shkrimtar duke evidentuar ngjarje, situata nga jeta e përditshme dhe duke i kthyer në art.

Biseda me shkrimtarin Arian Leka me datën 7 dhjetor 2021, mbylli serinë e takimeve të Festivalit. Ai është një nga shkrimtarët më të lexuar dhe vlerësuar kohët e fundit në fushën e poezisë, prozës, gjithashtu dhe studimeve letrare. Vepra e autorit është e përkthyer në nëntë gjuhë dhe krijimtaria e tij është e vlerësuar me çmime kombëtare e ndërkombëtare. Deti zë një vend të dukshëm në shkrimet e tija të cilat lidhen edhe me ndjesitë vetjake jetësore duke qenë se është nga qyteti bregdetar i Durrësit. Ndër botimet më të rëndësishme të tij veçojmë: “Anija e Gjunit”, poezi, “Gjarpri i Shtëpisë”, roman, “Strabizëm”, poezi, “Shpina e Burrit”, “Ndreqje gabimesh”, “Realizëm socialist në Shqipëri”, “Lindur në provincë”, “Në kërkim të këmishës së humbur”, etj. Ndërkohë është marrë me përkthime, kryesisht nga letërsia italiane. Arian Leka është themelues i Festivalit ndërkombëtar “Poeteka e Durrësit” si dhe botues i revistës me të njëjtin emër.

Gjatë bisedës ai sqaroi se qëllimi i krijimtarisë së tij është memorizimi i ngjarjeve, përcjellja e tyre në mënyrë artistike tek lexuesit. Analizave të tij nuk i shpëtojnë ngjarjet kryesore politike të lidhura me vendin tonë dhe hapsirave ballkanike të cilat autori arrin t'i trajtojë profesionalisht pa rënë në pozitë e një analisti politik.

Dy takimet e fundit u moderuan nga z. Gjovalin Çuni, studiues i letërsisë.

Gjatë diskutimeve u morën mendime për ecurinë e mëtejshme të Festivalit Letrar në mënyrë që të përfshijë sa më shumë lexues dhe ti shërbejë sa më shumë rritjes së interesit për librin dhe letërsinë, gjë që është një nga qëllimet kryesore të kësaj veprimtarie.

Përgjatë 4 javëve, Festivali Letrar u ndoq me interes të madh nga të ftuarit, shkrimtarë, pedagogë, studentë, dashamirës të letërsisë e të artit, etj, të cilët bënë pyetje dhe komentuan aspekte të ndryshme rreth zhvillimit të letërsisë dhe të artit.

(Afërsisht 120 persona ndoqën veprimtaritë e Festivalit në mënyrë të drejtpërdrejtë). Gjithashtu Festivali u përcoll nga të gjitha televizionet lokale, dhe pati një audiencë të mirë në rrjetet sociale.

Info shtesë:

Prezantim i librit **“Rrënjët&Malet e Malësisë së Madhe”** i autorit **Gjon Frani Ivezaj**.

Me datën 22 korrik 2021, në mjediset e bibliotekës "Marin Barleti" u prezantua libri **“Rrënjët&Malet e Malësisë së Madhe”** i autorit Gjon Frani Ivezaj. Kjo veprimtari u zhvillua në kuadrin e bashkepunimit që ka Biblioteka me shqiptarët e Malit të Zi. Me këtë rast morën pjesë shumë bashkatdhetarë nga trevat e Malit të Zi. Libri që u prezantua është frut i një pune kërkimore shkencore që autori ka bërë në vazhdim të botimeve të tjera të mëparëshme që po ashtu kanë si objekt studimi kryesisht zonën e Malësisë së Madhe por që përfshijnë në shumë raste edhe treva të tjera të banuara nga iliro-shqiptarët.

Libri që u prezantua trajton specifikisht historinë e Malësisë së Madhe të ndërthurur me elemente gjeografike, etnike, organizimin shoqëror e fisnor, etj.

Veprimtari kushtuar poetit të madh italian Dante Alighieri:

Me datën 15 shtator 2021, në kuadrin e 700 vjetorit të vdekjes së poetit të madh italian Dante Alighieri Biblioteka **“Marin Barleti”** zhvilloi një veprimtari ku ishte i ftuar Prof. As. Dr. Vincens Marku, pedagog i Letërsisë së Huaj në Universitetin e Shkodrës. Aktiviteti u moderua nga drejtori i bibliotekës, z. Maxhid Cungu. Prof. Vincens Marku foli mbi rolin dhe ndikimin që kanë edhe në ditët e sotme veprat e Dante Alighierit. Ai u ndal në një analizë rreth përkthimeve në gjuhën shqipe të **“Komedisë hyjnore”**. Në bisedë morën pjesë pedagogë, studiues, përkthyes, të cilët trajtuan veprën e Dantes nga këndvështrime të ndryshme. Një ndër përkthyesit e **“Komedisë hyjnore”**, Meritan Spahija, shprehet se në Shqipëri, Dante është përkthyer pesë herë, pa përmendur përkthimet fragmentare, në një kohë që duhet të ishte shumë herë më tepër, pasi çdo kënvështrim sjell diçka të re. Veprimtaria u ndoq me interes nga rreth 40 pjesëmarrës.

*Veprimtari shkencore me rastin e 150 vjetorit të lindjes së At Gjergj Fishtës, zhvilluar nga Biblioteka **“Marin Barleti”**:*

Me datën 22 shtator 2021, me rastin e 150 vjetorit të lindjes së At Gjergj Fishtës, Biblioteka "Marin Barleti" në bashkëpunim me Departamentin e Letërsisë pranë Universitetit "Luigj Gurakuqi", zhvilluan një veprimtari shkencore. Prezantimi i përmbajtjes dhe qëllimit të aktivitetit u bë nga drejtori i Bibliotekës "Marin Barleti" z. Maxhid Cungu i cili ia dha fjalën e përshëndetjes Provincialit Françeskan At Pashko Gojçaj si dhe Rektores së Universitetit "Luigj Gurakuqi" Prof. Suzana Golemi. Më tej veprimtaria u moderua nga Dr. Ermira Alija.

Prof. As. Dr. Arben Prendi kumtoi temën "Vështrim mbi Fjalorin e At Benedikt Demës" ku evidentoi rëndësinë e Fjalorit të fjalëve të rralla shqipe dhe i fjalëve të huaja të përdorura në veprën e At Gjergj Fishtës.

Prof. As. Dr. Vinçens Marku foli për librin "Letërshkëmbimi i Fishtës". Ai paraqiti përvojën e tij si përkthyes i letrave të At Gjergj Fishtës me At Pal Dodaj duke evidentuar edhe faktin që figura e At Gjergj Fishtës do të njihet më mirë nëpërmjet botimit të Letërshkëmbimeve.

Zj. Magdalena Haxhi kumtoi temën "Gjurmë të At Gjergj Fishtës në bibliotekën "Marin Barleti" ku hodhi dritë mbi librat, dorëshkrimet dhe njësi të tjera arkivale që kanë të bëjnë me At Gjergj Fishtën.

Me këtë rast u organizua **ekspozita "Fishta në fondet e Bibliotekës "Marin Barleti"**.

Në këtë veprimtari morën pjesë rreth 30 persona: studiues, pedagogë, studente, miq të librit dhe Bibliotekës, etj.

Prezantimi i librit "**Dorëshkrimet e fshehta të burgut**" të shkrimtarit **Visar Zhiti**.

Me datën 24 shtator 2021, Biblioteka "Marin Barleti" organizoi promovimin e librit "Dorëshkrimet e fshehta të burgut" të shkrimtarit Visar Zhiti. Autori ka përmbledhur në këtë libër dorëshkrimet e bëra gjatë periudhës kur ishte i burgosur në burgun e Spaçit. Shkrimtari, gjatë bisedës së tij tha se krijimtaria e tij nuk është e redaktuar dhe se lexuesit kanë mundësinë të përfshihen direkt në atë çfarë shkrimtari ka përjetuar gjatë kohës së dënimit. Në këtë libër, shkrimtari Visar Zhiti, ka përmbledhur në disa faqe vuajtjet e përjetuara në burgun famëkeq por ka dashur të tregojë edhe anën e brishtë dhe njerëzore e cila e ka shoqëruar në një mjedis të jashtëzakonshëm, siç e quan ai. Aktiviteti u ndoq me shumë interes nga rreth 40 pjesmarrës.

P08220.O2A5: Të shkruajmë për fëmijë.

Biblioteka Publike "Marin Barleti" në periudhën tetor-dhjetor 2021 ka zhvilluar projektin "Të shkruajmë për fëmijët". Projekti ka në fokus nxitjen e talentëve të reja në fushën e letërsisë sidomos asaj për fëmijë. Projekti shërben edhe si një ndihmesë për mësuesit e letërsisë për krijimin e një frymë interesimi dhe vëmendje të nxënësve për lëndën e letërsisë.

Në projekt janë përfshirë kryesisht nxënësit e shkollave 9 vjeçare të qytetit Shkodër të cilët janë identifikuar paraprakisht nga mësuesit e tyre për prirje të veçanta për krijimtari në fushën e letërsisë. Në këtë kuadër, në ambientet e bibliotekës u zhvillua fillimisht një proces përzgjedhjeje nga shkollat 9-vjeçare, me pjesëmarrjen edhe të mësuesve të letërsisë.

Kjo veprimtari u drejtua nga prof.Elinda Ramadani (Dibra) dhe qellimi kryesor ishte puna me të rinj letrar për të mësuar se si mund të shkruajmë për fëmijë. Në këtë aktivitet, që zgjati për 6 javë, morën pjesë 60 të rinj, nga ku 35 vajza, dashamirës të shkrimit për fëmijë dhe produktet e tyre me të zgjedhura, krijime në formën e poezisë dhe prozës, do të botohen në numrat në vazhdim të revistes Gegnia apo dhe në rrjetet sociale të bibliotekës Marin Barleti.

P08220.O3.A1: Administrimi dhe Menaxhimi i Teatrit "Migjeni"

Institucioni i Teatrit “Migjeni” në strukturën e tij përbëhet prej 37 punonjësish. Janë realizuar pagesat për Pagat e personelit dhe pagesat e sigurimeve shoqërore si dhe shpenzime për shërbime nga të tretë (Energji, ujë) dhe Qendra e Kulturës “Pjetër Gaci” ka 4 punonjës. Janë paguar pagat dhe sigurimet shoqërore të tyre si dhe shpenzime për shërbime nga të tretë (Energji, ujë).

P08220.O3.A2 Orkestra Frymore Honorare vjetore

Formacioni i Orkestrës Frymore është një nga vlerat e veçanta artistike unike që ka qyteti ynë. Ky formacion është i përbërë prej 40 muzikantëve të cilët realizojnë prova gjatë javës dhe performanca sipas planit vjetor. Ato janë mbështetur me honorare për 11 muajt e vitit.

P08220.O3.A3 Grupi orkestror i Qendrës Kulturore

Janë kryer pagesat mujore për Grupin Orkestror të qendrës “Pjetër Gaci”, i cili ka përgatitur dhe ka performuar 3 koncerte gjatë stinës së verës dhe 1 në muajin dhjetor.

P08220.O3.A4: Çmimi “Pjetër Gaci”

Bashkia Shkodër dhe Qendra Kulturore “Pjetër Gaci” organizuan: Çmimi “Pjetër Gaci”, edicioni XX.

Konkursi Pjetër Gaci, Edicioni i XX-të u zhvillua në datat 13-16 Maj. Për shkak të kushteve të pandemisë, edhe edicioni i sivjetshëm u zhvillua online. Informacionet për këtë aktivitet u dërguan të gjithave shkollave artistike në Shqipëri, Mal i Zi, Kosovë, Maqedoni, Itali, Slloveni, Austri, Kroaci, etj. Mundësia e një edicioni “Online” krijoi kushtet për mundësimin e pjesëmarrësve nga vende të ndryshme, nga Italia, Spanja, Austria, Indonesia, Serbia, Maqedonia, dhe rajoni. Mbi 50% e pjesëmarrësve kanë qenë aplikues nga rajoni dhe më gjërë. Të gjitha aplikimet janë bërë nëpërmjet faqes së internetit të konkursit: ëëë.pjetergaci.al

Në këtë edicion kanë aplikuar 176 konkurentë.

Finalistët kanë qenë:

1. Hillari Parangoni Category B - 2011 PIANO
2. Kevin Kaci Category B - 2010 PIANO
3. Elsa Gashi Category D - 2006
4. Martin Xuxi Category C - 2008 - Violin
5. Leonardo Dimovski Category E - 2004 Violin
6. Leyre Barrós Catena Category F - 2002 Violoncel
7. Mar Gimferrer - Category F - 2002 Violoncel

Çmimi “Pjetër Gaci” këtë vit është Exequo, pasi morën vota të barabarta Mar Gimferrer – Violoncel dhe Leyre Barros – Violoncel.

P08220.O3.A5: “Ahengu Shkodran”

Në ditën e trashëgimisë kulturore, me 29 shtator, organizohet aktiviteti tradicional “Ahengu Shkodran”. Ky aktivitet organizohet nga Bashkia Shkodër, Qendra Kulturore “Pjetër Gaci” në bashkëpunim me Teatrin Migjeni dhe Muzeun Historik.

Qëllimi i këtij aktiviteti është ruajtja e origjinalitetit të këngës popullore shkodrane e krijuar ndër vite dhe transmetimi i saj tek artistët e rinj.

Nga viti në vit ka patur interes nga artdashësit e shumtë të këngës popullore shkodrane duke sjellur herë pas here risi e bashkëpunime artistike.

Edhe këtë vit ndonëse në kushtet e një pandemie të gjatë interesi ishte mjaft i madh sa njerzit kishin ardhur rreth 1(një) orë para për të shijuar këtë mbrëmje kushtuar “Ahengut Shkodran”.

Artistë dhe artdashës kënduan të gjithë së bashku këngët e përzgjedhura me kujdes nga drejtori artistik Bardhyl Hysa ,drejtuesi i orkestrines Ilir Zoga në bashkëpunim me këngëtarët pjesmarres.

Bëhet shumë kujdes në përzgjedhjen e repertorit mundësisht duke sjellë këngë të padëgjua apo të harruara nga koha me interpretime të reja që fatmirsisht shkodres nuk i mungojnë. E rëndësishme është që këngët të vijnë sa më të pastra,origjinale në tingëllim dhe interpretim

Mund të përmendim si risi

1. “Besa besë” e Dom Zef Shehanit e kënduar me emocion nga dueti Laorjan Ejlli dhe Megi Toma,
2. “Ti je yll i bukurisë” e Jonuz Gushtes (dedikuar gruas së tij të bukur) e kënduar nga Ademir Fresku
3. “Kur e merr buljeren” e Prenkë Jakoves kënduar nga Martina Serreqi
4. Ritualin e këngëve të dasmave kënduar nga grupi vajzave shoqëruar nga grupi i valleve
5. Gjithashtu dhe grupi i “Karajfilave”që me pasion shoqëron pothuajse gjithë repertorin e kësaj mbrëmje.

Nuk i mungojnë kësaj mbrëmje dhe këngëtarët e afirmuar tashmë për këngën popullore qytetare Bujar Qamili (Mjeshtër i madh) Blerta Cina,Rezarta Smaja,Xhuli Pjetraj,Adelina Correj,Klinsman Llazani, Ivan Tanushi,Leonard Guga, Klodiana Vata,Niki Mjeda,Eldis Arnjeti,Bruna Sata etj, që u shoqëruan në mnyrë korrekte nga orkestrina e teatrit “Migjeni” Duhet përmendur që e gjithë kjo trupë me rreth 30 pjesmarres është e gjitha e veshur me kostume kombëtre duke ju përshtatur tipologjise së aktivitetit. Me këtë rast apelojmë që të ruajmë dhe të mirmbajmë dhe t’a pasurojmë garderoben që gjindet pranë Qendres Kulturore “Pjetër Gaci” si një trashëgimi kulturore bashkë me këngën e bukur të saj.

P08220.O3.A6: Honorare Grupi i Valleve

Grupi i Valleve përbëhet prej 12 personash, të cilët janë mbështetur me honorare për 11 muajt e vitit. Grupi i valleve ka performuar në festa të ndryshme të Bashkisë Shkodër, kryesisht gjatë muajve të verës dhe Javes se Pavarësisë.

P08220.O3.A7: Festivali i Këngës Qytetare “Luleborë”.

Që prej vitit 2016, qytetit tonë iu rikthye një traditë e vjetër, Festivali “Luleborë”. Ky aktivitet organizohet nga Bashkia Shkodër, Qendra Kulturore “Pjetër Gaci” dhe Teatri Migjeni. Festivali Luleborë u zhvillua në datat 29 dhe 30 Tetor 2021 në sallën e Teatrit Migjeni.

Këtë vit ishte edicioni i tij i gjashtë, i cili solli një ndryshim duke u kristalizuar në festivalin e muzikës së lehtë, e thenë ndryshe e muzikës POP. Ky edicion është standartizuar në tingëllime përmes orkestrimeve bashkohore duke sjellë dhe teknologji të reja në përpunimin e tingullit. Ky festival këtë vit solli edhe një standart të ri në aspektin muzikor duke seleksionuar krijimtari që sjellin risi në aspektin e gjuhës muzikore.

Drejtuës Artistik të këtij festivali ishin Shpëtim Saraçi dhe Markelian Kapidani.

Koncert maestro - Mario Deda.

Dirigjent të këtij festivali ishin: Jetmir Barbullushi, Gridi Kraja dhe Ilir Zoga.

Moderator - Enkel Demi dhe Rosela Gjylbegu

Festivali Luleborë solli 17 krijimtari të reja, të cilat u shoqëruan “Live” nga orkestra e këtij festivali me spalë z.Lorenz Radovani.

Juria e këtij edicioni përbëhej nga : Zhani Ciko, Osman Mula, Gjon Shllaku, Kozeta Kurti dhe Andris Gjoni.

Në fund, juria e kryesuar nga maestro Zhani Ciko vendosi të nderoj me çmimin e karrierës këngëtarën e shquar Justina Aliaj.

Çmimim e veçantë “Simon Gjoni” si interpretuesi më i mirë e fitoi këngëtari Laorjan Ejlli.
Çmimin e tretë e fitoi kënga, “Pa adresë” Teksti dhe muzika, Orges Toçe;Këndoi: Jozefina Simoni.

Çmimin e dytë e fitoi kënga: “S’ka ma bukur”, Teksti, muzika dhe orkestracioni: Mario Deda;
Këndoi: Saviana Vjerdha dhe Ademir Fresku.

Çmimin e parë e fitoi kënga “Si n’andërr”. Muzika dhe orkestracioni : Florent Boshnjaku;
Teksti: Arjola Zadrima; Këndoi: Rezarta Smaja.

P08220.O3.A8: “Koncert – Premierë i Orkestrës Frymore”

Meqënëse data 21 qershor është shpallur si dita ndërkombëtare e muzikës, e njohur ndryshe edhe si festa e muzikës, qendra kulturore “Pjetër Gaci” me mbështetjen e Bashkisë Shkodër, prezantuan para publikut artdashës shkodran, koncert nga trupa e Orkestrës Frymore të qytetit. Koncerti ishte konceptuar si një festë, i cili përveç repertorit klasik, u pasurua me performancat e solistëve të rinj dhe profesionist të qytetit tonë si:

Grupi “Karajfilat e Shkodrës”

Klodiana Brahimi- Soprano

Laorjan Ejlli

Megi Toma

Martina Serreqi

Semir Hoxha

Trupa e orkestës frymore luajti për publikun këto pjesë:

Shostakoviç- Marsh- Orkestra Frymore

“Palladio” – K. Jenkins- Orkestra Frymore

“O sole mio”- Semir Hoxha

“Neë York, Neë York”- Martina Serreqi

Momente nga muzika e filmit “Piratët e Karaibeve” - Orkestra Frymore

“Kenke nur i bukurisë” – Klodiana Brahimi

“Këndon bilbili poshtë te zalli”- L.Ejlli dhe K.Brahimi

“Un amore così grande”- Megi Toma

“Uvertura nga Opera Berberi i Seviljes” – Orkestra Frymore

Këtë vit koncerti i orkestrës frymore u drejtua nga dirigjenti i ri Ademir Lekaj nën kujdesin e veçantë të mjeshtrit Kujtim Alija.

Moderatore e aktivitetit ishte Rajmonda Marku

Drejtues Artistik- Bardhyl Hysa.

P08220.O3.A9: “Festivali Folklorik Tipologjik Kombëtar i Këngës Qytetare”

Festivali Folklorik Tipologjik Kombëtar i Këngës Qytetare është një aktivitet tashmë i kthyer në traditë, i cili organizohet një herë në dy vjet nga Ministria e Kultures dhe Bashkia Elbasan ku promovohen vlerat më të mira interpretuese dhe egzekutuese të këngës popullore qytetare. Grupi i yne i artisteve të Qendrës Kulturore Pjetër Gaci merr pjese përhera dhe u vlerësohet me cmime. Në vitin 2021 nuk eshte zhvilluar.

P08220.O3.A10: Festival burimor

Pasuria kryesore e kombit tonë është folklori muzikor ose siç quhet muzika burimore. Është e rëndësishme që këto vlera të ruhen dhe të promovohen nëpërmjet aktiviteteve të ndryshme. Bashkia Shkodër dhe Qendra Kulturore “Pjetër Gaci” organizun këtë festival me date 12.12.

2021 në sallën e Teatrit Migjeni. Ky aktivitet sjell në vëmendje origjinën e muzikës burimore, të interpretuar nga artistëve zgjedhur dhe ato të rinj.

P08220.O3.A12 : Pjese Teatrorë1

“Black Box/ Kutia e zezë” u shfaq me datën 5 dhe 6 nëntor 2021, e adaptuar për skenë nga Fatos Berisha e “Perfect Strangers” e Paolo Genovese.

P08220.O3.A13: Pjesë Teatrorë 2

Situata e pandemisë përcaktoi një qasje të re të trupës së teatrit Migjeni. Ato organizuan një festival teatror me performancë në ambiente të jashtme të qytetit. Me një qëllim të qartë që vepra letrare e Ernest Koliqit, të mishërohet me emocionin, interpretimin dhe me bukurinë e oborreve e rrugicave të Shkodrës, u performuan nga kjo trupë gjashtë shfaqje teatrore "KOLIQIANA" në ambiente të hapura të qytetit tonë.

Këto gjashtë shfaqje janë dramatizuar, vënë në skenë, dhe u interpretuan nga vetë aktorët e trupës profesionale dhe talentëve të reja.

Shfaqja e parë: "A TA LAÇË" - Dramatizuar dhe vënë në skenë nga Krist Lleshi, Linda Jarani. Interpretuan: Fritz Selmani, Lusi Bregu, Silvia Kacarosi, Arber Bala, Anrida Lopçi.

Shfaqja e dytë: "ANMIKU NË SHTËPI" - Dramatizuar dhe vënë në skenë nga: Fritz Selmani. Interpretuan: Simon Shkreli, Rezarta Smaja, Nikolin Ferketa, Sara Prençi, Aleksandër Prenga, Antonio Shllaku.

Shfaqja e tretë nga "KOPSHTI"- Dramatizuar dhe vënë në skenë nga Vladimir Doda. Interpretuan: Rajmonda Marku, Nikolin Ferketa, Luelda Stani, Ester Hysenaj, Ardit Ramaj.

Shfaqja e katërt: "TINGËLLIMET", Teatër poetik - Konceptuar dhe vënë në skenë nga Rajmonda Marku. Interpretuan: Astrit Fani, Vladimir Doda, Rajmonda Marku, Granit Halili, Marsela Mjeda, Marko Prendi.

Shfaqja e pestë: "E GJETI MBAS SHIMSHIRIT"- Dramatizuar dhe vënë në skenë nga Merita Smaja. Interpretuan: Muhamir Saiti, Niki Mjeda, Jursi Temali.

Shfaqja përmbyllëse e Festivalit teatror "KOLIQIANA" ishte me "TREGTAR FLAMUJSH" Dramatizuar dhe vënë në skenë nga Jozef Shiroka. Interpretuan: Astrit Fani, Fritz Selmani, Jozef Shiroka

P08220.O3.A13: Pjesë Teatrorë 3

Per shkak të pandemisë, rënies së numrit të spektatoreve në sallën e teatrit, që nga datat 21- 26 Qershor, "Koliqiana" u rikthye në oborret e Shkodrës. Qytetarët shkodranë hapën dyert e shtëpive për "Koliqianën" dhe dashamirësit e artit. Jane realizuar 5 shfaqje në oborret e familjeve shkodrane si ajo e Galiqve, Ali Tulës, Qashif Hoxhës, Orhan Milotit e Diana Golemi të cilët i kemi falenderuar shumë për mikëpritjen jo vetëm të trupës tonë, por dhe të spektatoreve ku në secilin oborr kanë qenë të shumtë.

Artdashësit që e kanë ndjekur këtë festival teatror, kanë qenë gjithsej 1000 vetë, ku 650 femra, dhe ka dominuar spektatori i ri.

P08220.O3.A15 : Variete

Estrada e Shkodrës u rikthye në skenën e Migjenit, pas një shkëputje gati dy vjeçare. Komedia "Koncert në Kohë pandemie" godet e thumbon kohët që po jetojmë dhe debatin për prindin me

Numër, duke bërë bashkë emra të brezit të artë të humorit me aktorë të rinj. Ismet Drishti rikthehet pas 23 vitesh si regjisor në qytetin e tij duke mbledhur mjeshtërat të mëdhenj: Zef Deda, Besnik Çinari, Drande Xhaj. Përkrah artistevë të mëdhenj luajtën edhe artistët e rinj të qytetit tonë si: Nikolin Ferketa, Fritz Selmani, Klodiana Vata, Lusi Bregu, Ketlin Pjalmi, Enejda Kruja, Aleksander Prengaj, Arbër Bala, Pëllumb Gjonaj.

Estadës nuk i mungoi kënga, mbasi në skenë u ngjiten artistët Rezarta Smaja, Laorjan Ejlli, Ketlin Pjalmi, Klodiana Vata.

Komedia "*Koncert në Kohë pandemie*" u shfaq për publikun për 7 netë rradhazi.

P08220.O3.A16: Shfaqje për fëmijë+ Teatri i kukullave

Teatri Migjeni prej disa vitesh ka si prioritet rikthimin e traditës së shfaqjeve për fëmijë dhe teatrin e kukullave, si mënyra më e mirë e afrimit të fëmijëve me teatrin.

Gjate vitit 2021 teatri i kukullave shfaqti premierat e "Kush e hëngri mjaltin" dhe "Maçok Çamarroku" për disa javë rradhazi, duke mbushur plot oborrin e Teatrit Migjeni.

Këtë vit "Shfaqja për Fëmijë" erdhi ndryshe nga herët e tjera, mbasi për publikun e vogël këtë vit ishte zgjedhur të shfaqeshin edhe filma të animuar. Ky aktivitet u zhvillua në oborrin e Teatrit Migjeni dhe në shëtitoren e Shirokës gjate muajve korrik dhe gusht 2021.

P08220.O3.A17: Pranverë me këngë

Me 28 maj 2021, në oborrin e teatrit Migjeni u zhvillua koncerti "Pranverë me Këngë".

Me një pjesëmarrje të gjërë të publikut, në skenë interpretuan këngëtarët, Rezarta Smaja, Laorjan Ejlli, Orjeta Kelaj, Leonard Guga, Blerta Cina, Ylber Tahiri, Leonora Luca, Ademir Fresku, Ketlin Pjalmi, Niki Mjeda, Glerdit Turmetaj, me udhëheqës artistik Ilir Zoga.

P08220.O3.A19. Honorare aktorë të teatrit të kukullave.

Këtë vit teatri i kukullave shfaqti premierat "Kush e hëngri mjaltin" dhe "Maçok Çamarroku". Janë realizuar 8 shfaqje për fëmijë, me pjesëmarrjen e 357 spektatorësh të vegjël. Për këtë aktivitet janë afruar dhe aktorëve të rinj amatorë të cilët janë mbështetur me honorare.

P08220.O3.A20: Dita e Luleve 6 Maj

Këtë vit dita e luleve u organizua nga Qendra Kulturore "Pjeter Gaci" dhe Teatri "Migjeni". Përgatitja për ditën e luleve filloi ditë më përpara, pasi Drejtoria e Kulturës kishte bërë një thirrje për pjesëmarrje për të gjithë bizneset të cilët merren me kultivimin e luleve, për tu bërë pjesë e panairit të luleve gjatë ditës së 6 majit.

"Dita e Luleve"- 6 Maj, filloi me "Panairi i luleve"- i vendosur në sheshin para Bashkisë Shkodër. Panairi i luleve u hap në orën 10:00 dhe qëndroi deri në orën 14:00. Shumë subjekte morën pjesë me standat e tyre me lule duke krijuar një larmishmëri të madhe buqetash me lule. Gjatë paradites, aktivitetit "Dita e Luleve" iu bashkua edhe aktiviteti i Qendrës Kulturore të Fëmijëve "Bilbilat e Vegjël të Shkodërs Këndojnë 2021" edicioni i 26-të. Ky edicion ka përfshirë rreth 1000 fëmijë të shkollave 9-vjecare, dhe në ditën e luleve konkurruan 26 këngëtarë finalistë, ku 21 ishin konkurrentë vajza. Sheshi ishte mbushur plot nga qytetarët, fëmijë të grupmoshave të ndryshëm, të cilët pritën shumë mirë këtë koncert. Koncerti zgjati nga ora 10:00 deri në orën 13:30.

Dita e luleve u përmbyll pasditen e datës 6 maj me koncertin e grupit muzikor më të ri në qytet: "N'Gen". Është një risi në qytetin tonë ndërtimi i një grupi të tillë. Grupi N'Gen solli tek publiku

artdashës, përmes tingëllimeve moderne të jazz- it dhe të Fusion- it, muzikën tonë popullore, këngët më të dashura për publikun si: Pranvera filloj me ardhë (latin style); S'ka ma t'bukur se Pranvera (Funk); Marxhelò (Buleria/flamenco); Napoloni (Latin); Faja (Sëing); Lule t'bukra ka Tirana (Salsa); Synin si Qershia (Bolero); Aman Kaçurrelat e tu (modern jazz/Funk). Nuk munguan pjesë nga repertori i huaj: Footloose; i can't stop loving you; Spain; ëalking by my self etj.

Në këtë koncert morën pjesë 12 këngëtarë:

Jozefina Simoni, Silvia Kacarosi, Margerita Shllaku, Viki Haxhi, Xhuli Pjetraj, Ingrid Havalja, Rezarta Smaja, Laorjan Ejlli, Ylber Tahiri, Ademir Fresku, Jetmir Banishta, Aleksander Tuka. Së fundi, Grupi n'Gen është i përbërë nga muzikantë të rinj të qytetit tonë dhe ka si qëllim të ushqejë bashkëpunimin mes të rinjve. Grupi n'Gen ka në formacionin e tij:

Pianoforte- Antonio Fjerca

Kitarrë- Daniel Prendi

Bas Elektrik- Bled Doçi

Perkursione- Antonio Shllaku.

Koncerti u zhvillua para sheshit të Bashkisë Shkodër filloi në orën 19:00 dhe zgjati rreth dy orë.

Grupi n'Gen drejtohet nga kompozitori Markelian Kapidani në kuadër të nismave të Qendrës Kulturore Pjetër Gaci në Shkodër.

P08220.O3.A21: Ndërmendje

Pas një viti mungesë për shkak të pandemisë, në sallën e Teatrit Migjeni u rikthye koncerti gala i fundvitit “Ndërmendje”. Ky aktivitet organizohet nga Bashkia Shkodër, Qendra Kulturore “Pjetër Gaci” dhe Teatri Migjeni. Ndërmendje 2021 u zhvillua me datë 30 Dhjetor 2021.

“Ndërmendje” e hapi mbrëmjen e saj me një recitim nga Hea Lohja, e cila është fituese e konkursit Fjala Artistike 2021. Ajo me brishtësinë e saj solli për publikun pjesën “Dashuria dhe Lumturia” të autorit italian Roberto Benigni.

Ndërmendje 2021 solli për publikun pjesë të ndryshme klasike, të kompozitorëve më të mirë ndërkombëtar, të cilët shërbyen si sfond për sjelljen ndërmend të arritjeve të bashkisë Shkodër gjatë gjithë vitit 2021.

Një premierë e një veper e re të kompozitorit Markelian Kapidani u vu në skenë për herë të parë , i cili performoi bashkë me orkestrën,nën shoqërimin e korit polifonik “Prenkë Jakova”. Pjesë e këtij koncerti këtë vit u bë edhe grupi N’Gen, të cilët përformuan për publikun pjesë të muzikës popullore por me arranjime moderne.

Nën shoqërimin e duartrokitjeve të publikut, orkestra nën drejtimin e maestro Jetmir Barbullushi, përformoj dy pjesët e fundit për këtë koncert,marshin e Fiskuturistave të Prenkë Jakovës dhe marshi i Radetzkyt nga Strauss.

Spalë e orkestrës Lorenz Radovani .

Dirigjent i orkestrës Jetmir Barbullushi , Moderator Ergys Kavaja.

P08220.O3.A22: Aktivitete me rastin e 2 Prillit

“2 Prilli” është ngjarje e cila shënoi një ndër revoltat më të mëdha në vend duke i dhënë fund komunizmit në Shqipëri.

Në kuadër të ditës përkujtimore të “2 Prillit” në sheshin që mban edhe emrin e kësaj revolte, u organizua ceremonia e vendosjes së kurorave në nderim të dëshmorëve të demokracisë. Shoqëroi homazhet Orkestra Frymore e Bashkisë Shkodër.

Në këtë ceremoni morën pjesë, Kryetarja e Bashkisë Shkodër, znj. Voltana Ademi, Presidenti i Republikës, z. Ilir Meta, zv.Kryetari i Partisë Demokratike z. Edi Paloka, Kryetari i Partisë

Demokratike Shkodër, z. Xhevdet Amuli, kandidatët për deputet të partive politike, përfaqësuesit e shoqatës “2 Prilli”, shoqata e të përndjekurve politik, familjarë të dëshmorëve. Në mbarim të ceremonisë, aktorja e Teatrit Migjeni, znj.Raimonda Marku, interpretoi poezinë e At Gjergj Fishtës “Të lumët ata që dhanë jetën”.

P08220.O3.A23: Festival Jazz-i.

Projekt i fituar nga Shoqata Kulturore “Rrok Jakaj”, realizoi “Shkodra Jazz Festival”. U prezantua i integruar brenda dhe “Rrok Academy”, i cili ka si synim edukimin e brezave të rinj me muzikën Jazz, Klasike dhe “Neë Technology”- Shkrimi Muzikor, përmes leksioneve intensive të drejtuara nga profesionistë të fushës.

“**RROK ACADEMY**” filloi në datat 09-15 Gusht 2021, degën “Neë Technology” mbi teknikat e Shkrimit Muzikor. Kurset u mbajtën në ambjentet e Qendrës Rinore “Atelie”.

09-18 Gusht 2021, dega fizarmonikë i drejtuar nga Bardh Jakova. Kurset u mbajtën në ambjentet e Qendrës Rinore “Atelie”.

16 – 29 gusht 2021 u zhvilluan degët Klasike drejtuar nga Paçalin Pavaci. Kurset u mbajtën në ambjentet e Galerisë së Arteve Shkodër.

16 – 29 gusht 2021 dega Jazz , drejtuar nga Markelian Kapidani. Kurset u mbajtën në ambjentet e Qendrës Rinore “Atelie”.

Janë realizuar plot 10 koncerte gjatë muajit gusht, në pikat kryesore të qytetit, me artistë me famë ndërkombëtare, duke i dhënë gjallëri dhe argëtim qytetit dhe qytetarëve.

P08220.O3.A24: Koncertet e Verës

Koncertet e Verës këtë vit janë organizuar nga Qendra Kulturore “Pjetër Gaci” dhe Teatri Migjeni

Koncertet e Verës janë aktivitete të cilat publiku i Shkodrës i pret me kënaqësi. Këtë radhë u shfaqën 4 koncerte, dy prej të cilëve u mbajtën nga grupi “N'Gen”, ndërsa dy të tjerë u mbajtën, njeri nga grupi Rock The Four Band & Doc dhe tjetri nga kuarteti klasik i harqeve- Gabriel.

Këto dy koncerte, grupi n'Gen solli arranzhime të reja këngësh plot me ritëm e gjallëri.

"The Four Band & Doc, grup tashmë i njohur për publikun e qytetit tonë, performoi një spektakël plot vrull dhe energji në sheshin kryesor të qytetit.

Kuarteti Gabriel solli një koncert tepër të vecantë të muzikës klasike dhe jo vetëm, që u zhvillua në oborrin e muzeut historik “Oso Kuka”.

Kuarteti performoi me një repertor të përzier klasik dhe modern "duke ja shkelur syrin" disa arranzhimeve mjaft interesante të bëra me mjeshtëri nga një autor i cili për dëshirë të vetë muzikantëve të kuartetit ngeli nën vellon e misterit. Koncerti u prit shumë mirë nga spektatori shkodran.

P08220.O3.A25: Karnavalet

Ky aktivitet do të realizohej në fund shkurti por për shkak të situatës pandemike COVID-19, masave shtërnguese për parandalimin e përhapjes së tij, u bë i pamundur realizimi i këtij aktiviteti.

P08220.O3.A27: Dita ndërkombëtare e Muzikës

Me 21 Qershor 2021, në ditën ndërkombëtare të muzikës, u mbajt një takim dhe diskutim mes kompozitorësh të qytetit si dhe nga Tirana.

Tema e diskutimit ishte “Muzika e sotme, tregut muzikor, kultivimit të saj”. U diskutua mbi problematika të ndryshme rreth botës së muzikës dhe çështjes se: a mund të veprohet për përmirësimin e gjendjes së muzikës në vendin tonë. Është hera e parë që në Shqipëri ndermerret nje iniciative e tille dhe realizohet një takim me të tillë temë. Diskutimi u hap nga ideatori i këtij takimi kompozitori Markelian Kapidani. Më tej e morën fjalën kompozitorët Gjon

Shllaku, Shpëtim Saraçi, Alfred Kaçinari etj. Pasi u trajtuan tema si: Muzika në raport me tregun e lirë; muzika dhe ambjettet shoqërore; muzika dhe mediat, muzika dhe informatika etj, diskutimi u fokusua tek muzika dhe shkolla. Nevoja për të edukuar brezat jo vetëm përmes mësimi të lëndëve të përgjithshme si Fizika, Matematika etj, por edhe përmes Muzikës, si forma më perfekte artistike për të plazmuar shpirtin e qytetarëve të ardhshëm. Nga ky takim, të gjithë të pranishmit ranë dakord që: Muzika duhet të jetë lëndë e detyrueshme pa përjashtime në të gjitha shkollat.

Në orën 19:00, para sheshit të Bashkisë Shkodër, u zhvillua koncert nga Orkestra Frymore e qytetit, nën kujdesin e Mjeshtrit të Madh, Kujtim Alija.

P08220.O3.A28: “Festa e Trashëgimisë Kulturore”- Za Fest.

Edicioni Zâ Fest edicioni 5, u organizua në datat 29, 30, 31 Korrik 2021.

Me 29 Korrik në Shirokë, koncert që solli një kombinim fantastik i muzikës së Bach me polifoninë e jugut. Të ftuar të kësaj nate ishin: Irini Qirjako, Shpat Deda nga Kosova dhe grupi nga Franca Terrenoire.

Me 30 Korrik në Gjuhadol, filloi me një aktivitet të veçantë që Za Fest zhvillon në çdo edicion “Logu i Za Fest”. Të ftuar në këtë aktivitet ishin Altin Prenga dhe Saranda Bogujevcki që ndanë me publikun historitë e tyre. Mbrëmja vijoi me tenorin Josif Gjipali dhe panistin Ekland Hasa, duke përfunduar këtë natë me e DJ Oda Haliti.

Me 31 Korrik në Kalanë e Rozafës, u zhvillua aktiviteti i fundit i Za fest edicioni i V-të. Këngët arbëreshë të Zadarit në Koraci erdhi më së bukur për publikun nga Dina Bušić dhe Melita Ivković.

Arben Bajraktaraj solli poezi dhe rrëfenja në Za Fest në muret e kalasë. Gentian Doda me baletin “Vals i Këputun” ishte risia e këtij aktiviteti. Gjon`s Tears ngriti peshë gjithë publikun e Za Fest në kala. Zëri i tij magjepsi gjithë audiencën. Vlashent Sata me bandën e tij solli këngët më të bukura nga albumet e tij. Mbrëmja u mbyll me enegjinë e Gypsy Barcelona Balkan Orchestra.

P08220.O3.A30: Lëvizja e Postrribës.

“Lëvizja e Postrribës” e njohur si lëvizja e parë antikomuniste në Shqipëri, e ndodhur më 9 shtator 1946, ishte lëvizja e atyre që nuk besuan kurrë tek komunizmi internacionalist shqiptar. Qytetarë të ndërgjegjshëm dhe të përgjegjshëm, të cilët patën vetëdijen dhe e parashikuan se komunizmi do të sillte vetëm regres në vendin tonë, u ngritën kundër forcës së madhe të diktatorit më të egër që njohu Europa.

Bashkia Shkodër edhe këtë vit organizoi aktivitetin përkujtimor të kësaj ngjarje të rëndësishme.

P08220.O3.A31: Ekspozita “Salloni i vjeshtës ”

Në Galerinë e Arteve në Shkodër me datën 25 Nëntor 2021 u hap ekspozita e “Sallonit të Vjeshtës”, edicioni XV-të me temën “Një dhomë më vete” ku bëri bashkë 65 artistë nga Shqipëria dhe Kosova.

Kuruar nga prof. asc Ardian Isufi dhe Elton Koritari, ekspozita përmbante piktura, fotografi, instalacione, dhe video -performancë. Ekspozita qëndroi e hapur deri me datën 31 Dhjetor 2021.

Pjesëmarrës nga përtej Shkodres, Kosovës, Malit të Zi dhe Maqedonisë së Veriut, sollën para publikut dhe iu nënshtruan konkursit i cili përzgjodhi fitues dy artistë: Edmond Gjipopulli me veprën në pikturë "Natë feste në shi" dhe Iden Temali me veprën në fotografi "Rezistencë"

Me nderhyrjen e kuratorëve ky edicion vjen më bashkëkohor dhe kjo solli që pjesëmarrja e artistëve të ketë rritje, por dhe pjesëmarrje kualitative.

“Salloni i Vjeshtës” është ndër ekspozitat më jetëgjata në Shqipëri dhe si e atillë ndër më të rëndësishmet, që organizohet prej 15 vitesh radhazi në Shkodër.

Pjesëmarrës këtë vit ishin:

Abaz Hado / Adnan Bushati / Adnan Kastrati / Afeida Meta / Ahmet Malevija / Albes Fusha / Aleksandër Hila / Alfred Temali / Alkida Boshnjaku / Andi Hila / Anila Hetoja / Arben Suma / Ardian Pepa / Artan Draçini / Besmira Malevija / Bib Frrokaj / Burim Myftiu / Denisa Brahim / Diomen Boriçi / Dita Krasniqi / Edis Kadija / Edmond Gjipopulli / Eliza Hoxha / Ena Bulku / Erëmirë Jahja / Ergys Vela / Ermal Baboci / Ervin Bexolli / Evarist Marashi / Fatlum Doçi / Fatmir Kadillari / Fatos Lubonja / Ferid Kola / Florian Haxhihyseni / Gazmend Kruja / Gjelosh Mitaj / Hashim Kruja / Helidon Haliti / Iden Temali / Iva Seferi / Jaser Gradeci / Jozo Koçoviç / Klevis Baja / Kristian Zara / Liljana Çefa / Lindita Gjoka / Lindita Marku / Madalena Tani / Meri File / Mikel Temo / Monika Dukaj / Nirvana Baja / Oltsen Gripshi / Ormira Lulani / Osman Demiri / Petrit Bilali / Roland Tasho / Rozafa Shpuza / Rud Faja / Servet Derguti / Sidrit Lohja / Sokol Kola / Stefan Capaliku / Teuta Lagja / Vladimir Myrtezai.

P08220.O3.A32 : Cmimi Idromeno.

Ky aktivitet ze fill që në vitin 2008 dhe pas një periudhe nderprerje rimori përsëri rrugën e prezantimit. Këtë vit si Kurator i aktivitetit ishte Znj .Beskida Djepaxhia.

Zj. Djepaxhia jeton dhe punon si artiste, kuratore dhe mesimdhënëse në Athinë të Greqisë prej shumë vitesh. Ajo është pjesë e pandalshme e ekspozitave me karakter nderkombëtar jo vetëm si artiste prezantuese por se fundmi dhe si kuratore eventesh të rëndësishme nderkombëtare të artit figurative.

Koncepti kurator i këtij edicioni ishte : *Cfare mbetet e pandryshueshme gjate ndryshimit ? / Èhat remain unchanged during the change ?*

Cfare mbetet e pandryshueshme gjate ndryshimit ? Vete ndryshimi i cili është në levizje të përhershme dhe që e bën ndryshimin të nënshtrohet atij .

Çmimi Idromeno erdhi me përpjekjen për të lidhur dy kufij që shpallën se bashku , duke gjurmuar rrugetimin e 7 artisteve dhe praktikën e tyre dhe duke i ftuar ato në dialog të hapur . Konkursi përfshiu një game të gjere mediumesh si , video, fotografi, pikturë dhe instalacion. Punimet e zgjedhura synuan të veprojnë si një sipërfaqe e kontekstit vizual dhe jo vetëm:Por si estetike me rrefime që rikujtojnë duke rimarrë histori dhe duke i shkruar ato me imagjinatën .

Ekspozita gjithashtu synoi të zgjerojë dhe të dendesoje motivet e nderlidhura dhe konceptit të ndryshimit ku elementet baze janë, historia, kujtesa, identiteti, globalizmi, prejardhja, shpirtërorja, disiplina, konsumizmi, miti .

Fitues i këtij Edicioni u shpall z.Ergyes Vela.

P08220.O3.A33: “Personazh i ftuar”- Ekspozitë personale e një personaliteti të artit pamor shqiptar të ftuar nga Galeria e Arteve e Shkodrës.

Ekspozitë personale e autorit shumë të njohur shqiptar Ardian Isufi "*Mirrors should think longer before they reflect...*"

Ekspozita kishte karakter multimedial dhe siguroi një vizitueshmëri të gjërë si nga vizitorët vendas dhe nga qytetet e tjera. Ardian Isufi radhitet ndër emrat më me zë në skenën bashkohore të artit shqiptar me një numër ekspozitash të rëndësishme brenda dhe jashtë Shqipërisë.

Ekspozita qëndroi e hapur nga data 15 maj deri më 12 qershor 2021.

P08220.O3.A34: Takimet publike- bisedat publike mbi artin dhe ëorkshop me artistë të rinj.

Të ftuar në këtë aktivitet ishin: Profesor Ardian Isufi dhe Vladimir Myrtezai.

Takimet publike janë një rast i veçantë i njohjes së veprës dhe artistit më nga afër dhe me një analizë më të thellë të rolit të artistit dhe kuratorit në jetën publike.

Ky takim u pasua nga leksione të ndara në katër pjesë të Prof. Vladimir Myrtezait me temën: "Galaktikat fluturuese të artistit A.Isufi". Studentë të katedrave të ndryshme, pedagogë, artistë etj, ndoqën nga afër këto leksione që kishin si qëllim krijimin e lidhjes mes artistit dhe rolit të veprës së tij në shoqëri.

Info shtesë :

Me 17 Qershor 2021, në ambjentet e Galerisë së Arteve Shkodër u hap ekspozita e veçantë e autorit Myftar Cubi e titulluar "Mozaik 21"

Autori në fjalë erdhi me galerinë e artit Shkodër me mbi 40 punime të gjitha në gjininë e mozaikut duke sjellë pranë publikut një vepër e cila haset rrallë në ambjentet ekspozuese pasi mozaiku njihet për vështirësinë dhe kompleksin e realizimit.

Tematika ishte kryesisht e ndarë në atë epike, lirike, erotike dhe e portretit. Ekspozita qëndroi e hapur për dy javë dhe u ndoq intensivisht nga publiku.

Me 14 Gusht 2021 në Galerinë e Arteve Shkodër u hap ekspozita personale e autores Greta Tahiraga.

Autorja në fjalë u paraqit me 33 punime të gjitha në gjininë e natyrës së qetë e titulluar "RETINENCE" dhe u kurua nga artisti dhe historjani i mirënjohur Oltsen Gripshi. Ekspozita përcolli jehonën e traditës piktoreske të shkollës së artit shkodran dhe përshkohej nga simbolika e luleve dhe frutave aq prezente në traditën shkodrane.

Ekspozita pati jehonë të gjërë mediatike dhe u përcoll nga një numër i madh vizitorësh. Ekspozita qëndroi e hapur nga dt 14-31 Gusht 2021.

P08220.O3.A35: Programe të edukimit artistik në partneritet individë dhe shoqata kulturore:

Këtë herë u realizuan për të tretin vit radhazi në Galerine e Arteve, #ProgrameteEdukimit2021 ku si qëllim ishte konceptimi dhe ndërtimi i një filmi vizatimor nga fëmijët për fëmijët, bazuar në konceptin e perzgjedhur nga kuratorja titulluar "Ngutja dhe Durimi". Ky koncept ze fill ne dy karakteristika të njeriut që janë ngutja dhe durimi te cilat zënë e formësohen që në hershmërinë e femijes .

Realizimi i shpenzimeve korrente dhe kapitale për këtë program, duke e krahasuar me planifikimin është në total 96.2%, sipas zërave kryesorë më poshtë:



Shpenzimet korrente
Shpenzimet kapitale

96.3%
31.8%



Faktorët që kanë ndikuar në mosrealizimin e fondeve të planifikuara.
Fondet e planifikuara janë realizuar në masën 96.3 %.

Realizimi i treguesve të performancës:

Aneksi nr.4 Raporti i realizimit të objektivave të politikës së programit

Periudha e Raportimit: 01.01.2021-31.12.2021

Kodi i Programit	10430	Emertimi i programit:	“Kujdesi social për familjet dhe fëmijët”.					
Qellimi 1	Mbulim sa më të plotë të territorit me Shërbime Sociale duke u harmonizuar me nevojat dhe interesat e komunitetit. Gjithëpërfshirja, pjesëmarrja, krijimi i Mundësive të Barabarta dhe Mosdiskriminimi për shkak të aftësive ndryshe, gjinisë, origjinës, minoritetit etj.:Partneriteti i ngushtë ligjor me shoqërinë civile, organizata jo-fitimprurëse, biznesin privat dhe biznesin social në veçanti.							
			**Treguesit e performancës/Produktet:					
Objektivat e politikës:	Kodi i Treguesit te Performances/Produktit	Emertimi i Treguesit te Performances***/Produktit	Niveli faktik i vitit paraardhes	Niveli i planifikuar ne vitin korent	Niveli i rishikuar ne vitin korent	Niveli faktik ne fund te vitit korent	% e Realizimit te Treguesit te Performances/Produktit	
Objektivi1	Mbulimi sa më i plotë i territorit, të Bashkisë, me shërbime sociale duke u harmonizuar me interesat dhe nevojat e komunitetit.	1	Fuqizimi i familjeve dhe qëndrueshmeri e shërbimeve të ofruara Plan Lokal Veprimi për fëmijët në situatë rruge	1	1	1	100%	
		2	Numri i fëmijëve të trajtuar në situatë rruge	70	50	60	100%	
		3	Numri i familjeve në situatë rruge të mbështetura;	50	20	160	100%	
Objektivi 2								

	Bashkëndimi dhe harmonizimi i aktiviteteve lokale me Strategjitë dhe politikat kombëtare, me institucionet në varësi të pushtetit qendror, bashkitë fqinje dhe shtetet kufitare	4	Numri i rasteve të referuara të dhunës në familje	121	80	130	150	115%
		5	Nr i përfituesve nga funksionimi i sistemit të referimit.	200	180	300	300	100%
		6	Nr i takimeve të organizuara të Ekipit Teknik ndërdisiplinor (ETN)	6	10	10	9	90%
		7	Nr. i aktiviteteve ndërgjegjësuere.	50	35	35	20	57%
		8	Nr i pjesëmarrësve në aktivitete.	500	830	830	330	40%
		9	Nr i organizatave pjesëmarrëse.	25	25	25	25	100%
		10	Numri i studentëve që zhvillojnë praktikën mësimore në Bashki.	13	12	15	15	100%
Objektivi 3	Partneriteti i ngushtë me shoqërinë civile, organizatat jo-fitimprurese, biznesin privat dhe biznesin social në veçanti për ofrimin e shërbimeve sociale për shtresat në nevojë.	11	Nr. i takimeve periodike të tryezës konsultative.	12	12	17	17	100%
		12	Nr. partneriteteve me shoqërinë civile, organizatat jo-fitimprurese,	18	25	25	23	92%
		13	Hartimi i planit lokal për lokalizimin e objektivave të zhvillimit të qëndrueshëm	1	0	1	1	100%
		14	Mbështetje financiare për familjet në vështirësi në kushtet e pandemisë së shkaktuar	553	0	0	0	
Objektivi 4	Gjithpërfshirja, Pjesëmarrja, krijimi i Mundësive të Barabarta dhe Mosdiskriminimi për shkak të aftësisë ndryshe, gjinisë, moshës, origjinës, minoritetit	15	Nr. i personave që do të marrin shërbime pranë Qendrës Komunitare për Rom dhe Egjiptian	600	500	500	500	100%
		16	Nr. i jetimëve të mbështetur me rastin e festave të fundit të vitit;	43	50	43	41	95%

		17	Nr. i femijeve dhe familjeve qe marrin sherbim ne qendren e specializuar per diagnostimin e hershem te femijëve me autizem.	15	30	20	15	75%
		18	Nr. i fushatave ndërgjegjësuese e informuese të realizuara me aktorët e sektorit dhe prindërit.	4	0	2	1	50%
		19	Nr . i aktorëve të sektorit të informuar, prindërve dhe publikut të gjerë	800	0	300	150	50%
		20	Nr. i shërbimeve ditore të ofruara.	0	0	4	4	100%
		21	Plani i Zhvillimit lokal për komunitetin rom dhe egjiptian i miratuar dhe pjesë e dokumenteve strategjike të Bashkisë së Shkodrës	1	1	1	1	100%
		22	Mbështetje financiare për familjen e të ndjerit Musaen Zeneli	0	0	1	1	100%
Objektivi 5	Fuqizimi i Institucioneve qe ofrojne Sherbime Sociale me orjentim Promovimin dhe Zhvillimin e Sherbimeve Alternative.							
		23	Nr. i Qëndrave sociale komunitare funksionale;	12	12	13	13	100%
		24	Numri i përfituesve te sherbimeve ne qendrat.	6600	6600	6600	6600	100%
		25	Nr. i Sherbimeve Alternative te ofruara.	5	5	5	5	100%
		26	Numri i femijeve dhe familjeve perfituese.	40	40	40	30	75%
Objektivi 6	Krijimi i qendres komunitare rinore per nxitjen dhe promovimin e pjesemarrjes aktive ne formim profesional e edukim, aktivitate artistike, kulturore dhe							
		27	Nr. i të rinjve përfitues në shërbimet e Qendrës Rinore.	400	1200	1100	1000	91%

	sociale për të rinjtë e Bashkisë Shkodër.	28	Nr. i shërbimeve të ofruara në qëndër për të rinjtë.	6	6	6	6	100%
Objektivi 7	Krijimi i fondit të dedikuar për mbështetjen e personave me AN në bashkërendim me Shoqërinë Civile.	29	Nr. i fëmijëve në nevojë që marrin pjesë dhe performojnë në aktivitetin artistiko-kulturor.	0	25	25	22	88%
		30	Nr. i shtëpive familje funksionale dhe në shërbim të PAN. Shërbimet e ofruara për PAN-të në shtëpi-familje;	8	8	8	8	100%
		31	Nr. i klientëve të mbështetur me shërbime;	77	79	79	79	100%
		32	Numri i personave të asistuar me pagese paaftesie	3928	4650	4400	3960	90%
Objektivi 8	Bashkërendimi dhe harmonizimi i aktiviteteve lokale me Strategjitë dhe politikat kombëtare, me institucionet në varësi të pushtetit qendror, bashkitë fqinje dhe shtetet kufitare	33	Numri i personave të asistuar me pagese invaliditeti;	3377	3550	3400	3282	97%
		34	Numri i familjeve me kryefamiljarë gra/burra të asistuar me ndihme ekonomike	1972	2550	2300	2019	88%
		35	Nr. i çerdheve	6	7	7	6	86%
Objektivi 9	Fuqizimi i Institucioneve që ofrojnë Shërbime Sociale me orientim Promovimin dhe Zhvillimin e Shërbimeve Alternative.	36	Numri i fëmijëve përfitues të shërbimit	190	310	200	190	95%
		37	Nr. i fëmijëve (vajza/djem që frekuentojnë çerdhet.	99	150	100	99	99%

		38	Numri i stafit për fëmijë	67	67	67	67	100%
--	--	----	---------------------------	----	----	----	----	------

Realizimi i produkteve:

ANEKSI nr.3 "Raporti përmbledhes i realizimit te treguesve te performances/produkteve te programit"

Emri i Grupit	Bashkia Shkodër	Kodi i Grupit	141
Programi	Kujdesi social për familjet dhe fëmijët	Kodi i Programit	10430

Kodi	Emertimi i Produktit	Njësia matese	Sasia Faktike (v. 2020)	Shpenzimet (v. 2020)	I		II		III		IV		Luhatjet ne Koston per Njesi				
					Kosto per Njesi (v. 2020)	Sasia (v. 2021)	Shpenzimet (v. 2021)	Kosto per Njesi (v. 2021)	Sasia e Rishikuar (v. 2021)	Shpenzimet e Rishikuara (v. 2021)	Kosto per Njesi e Rishikuar (v. 2021)	Sasia Faktike (v. 2021)	Shpenzimet Faktike (v. 2021)	V = IV - I	V = IV - II	V = IV - III	
1	Ndërgjegjësimit i komunitetit mbi fenomenin e lypjes.	Fushatë ndërgjegjësimit				1	100	100	1	100	100	1	82	82	82	-18	-18
2	Fushatë ndërgjegjësimit kundër dhunës me bazë gjinorë, promovimi i familjes.	Fushatë ndërgjegjësimit	10	274	27	3	450	150	3	450	150	3	370	123	96	-27	-27

3	“Modelimi i qyteteve të drejta: Integrimi i Agjendës 2030 brenda politikave lokale, në kohën e flukseve të mëdha të migrimit dhe refugjatëve.	Fushatë ndërgjegjësimi	1	610	610				1	4,403	4,403	1	613	613	3	613	-3,790
4	Mbështetje financiare për familjet në vështirësi në kushtet e pandemisë së shkaktuar	Numri i familjeve	553	2,334	4										-4	0	0
5	Fushatë ndërgjegjësimi në kuadër të ditës ndërkombëtare të gruas, ditës ndërkombëtare të të drejtave të fëmijëve, personave me aftësi ndryshe.	Fushatë ndërgjegjësimi	15	148	10	3	300	100	3	300	100	3	244	81	72	-19	-19
6	Familje Rome dhe Egjiptiane, që marrin shërbime pranë Qendrës Komunitare	Numër individësh të mbështetur	600		0	500		0	500		0	500		0	0	0	0
7	Jetimë të mbështetur me rastin e festave të fundit të vitit	Numri i jetimëve	43	351	8	50	400	8	43	416	10	41	380	9	1	1	0
8	Fëmijë që marrin shërbim në qendrën e specializuar për diagnostimin e hershëm të fëmijëve me autizem.	Numri i fëmijëve				20	1,201	60	20	1,201	60	15	915	61	61	1	1
9	“Krijimi i shërbimit të specializuar ditor për fëmijët me çrregullime të spektrit autik në Bashkinë e Shkodrës”.	Numri i fëmijëve		618		20		0	20	1,380	69	15	1,380	92	92	92	23
10	Aktivitete ndërgjegjësuese	Numër Aktivitetesh	5	185	37	5	200	40	5	200	40	2	155	77	40	37	37
11	Mbështetje financiare akorduar familjes së të ndjerit Musaen Zeneli.	Mbështetje financiare							1	100	100	1	100	100	100	100	0
12	Numri i Qendrave sociale komunitare funksionale;	Numri i qendrave	12	8,616	718	12	10,848	904	13	15,445	1,188	13	8,571	659	-59	-245	-529

13	Promovimi dhe Zhvillimi i Shërbimeve Alternative.	Fushatë ndërgjegjësimi	5	46	9	1	100	100	1	100	100	1	82	82	73	-18	-18
14	Jetimë përfitues	Numri i jetimëve													0	0	0
15	Shërbime të ofruara në qendër për të rinjtë	Numri i shërbimeve	6		0	6		0	6		0	6		0	0	0	0
16	Aktivitete gjithpërfshirëse për fëmijë në kuadër të festave të fundvitit	Numri i aktiviteteve				1	271	271	1	271	271				0	-271	-271
17	Mbështetja e trupës muzikore të Personave me Aftësi Ndryshe”	Trupa Muzikore				1	369	369	1	369	369	1	281	281	281	-88	-88
18	Numri i shtëpive familje funksionale dhe në shërbim të PAK.	Numri i shtëpive familje	8	34,224	4,278	8	36,164	4,521	8	38,253	4,782	8	35,278	4,410	132	-111	-372
19	Persona të asistuar me pagesë paaftësie dhe invaliditeti	Numër përfituesi sh	7,305	851,059	117	8,200	830,000	101	7,800	775,302	99	7,242	762,996	105	-11	4	6
20	Familje dhe individë në nevojë që përfitojnë nga skema e Ndihmës ekonomike	Numër përfituesi sh	1,972	147,709	75	2,550	140,000	55	2,300	184,798	80	2,019	180,963	90	15	35	9
21	Fëmijë përfitues të shërbimit të çerdheve	Numri i fëmijëve	190	36,935	194	310	47,227	152	222	52,166	235	222	42,501	191	-3	39	-44
22	Rikonstruksion i plotë i çerdes Manush Alimani	Numri i godinave				1		0	1		0				0	0	0

Drejtuesi i Ekipit Menaxhues të Programit	Emri	Filip Vila	Kryetari i Njësisë së Vetëqeverisjes Vendore	Emri	Voltana Ademi
	Firma			Firma	
	Data			Data	

Për vitin 2021 në Programin “Kujdesi social për familjet dhe fëmijët”, në funksion të veprimtarisë kryesore dhe përbushjes së objektivave të përcaktuara, janë parashikuar këto aktivitete.

Aktivitete/Projekte	Buxheti fillestar 000/Lekë	Buxheti i rishikuar 000/Lekë	Realizimi i Vitit 2021 000/Lekë
P10430.O1.A1 Zbatimi i Planit lokal të Veprimit për Identifikimin dhe mbrojtjen e fëmijëve në situatë rruge.	100	100	82
P10430.O2.A1. Zbatimi i sistemit të referimit të rasteve për viktimat e dhunës në familje.	200	200	163
P10430.O2.A2. Dita ndërkombëtare për familjen – 15 maj	50	50	41
P10430.O2.A3. Partneriteti me departamentin e psikologji-punës sociale dhe departamentin e infermierisë			Realizuar
P10430.O2.A4. Zbatimi i kartës evropiane për barazi gjinore.	200	200	166
Projekti: P10430.O2.A5 DEAR – “Modelimi i qyteteve të drejta: Integrimi i Agjendës 2030 brenda politikave lokale, në kohën e flukseve të mëdha të migrimit dhe refugjatëve. Një projekt advokimi udhëhequr dhe zbat (uar nga autoritetet lokale”, CSO-LA/2017/388-138. (TRASHEGUAR)		4,403	613
P10430.O3.A1. Tryeza konsultative me organizatat që veprojnë në sektorin social në Bashkinë e Shkodrës;			Realizuar
P10430.O3.A2. Aktivitet ndërgjegjësues në kuadër të ditës ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve, 20 nëntori.	50	50	50
P10430.O3.A3. Dita ndërkombëtare e fëmijëve, "1 Qeshori"			Realizuar
P10430.O3.A4. Dita ndërkombëtare e gruas, 8 marsi	150	150	121
P10430.O3.A5. Bashkëpunimi me Fondacionin “Shpresë për botën”, për përmirësimin e cilësisë së jetesës për personat që jetojnë në institucionet rezidenciale dhe familjet në nevojë.			Realizuar
P10430.O3.A6 Aktivitet ndërgjegjësues në kuadër të ditës ndërkombëtare për Personat me Aftësi të kufizuar, më 3 Dhjetor.	100	100	73
P10430.O4.A1 Fuqizimi socio – ekonomik i komunitetit rom dhe egjiptian			Realizuar

P10430.O4.A2 Shpërblim për jetimët me rastin e festave të fundvitit dhe te trashëguara	400	416	380
P10430.O4.A3 . Shërbime mbështetëse dhe riaftësuese për integrimin e fëmijëve me aftësi ndryshe në sistemin edukativ	1,201	1,201	915
P10430.O4. A3.1 “Krijimi i shërbimit të specializuar ditor për fëmijët me çrregullime të spektrit autik në Bashkinë e Shkodrës”. (TRASHEGUARA)		1,380	1,380
P10430.O4.A4 . Plani i zhvillimit lokal per komunitetin rom dhe egjiptian	200	200	155
P10430.O4.A5 Mbështetje financiare për familjen e të ndjerit Musaen Zeneli		100	100
P10430.O5.A1. Ngritja dhe vendosja në funksion e Qendrave Komunitare “Për Familjen” dhe te trashëguara	10,848	15,445	8,571
P10430.O5.A2. Shërbime alternative per femijet dhe familjen.	100	100	82
P10430.O5.A3. Ndërhyrje të integruara për përfshirjen dhe integrimin socio-ekonomik të fëmijëve dhe të rinjve pa përkujdes prindëror.			Realizuar
P10430.O6.A1 Qendra Rinore "Po të Ardhmes" (Atelie)			Realizuar
P10430.O7. A1. “Asnjë Fëmijë Jashtë”	271	271	E parealizuar
P10430.O7.A2. Mbështetja e Trupës muzikore të personave me aftësi Ndryshe.	369	369	281
P010430 .O7.A3 Shtëpi Familje për persona me aftësi të kufizuar nga Opera Madonnina del Grappa dhe te trashëguara	16,600	16,717	15,503
P10430.O7.A4. Projekti “Shpresa” për personat e braktisur dhe me aftësi ndryshe dhe te trashëguara	19,564	21,536	19,775
P010430.O8.A1. Pagesë PAK dhe Invaliditeti.	830,000	774,532	762,996
P10430.O8.A2. Ndihma ekonomike	140,000	184,798	180,963
P10430.O8.A3. Pagesë për PAK në zbatim të vendimeve të Gjykatës Gjykatës Administrative Shkalla e Parë Shkodër, Nr. 526 (754), datë 17.12.2019 bazuar në aktin normativ nr. 34 datë 03.12.2021	-	770	Proces gjyqësor në proces
P10430.O9.A1. Administrimi dhe funksionimi i cerdheve dhe te trashëguara	47,227	52,165	42,501
A.1 Shpenzime për paga dhe sigurime të punonjësve	37,202	41,278	33,300
A.2 Kancelari	95	95	80

A.3 Materiale për pastrim, dezinfektim, ngrohje dhe ndriçim	1,000	1,000	600
A.4 Furnizime me ushqime	5,300	5,985	4,905
A.5 Materiale të tjera	150	150	148
A.6 Energji elektrike	1,000	1,000	1,000
A.7 Uji	800	800	800
A.8 Internet	46	46	46
A.9 Lëndë djegëse (dru zjarri)	300	300	300
A.10 Shërbime të tjera për dezinfektim	40	40	21
A.11 Shpenzime transporti	200	200	200
A.12 Mirëmbajtje e zakonshme (Rrjetit elektrik Çerdhes Perash)	300	300	298
A.13 Mirëmbajtje (Vendosje e strehe qëndrimi për bicikleta dhe karroca)	200	200	189
A.14 Mirëmbajtje e aparateve e paisjeve teknike	40	40	E parealizuar
A.15 Mirëmbajtje të pajisjeve të zyrës	30	30	E parealizuar
A.16 Shpenzime për sigurimin e ndërtesave	40	40	39
A.17 Transferta buxhetore për individë	84	262	177
A.18 Blerje paisje TIK	100	100	100
A.19 Blerje Paisje sigurie (Kamera)	300	300	298
P10430.O9.A2. Rikonstruksioni i Çerdhes “Manush Alimani”	-	-	Parashikuar me fond për tu realizuar në vitin 2022-2023
Të Trashëguara	27,865	-	-
Totali	1,095,495	1,075,253	1,034,911

- **P10430.O1.A1** Zbatimi i Planit lokal të Veprimit për Identifikimin dhe mbrojtjen e fëmijëve në situatë ruge.

Në kuadrin e nënshkrimit të Marrëveshjes Bashkëpunimit midis MMSR, MAS dhe MPB “Për identifikimin dhe mbrojtjen e fëmijëve në situatë ruge dhe Planit Kombëtar të Veprimit “Ndihmë për Familjet dhe Fëmijët në situatë ruge”, është hartuar dhe vazhdon të zbatohet Plani lokal i veprimit, ku Bashkia (NJMF), ka përgjegjësinë kryesore për të siguruar mbrojtjen e fëmijëve dhe koordinimin e punës ndërmjet institucioneve përgjegjëse, brenda territorit të qytetit. Vazhdojnë të funksionojnë skuadrat e terrenit me përfaqësues të Bashkisë Shkodër, stafi i qendrave komunitare, përfaqësues të Policisë dhe organizatave partnere të shoqërisë civile të cilët janë trajnuar, kanë qenë dhe janë prezent në territor sipas një kalendarit të paracaktuar. Në zbatim të ligjit 18/2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”, Bashkia Shkodër po koordinon Mbledhjet e Grupit Teknik Ndërsektorial me përfaqësues nga të gjitha institucionet publike vendore dhe organizatat partnere

ku janë diskutuar rastet për çdo familje të fëmijëve në situatë rruge. Gjithashtu janë hartuar plane individuale ndërhyrjeje për fëmijët në situatë rruge me qëllim mbështetjen dhe përmirësimin e situatës së këtyre fëmijëve dhe familjeve të tyre. Nr. i fëmijëve të identifikuar në situatë rruge si dhe të mbështetur është 65 dhe numri i familjeve në situatë rruge të mbështetura është 50. Për secilën familje të identifikuar janë ofruar ndihma në veshmbathje, ushqime, asistencë ligjore, ndërmjetësim për punësim, ndihmë ekonomike, rregjistrim i fëmijëve në shkollë dhe kopshte, monitorim për frekuentimin dhe ecurinë e fëmijëve në shkollë sipas vlerësimeve dhe planeve individuale të ndërhyrjes. Në ditën ndërkombëtare të fëmijëve në situatë rruge, me datë 12 prill, u zhvillua një aktivitet ndërgjegjësues, në sheshin para Bashkisë, i cili kishte si qëllim rritjen e ndërgjegjësimit ndaj fenomenit të shfrytëzimit ekonomik të fëmijëve duke përfshirë dhe fëmijët në situatë rruge. Ky aktivitet u zhvillua në formën e një panairi ku u pasqyruan shërbimet që ofrohen pranë qendrave tona komunitare për fëmijët dhe familjet në nevojë dhe u shpërndanë materiale promocionale që përcjellin mesazhin “Mos dhuro para, dhuro kujdes”. Ky mesazh sensibilizues u përcoll edhe përmes mediave lokale dhe atyre sociale. Gjithashtu me datë 8 prill, Dita ndërkombëtare e Romëve, u zhvilluan aktivitete ndërgjegjësuese në Qendrën Komunitare Multifunksionale “Për familjen”, për të promovuar kulturën dhe traditat rome dhe njëkohësisht për të promovuar integrimin dhe përfshirjen e tyre sociale.

- **P10430.O2.A1.** Zbatimi i sistemit të referimit të rasteve për viktimat e dhunës në familje. Njësitë e qeverisjes vendore, si autoritete përgjegjëse në luftën kundër dhunës në familje, kanë detyrim ligjor ngritjen dhe funksionimin e sistemit të referimit të rasteve për viktimat e dhunës në familje (ligji nr.9669 “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare, i ndryshuar me ligjin nr.47/2018 dhe VKM nr. 334, datë 17. 02. 2011 “Për mekanizmin e bashkërendimit të punës për referimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare dhe mënyrën e procedimit tij”, i ndryshuar me VKM Nr.327, datë 02.06.2021). Në Bashkinë e Shkodrës, që në shkurt të vitit 2017, nga drejtuesit e institucioneve vendore, rajonale dhe organizatave të shoqërisë civile që veprojnë me trajtimin e rasteve të dhunës në familje, është arritur firmosja e marrëveshjes së bashkëpunimit për riorganizimin dhe ngritjen e mekanizmit të bashkërendimit të punës për referimin dhe trajtimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare dhe mënyrën e procedimit të tij. Në kuadër të ndërgjegjësimit të shoqërisë për të mos pranuar dhe për të mos toleruar ushtrimin e dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje, Bashkia Shkodër ka realizuar një sërë aktivitete për ndërgjegjësimin e komunitetit në lidhje me dhunën me bazë gjinore gjatë kësaj periudhe. Janë planifikuar, organizuar dhe zhvilluar aktivitete ndërgjegjësuese në kuadër të 8 marsit, ditës ndërkombëtare të gruas dhe në zbatim të kartës evropiane për barazi mes burrave dhe grave, të nënshkruar në vitin 2017, sipas një kalendari të paracaktuar. Janë organizuar aktivitete sensibilizuese, informuese, të shpërndara në Qendrat Komunitare “Për Familjen”, shkollat e Bashkisë Shkodër, Qendrën Rinore Atelie dhe institucionet kulturore të Bashkisë Shkodër si: Biblioteka “Marin Barleti”, Muzeu “Oso Kuka”, Teatri Migjeni, Galeria e Arteve etj. Në kuadër të 16 ditëve të aktivizimit kundër dhunës me bazë gjinore janë zhvilluar 15 aktivitete sensibilizuese, informuese nën moton “Fol! Kërko ndihmë!”. Aktivitetet janë organizuar nën masa të kujdesit të

shtuar dhe në respektim të të gjithë masave për parandalimin e përhapjes së COVID- 19. Aktivitetet janë zhvilluar si në qytet ashtu dhe në njësitë administrative. Krahas këtyre aktiviteteve, fushatat e komunikimit online, me qëllim rritjen e informimit dhe sensibilizimit të komunitetit për të mos pranuar dhe për të mos toleruar ushtrimin e dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje, janë organizuar vazhdimisht përgjatë të gjithë kësaj periudhe me anë të postimeve në mediat sociale të Bashkisë Shkodër dhe Drejtorisë së Shërbimeve Sociale, Strehimit dhe Shëndetit Publik. Bashkia Shkodër për vitin 2021 ka trajtuar, menaxhuar dhe monitoruar 129 raste të reja të pajisura me urdhër mbrojtje nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër. Gjithashtu ka vazhduar trajtimi i 21 rasteve nga viti 2020. Gjatë vitit 2021 ka vazhduar ofrimi i shërbimeve për viktimat e dhunës në familje dhe konsolidimi i tyre. Për të gjithë rastet janë hartuar dhe dërguar raportet përkatëse të monitorimit çdo 60 ditë në Drejtorinë Vendore të Policisë Shkodër. Në varësi të nevojave viktimat e dhunës në familje, kanë marrë mbështetjen e duhur psikologjike dhe ligjore nga stafi i Qendrave Komunitare “Për familjen” të Bashkisë Shkodër dhe organizatat partnere që ofrojnë të tilla shërbime në Bashkinë Shkodër.

- **P10430.O2.A2.** Dita ndërkombëtare për familjen – 15 maj.

Në Ditën Ndërkombëtare të Familjes në gjithë botën organizohen aktivitete në nivel lokal, kombëtar dhe ndërkombëtar, që kanë në fokus familjen, duke e përqëndruar vëmendjen tek proceset shoqërore, ekonomike dhe demografike që prekin familjet. Gjithashtu fokusi i kësaj dite është promovimi i vlerave të familjes, nxitja e barazisë midis grave dhe burrave në familje, mbrojtja e familjes si njësi bazë e shoqërisë dhe mundësia për të ndihmuar familjet për të përmbushur përgjegjësinë e tyre për komunitetin ku bëjnë pjesë. Në territorin e bashkisë së Shkodrës, ekziston një numër i madh familjesh në vështirësi të theksuara sociale e ekonomike. Situata në të cilën ndodhen këto familje vjen si shkak i ndikimit të një sërë faktorësh si: niveli i ulët arsimor, kulturor, ekonomik, etj. Si pasojë të faktorëve të lartpërmendur, këto familje shpesh herë kanë mungesë informacioni, nuk marrin interesim për shërbimet sociale që ofrohen në territor dhe jetojnë në kushte ekstreme varfërie. Duke qenë se Bashkia e Shkodrës që nga viti 2016, arriti ngritjen dhe vënien në funksion të qendrave komunitare të quajtura ”Për Familjen”, duke parë familjen si qeliza bazë për zhvillimin e komunitetit, sivjet në kuadër të ditës ndërkombëtare për familjen është realizuar një javë me aktivitete nën moton ”Familja është aty ku është zemra”. Janë organizuar aktivitete sensibilizuese, informuese, në përputhje me temën ndërkombëtare të sivjetshme të Ditës së Familjes, “ Familja dhe Teknologjia”, të shpërndara në Qendrat Komunitare “Për Familjen”, shkollat e Bashkisë Shkodër, Qendrën Rinore Atelie etj. Aktivitetet janë organizuar nën masa të kujdesit të shtuar dhe në respektim të të gjithë masave për parandalimin e përhapjes së COVID- 19. Aktivitetet janë zhvilluar si në qytet ashtu dhe në njësitë administrative.

- **P10430.O2.A3.** Partneriteti me departamentin e psikologji- punës sociale dhe departamentin e infermierisë

Në universitetin e Shkodrës “Luigj Gurakuqi”, në degët e psikologjisë, punës sociale, fizioterapisë dhe infermierisë, çdo vit regjistrohen rreth 50 studentë në secilën degë. Në vitin e tretë të studimeve bachelor, gjatë gjithë vitit akademik, studentët zhvillojnë lëndën e “Praktikimit”. Një lëndë e tillë është me shumë rëndësi për përfitimin e njohurive praktike në fushat përkatëse. Gjithashtu pas përfundimit të studimeve në ciklin bachelor, ka shumë rëndësi praktika e njohurive të marra gjatë viteve të studimit. Bashkia e Shkodrës ka arritur një marrëveshje bashkëpunimi me Universitetin e Shkodrës “Luigj Gurakuqi”, ku pjesë e kësaj marrëveshje ka qenë bashkëpunimi për ofrimin e një praktike sa më profesionale dhe të vlefshme për zhvillimin akademik e profesional të studentëve. 13 studentë; 12 të nivelit bachelor dhe 1 i nivelit master kanë zhvilluar praktikën profesionale pranë shërbimeve sociale dhe kanë kontribuar në aktivitetet e planifikuara pranë qendrave komunitare “Për Familjen”. Aktualisht 3 studentë të tjerë po zhvillojnë praktikën profesionale në kuadër të një programi të DAP. Një eksperiencë e tillë ka rezultuar shumë pozitive për të dyja palët. Nëpërmjet institucionalizimit të këtij bashkëpunimi, studentët ofrojnë njohuritë e tyre në shërbim dhe në përputhje me nevojat e komunitetit, duke filluar kështu të fitojnë aftësitë bazë të profesionit të tyre.

- **P10430.O2.A4. Zbatimi i kartës evropiane për barazi gjinore.**

Barazia e grave dhe burrave përbën një të drejtë themelore për të gjithë dhe një vlerë thelbësore për çdo demokraci. Për t’u arritur kjo e drejtë, duhet që ajo jo vetëm të njihet me ligj, por edhe të zbatohet me efektivitet në të gjitha sferat e jetës: politike, ekonomike, shoqërore dhe kulturore. Me gjithë rastet e shumta të njohjes zyrtare dhe përparimin e bërë, barazia e grave dhe burrave në jetën e përditshme ende nuk është bërë realitet. Gratë dhe burrat nuk gëzojnë të drejta të njëjta në praktikë. Ende vazhdojnë të ekzistojnë pabarazitë shoqërore, politike, ekonomike dhe kulturore. Këto pabarazi janë rezultat i disa nocioneve shoqërore të ndërtruara mbi bazën e stereotipave të shumta të pranishme në familje, arsim, kulturë, mjetet e komunikimit, në botën e punës, në organizimin e shoqërisë. Janë aq të shumta fushat e jetës në të cilat mund të veprohet, përmes përdorimit të një qasjeje të re dhe realizimit të ndryshimeve strukturore. Për këtë, Bashkia e Shkodrës, pas nënshkrimit të kartës evropiane për barazi gjinore, është angazhuar në hartimin dhe miratimin e planit vendor gjinor si një mjet i rëndësishëm i zbatimit në praktikë të angazhimeve publike të ndërmarra nga Bashkia Shkodër në lidhje me parimet e barazisë, planifikimit dhe zbatimit të nevojave dhe të të drejtave të grave dhe burrave, të rejave dhe të rinjve, si dhe vajzave dhe djemve, nga të gjitha grupet e shoqërisë. Gjatë kësaj periudhe janë planifikuar, organizuar dhe zhvilluar aktivitete ndërgjegjësuese në kuadër të 8 marsit, ditës ndërkombëtare të gruas dhe në zbatim të kartës evropiane për barazi mes burrave dhe grave, të nënshkruar në vitin 2017, sipas një kalendarit të paracaktuar. Janë organizuar aktivitete sensibilizuese, informuese, të shpërndara në Qendrat Komunitare “Për Familjen”, shkollat e Bashkisë Shkodër, Qendrën Rinore Atelie dhe institucionet kulturore të Bashkisë Shkodër si: Biblioteka “Marin Barleti”, Muzeu “Oso Kuka”, Teatri Migjeni, Galeria e Arteve etj. Aktivitetet janë organizuar nën masa të kujdesit të shtuar dhe në respektim të të gjithë masave për parandalimin e përhapjes së COVID- 19. Aktivitetet janë zhvilluar si në qytet ashtu dhe në njësitë administrative.

- **Projekti: P10430.O2.A5** DEAR – “Modelimi i qyteteve të drejta: Integrimi i Agjendës 2030 brenda politikave lokale, në kohën e flukseve të mëdha të migrimit dhe refugjatëve. Një projekt advokimi udhëhequr dhe zbatuar nga autoritetet lokale”, CSO-LA/2017/388-138.

Në zbatim të Vendimit të Këshillit Bashkiak VKB Nr. 25, datë 18.04.2019 “Për shtesë plani në buxhetin e Bashkisë Shkodër” dhe marrëveshjes së bashkëpunimit ndërmjet Rajonit Emilia-Romania dhe Bashkisë Shkodër, po zbatohet Projekti DEAR – “Modelimi i qyteteve të drejta” CSO-LA/2017/388-138, i cili financohet nga Komisioni Evropian, në kuadër të Programit Programi DEAR - EuropeAid/151103/DH/ACT/Multi. Projekti drejtohet nga Rajoni Emilia-Romania në rolin e Liderit të Projektit dhe zbatohet në 10 shtete (8 shtete anëtare të Unionit dhe 2 shtete jo anëtarë), në një partneritet prej 18 entesh publike e private të përfshira. Qëllimi i përgjithshëm i projektit është të kontribuojë në promovimin e të kuptuarit kritik të roleve dhe përgjegjësi të autoriteteve lokale dhe të qytetarëve në arritjen e Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm (OZHQ) të Agjendës 2030, si dhe rëndësinë e lokalizimit të Agjendës 2030 nga bashkitë dhe autoritetet vendore në hartimin e politikave lokale.

Bashkia Shkodër, si partnere e projektit të sipërpërmendur, ka zbatuar projektin sipas planit të punës të dakordësuar me liderin e projektit dhe bazuar në buxhetin përkatës të vënë në dispozicion për këtë qëllim. Gjatë periudhës së raportimit në fjalë, janë realizuar të gjithë procedurat e nevojshme administrative për vijimësinë e aktiviteteve të projektit. Këto aktivitete për 8-mujorin në fjalë përfshijnë: i) prezantimin në një event publik në sallën e Këshillit Bashkiak të Planit Lokal të hartuar nga eksperti i jashtëm; ii) përkthimin e produkteve finale të projektit nga gjuha angleze në gjuhën shqipe: “Mjetit Dixhital për Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm dhe Migrimit” dhe “Udhëzuesit për trajnime”; iii) pjesëmarrjen në Shkollën Ndërkombëtare Verore e organizuar nga Universiteti i Bolonjës dhe Punto Europa Forlì të 2 studentëve dhe 2 profesorëve nga Universiteti i Shkodrës “Luigj Gurakuqi”; iv) Rjedhimisht janë paguar honorare për 2 profesorë, pjesëmarrës në trajnimin e parashikuar brenda aktivitetit. Aktivitetet e projektit kanë përfunduar dhe projekti është mbyllur nga ana administrative dhe financiare me datë 20.06.2021.

- **P10430.O3.A1.** Tryeza konsultative me organizatat që veprojnë në sektorin social në Bashkinë e Shkodrës.

Në qytetin e Shkodrës, ndodhen e funksionojnë një sërë organizatash të shoqërisë civile që ofrojnë shërbim në mbështetje të grupeve sociale në nevojë; fëmijëve, të rinjve, grave e burrave, personave me aftësi ndryshe, komunitetit rom dhe egjiptian, moshës së tretë, etj. Viti 2016 ishte një vit i rëndësishëm i fillimit të bashkëpunimit me organizatat e shoqërisë civile dhe institucionalizimit të partneritetit me to. Gjatë këtyre viteve është konsoliduar aktiviteti i tryezave konsultative dhe zhvillimi i bashkëpunimit me shoqërinë civile. Me synim koordinimin e aktiviteteve dhe shërbimeve në territorin e Bashkisë së Shkodrës, janë planifikuar dhe organizuar tryeza konsultative me shoqërinë civile. Gjatë kësaj periudhe tryezat konsultative janë organizuar për planifikimin e aktiviteteve në kuadër të zbatimit të kartës evropiane për barazinë gjinore, 8 marsit, 8-12 prillit, 15 majit, 1 qershorit, 12 qershorit, 30 korrikut, muajt antitrafikim, 16 ditëve të aktivizimit kundër dhunës me bazë gjinore, 20 nëntorit, 3 dhjetorit dhe në zbatim të projekteve

të reja që po zbatohen në Bashkinë e Shkodrës nga organizatat partnere. Për shkak të situatës së shkaktuar nga COVID- 19 një pjesë e këtyre takimeve janë organizuar ndërmjet metodave të komunikimit online, me qëllim ruajtjen e shëndetit të secilit dhe sigurimin e mbarëvajtjes së punës. Tashmë ka një proces të vazhdueshëm dhe të qëndrueshëm të konsultimit përmes takimeve ku qëllimi i këtyre tryezave ka qenë ndërhyrja e integruar në ofrimin e shërbimeve, përmirësimi i cilësisë së shërbimeve dhe mbulimi i territorit me shërbime.

- **P10430.O3.A2.** Aktivitet ndërgjegjësues në kuadër të ditës ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve, 20 nëntori.

20 Nëntori “Dita Ndërkombëtare e të Drejtave të Fëmijëve” synon të promovojë mirëqenien e fëmijëve, të parandalojë çdo formë dhune apo abuzimi ndaj fëmijëve. Në kuadër të ditës ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve, është realizuar një aktivitetet ndërgjegjësues me fëmijët dhe për fëmijët. Këto aktivitete ndërgjegjësuese kanë qëllim rritjen e ndërgjegjësimit mbi të drejtat e fëmijëve. Aktiviteti i zhvilluar në sallën e Këshillit Bashkiak përfshiu përfaqësues të organizatave lokale, institucioneve publike dhe qendrave komunitare që ofrojnë shërbime për fëmijët në nevojë në territorin e bashkisë, si dhe fëmijë përfitues të këtyre shërbimeve.

- **P10430.O3.A3.** Dita ndërkombëtare e fëmijëve, "1 Qeshori"

1 Qeshori është dita ndërkombëtare e fëmijëve. Këtë ditë fëmijët e të gjitha moshave kërkojnë që të jenë të lumtur e të festojnë me familjen, me prindërit, me vëmendjen dhe përkujdesjen e nevojshme për realizimin e dëshirave të tyre. Kjo ditë përveç se është një ditë festive, është një ditë sensibilizimi për promovimin dhe respektimin e të drejtave të fëmijëve. Në këtë ditë pranë Bashkisë Shkodër është realizuar një aktivitet ndërgjegjësues në bashkëpunim me shkollat, qendrat komunitare, shtëpinë e fëmijës 6- 15 vjeç dhe organizatat partnere. Në këtë aktivitet janë realizuar lojra psiko- sociale, ekspozitë pikturë, animacione, teatër i kukullave, performanca artistike me mesazhe ndërgjegjësuese. Në vazhden e të drejtave të fëmijëve, në kuadër të 12 Qershorit, Ditës Ndërkombëtare Kundër Punës së Fëmijëve, Bashkia Shkodër ka realizuar një aktivitet sensibilizues me qëllim mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve siç është e drejta e edukimit, e drejta e jetës, e drejta për kujdes prindëror dhe e drejta për të mos u shfrytëzuar për punë. Qëllim i këtyre aktiviteteve është rritja e ndërgjegjësimit mbi të drejtat e fëmijëve.

- **P10430.O3.A4.** Dita ndërkombëtare e gruas, 8 marsi.

8 Marsi njihet si "Dita e Gruas", në të gjithë botën. Në këtë ditë reflektohet mbi kurajon dhe veprimet e grave të thjeshta të cilat luajtën një rol të rëndësishëm në historinë e të drejtave të grave. Në Ditën Botërore të Gruas, në ditët e sotme, ashtu si në të shkuarën, punohet për barazinë gjinore të gruas, pavarësinë e saj, eliminimin e padrejtësive politike, për kushte më të mira pune dhe jetese. Për herë të parë 8 Marsi në Shqipëri u kremtua në vitin 1942 të shekullit të XX- të në grupe të vogla grash. Në kuadër të 8 marsit, Ditës Ndërkombëtare të gruas u realizua një fushatë ndërgjegjësuese e shtrirë përgjatë të gjithë javës nën moton “Gra të forta”. Janë organizuar aktivitete sensibilizuese, informuese, të shpërndara në Qendrat Komunitare “Për Familjen”,

shkollat e Bashkisë Shkodër, Qendrën Rinore Atelie dhe institucionet kulturore të Bashkisë Shkodër si: Biblioteka “Marin Barleti”, Muzeu “Oso Kuka”, Teatri Migjeni, Galeria e Arteve etj. Aktivitetet janë zhvilluar si në qytet ashtu dhe në njësitë administrative. Synimi i kësaj fushate ishte promovimi i rolit të gruas në shoqëri.

- **P10430.O3.A5.** Bashkëpunimi me Fondacionin “Shpresë për botën”, për përmirësimin e cilësisë së jetesës për personat që jetojnë në institucionet rezidenciale dhe familjet në nevojë.

Në zbatim të marrëveshjes së bashkëpunimit me organizatën “Shpresë për botën”, që ka si qëllim mbështetjen e 3 institucioneve rezidenciale; Shtëpisë së foshnjës, Shtëpisë së fëmijës shkollor dhe Qendrës së zhvillimit, është arritur që të përmirësohet cilësia e jetës së fëmijëve dhe të rinjve që jetojnë në institucionet rezidenciale, si dhe është rritur pjesëmarrja e fëmijëve në aktivitete të ndryshme sociale, kulturore dhe sportive, me qëllim integrimin e tyre. Gjatë kësaj periudhe janë organizuar një sërë aktivitete social- kulturore me fëmijët në raste festash si dhe janë organizuar festime për ditëlindjet për fëmijët në këto institucione. Vazhdon të ofrohet mbështetje me transport për të mundësuar takimet e fëmijët me prindërit biologjikë me qëllim mbajtjen dhe fuqizimin e lidhjeve afektive mes tyre. Këto aktivitete janë organizuar gjatë gjithë vitit në të tre institucionet rezidenciale të Bashkisë Shkodër. Për disa fëmijë është mundësuar të realizohet takimi me familjet biologjike pranë banesave të tyre në Bashkinë Tiranë.

- **P10430.O3.A6.** Aktivitet ndërgjegjësues në kuadër të ditës ndërkombëtare për Personat me Aftësi Ndryshe, më 3 Dhjetor.

3 Dhjetori - Dita Botërore e Personave me Aftësi të kufizuar, synon ndërgjegjësimin e institucioneve, shoqërisë civile, donatorëve, por edhe të mbarë komunitetit për t’u bërë pjesë dhe për t’u përfshirë në procesin e integrimit të personave me aftësi të kufizuar në jetën politike, sociale, ekonomike e kulturore.

Në kuadër të ditës ndërkombëtare për personat me aftësi të kufizuar janë realizuar disa aktivitete. Janë realizuar disa aktivitete nëpër gjimnazet e Bashkisë Shkodër me qëllim ndërgjegjësimin e të rinjve për aftësinë e kufizuar, shërbimet që ofrohen dhe mënyrën sesi ato mund të kontribuojnë në ndihmë të kësaj kategorie. Është realizuar shpërndarje e pakove ushqimore për disa persona me aftësi të kufizuar. Në respektim të të drejtave është organizuar një marshim sensibilizues nëpër rrugët e qytetit dhe një aktivitet social- kulturor me performanca të përgatitura nga vetë personat me aftësi të kufizuar. Qëllimi ynë është mposhtja e të gjitha barrierave, jo vetëm barrierat fizike të betonit, por ato kulturore dhe sociale të cilat pengojnë integrimin e personave me aftësi të kufizuara në fusha të ndryshme të jetës.

- **P10430.O4.A1** Fuqizimi socio – ekonomik i komunitetit rom dhe egjiptian.

Ka vazhduar ofrimi i shërbimeve sociale, integruese dhe mbështetëse pranë qendrës komunitare multifunkionale, për komunitetin rom dhe egjiptian. Qendra Komunitare Multifunkionale “Për

Familjen” për komunitetin rom dhe egjiptian është vënë në funksion të plotë dhe ofron shërbime specifike për komunitetin rom dhe egjiptian. Numri total i përfituesve të shërbimeve në këtë qendër janë 200 familje, nga të cilat 170 janë familje që i përkasin komunitetit rom dhe 30 familje të komunitetit egjiptian. Fëmijët që përfitojnë shërbime integruese gjatë frekuentimit të qendrës janë 120 fëmijë, të cilët mbështeten me lehtësim dhe transport në shkollë, vakte ushqimore dhe klasa pas-shkollore. Gjithashtu këto fëmijë janë pjesë e aktiviteteve sociale dhe argëtuese, lojra psiko-sociale që zhvillohen në qendër, por jo vetëm pasi Bashkia Shkodër në bashkëpunim edhe me Organizatat partnere organizon aktivitetin Kamp Veror i cili për këtë vit është zhvilluar më datat 12– 23 korrik 2021 pranë ambjenteve të shkollës Edith Durham. Gjatë kampit përveç lojrave dhe aktiviteteve psiko - sociale me fëmijët janë zhvilluar takime me: Zjarrëfikësen, Ambulancën, Autoskollën, Teatrin Migjeni, Muzeun Historik “Oso Kuka” si dhe ditë në pishina. Fëmijë të komunitetit rom dhe egjiptian që mbështeten nga Qendra Komunitare Multifunkionale, që frekuentojnë arsimin parashkollorë dhe atë të detyrueshëm janë: 134 të regjistruar në shkollë, 64 fëmijë janë regjistruar në kopsht dhe 7 fëmijë janë regjistruar në çerdhe. Këto fëmijë mbështeten me shërbime integruese nga Qendra Komunitare Multifunkionale “Për familjen”. Gjithashtu në Qendrën Komunitare Multifunkionale ofron edhe klasa prindërimi dhe fokus grupe kryesisht me prindër të fëmijëve që frekuentojnë Qendrën Multifunkionale. Gjatë këtyre takimeve diskutohet dhe trajtohen tema në përshtatje me problematikat e hasura më shpesh. Nr i përfituesve të klasave të prindërimin është 60 prindër të komunitetit rom dhe Egjiptian.

- **P10430.O4.A2** Shpërblim për jetimët me rastin e festave të fundvitit.

Në territorin e Bashkisë së Shkodrës ofrojnë shërbim rezidencial për fëmijë pa përkujdes prindëror 3 institucione të ndryshme të ndara sipas grupmoshave. Këto institucione ofrojnë shërbime për të rinjtë deri në moshën 18 vjeçare. Bashkia e Shkodrës në vitin 2017 ka aplikuar, fituar dhe zbatuar projektin për ristrukturimin e godinës së ish konviktit të shkollës pyjore, pranë MZHU, me qëllim strehimin dhe ofrimin e kushteve sa më të mira banimi për jetimët e dalë nga strukturat rezidenciale dhe që jetojnë në konviktet e shkollave të mesme të qytetit. Aktualisht janë të gatshme dhe janë vënë në funksion 24 apartamente sociale për strehimin e jetimëve dhe grave kryefamiljare. Gjithashtu, në ndihmë të kësaj shtrese do të shpërndahet ashtu si vitet paraardhëse shpërblimi i jetimëve të dalë nga strukturat rezidenciale dhe jo vetëm, banorë të Bashkisë Shkodër, me rastin e festave të fundvitit. Qëllimi i kësaj ndihme është lehtësimi i situatës së tyre ekonomike dhe krijimi i një atmosfere sa më të mirë festive.

- **P10430.O4.A3** Shërbime mbështetëse dhe riaftësuese për integrimin e fëmijëve me aftësi ndryshe në sistemin edukativ.

Autizmi është një sëmundje e cila karakterizohet nga çrregullime të marrëdhënieve sociale, të komunikimit dhe sjellje e lëvizje stereotipike. Autizmi po përhapet në mënyrë të shpejtë duke u shndërruar në një sfidë për shëndetin publik në mbarë botën për shkak të kostove shoqërore dhe ekonomike. Njohuritë për autizmin në shërbimin shëndetësor e më tepër në popullatën shqiptare

janë shumë të pakta dhe nuk është e qartë se rritja e rasteve është rezultat i shtimit real të rasteve apo diagnostikimit më të mirë. Në Shqipëri shifrat janë në rritje, por nuk ka të dhëna të sakta. Specialistët e shëndetësisë bëjnë thirrje për sensibilizimin e opinionit publik për diagnostikimin e hershëm, përkrahjen ndaj fëmijëve autikë dhe integrimin e tyre në shoqëri. Në Shkodër nuk ka pasur një shërbim të specializuar për trajtimin e fëmijëve me autizëm që të mundësojë mbështetjen dhe ofrimin e shërbimeve integruese në moshë sa më të hershme në shërbimet edukuese parashkollore dhe shkollore. Gjatë vitit 2019, Bashkia Shkodër është shpallur fituese me projektin “Krijimi i shërbimit të specializuar ditor për fëmijët me çrregullime të spektrit autik në Bashkinë e Shkodrës” në kuadër të thirrjes për projekte “Askush të Mos Mbetet Pas”, një program i përbashkët i Kombeve të Bashkuara, i financuar nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC). Kanë përfunduar punimet për përshtatjen e ambienteve fizike për ofrimin e shërbimeve, është siguruar mobilimi i ambienteve, përzgjedhja e stafit dhe trajnimi i tij nga Fondacioni “Fëmijët Shqiptarë”, si enti më me eksperiencë në ofrimin e një ekspertizë të tillë. Qendra Harmonia tashmë ka filluar punën dhe ofron shërbime për spektrin e autizmit. Përgjatë kësaj periudhe kanë marrë shërbim rreth 15 fëmijë të diagnostikuar me spektrin e autizmit.

- **P10430.O4. A3.1** “Krijimi i shërbimit të specializuar ditor për fëmijët me çrregullime të spektrit autik në Bashkinë e Shkodrës”

Bashkia Shkodër është shpallur fituese me projektin “Krijimi i shërbimit të specializuar ditor për fëmijët me çrregullime të spektrit autik në Bashkinë e Shkodrës” në kuadër të thirrjes për projekte “Askush të Mos Mbetet Pas”, një program i përbashkët i Kombeve të Bashkuara, i financuar nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC). Nëpërmjet këtij projekti është financuar nisja e ofrimit të shërbimeve dhe vënia në funksion e ambienteve të rikonstruara. Projekti ka mbështetur zbatimin e vizionit të sapo- hartuar të sektorit social në Shqipëri, në përputhje me Objektivat për Zhvillim të Qëndrueshëm (SDG-të) dhe aspiratat e vendit drejt integritimit evropian. Projekti adreson përfshirjen sociale të personave me AK, në këtë rast të fëmijëve me çrregullime të spektrit autik, nëpërmjet ofrimit të shërbimeve të kujdesit shoqëror të specializuara, që synojnë fuqizimin dhe pjesëmarrjen efektive të tyre në shoqëri. Gjithashtu, ky projekt propozohet në përputhje me Planin Social Vendor të Bashkisë Shkodër, në mënyrë konkrete për sa i përket “Objektivit Strategjik 1” përsa lidhet me standardizimin, konsolidimin dhe shtrirjen e shërbimit komunitar në territor; si dhe në përputhje me “Objektivin Strategjik 5” përsa lidhet me ofrimin e shërbimeve mbështetëse dhe riaftësuese për integrimin e fëmijëve me aftësi ndryshe (autikë) në sistemin edukativ. Gjatë kësaj periudhe janë ridizenjuar hapësirat në përshtatje me shërbimet që do të ofrojë Qendra. Është siguruar me financimin e Bashkisë Shkodër një pjesë e mobilimit të ambienteve të qendrës, si dhe janë realizuar ndërhyrjet e duhura infrastrukturore të objektit për rehabilitimin e dëmtimeve të shkaktuara nga tërmeti i 26 nëntorit 2019. Janë kryer procedurat e prokurimeve përkatëse dhe organizuar aktivitetet e parashikuara në kuadër të projektit. Është realizuar përzgjedhja dhe trajnimi i stafit që do të merret me ofrimin e shërbimeve dhe është bërë punësimi i tyre. Qendra Harmonia që nga janari i këtij viti është në funksion të plotë

dhe ofron shërbime të specializuara për spektrin e autizmit. Përgjatë kësaj periudhe kanë marrë shërbim rreth 15 fëmijë të diagnostikuar me spektrin e autizmit.

- **P10430.O4.A4** Plani i zhvillimit lokal për komunitetin rom dhe egjiptian.

Në zbatim të planit të zhvillimit janë realizuar dhe ofrohen shërbimet në mbështetje dhe fuqizim të komunitetit rom dhe egjiptian. Njëkohësisht është punuar për hartimin e raportit të parë mbi ecurinë e zbatimit të Planit të Zhvillimit të Komunitetit (PZHK) Rom dhe Egjiptian të Bashkisë së Shkodrës për periudhën 2017- 2021. Raporti ofron një analizë të evidencave ekzistuese në lidhje me ndryshimet në jetët e anëtarëve të dy komuniteteve, rom dhe egjiptianë, sipas gjashtë fushave prioritare të planit të veprimit, përkatësisht: regjistrimi civil dhe aksesin në sistemin e drejtësisë; arsimi dhe promovimi i dialogut ndërkulturor; punësimi dhe arsimi dhe formimi profesional; kujdesi shëndetësor, strehimi dhe integrimi urban; si dhe mbrojtja sociale. Duke marrë në konsideratë që monitorimi ndihmon aktorët vendor për të bërë ndryshimet e nevojshme në PZHK, ai ndër të tjera synon të ofrojë edhe rekomandimet e nevojshme për adresimin e sfidave dhe problemeve të identifikuara.

- **P10430.O4.A5** Mbështetje financiare për familjen e të ndjerit Musaen Zeneli

Me vendim të Këshillit Bashkiak VKB nr. 38, datë 02.07.2021, "Për një shtesë në VKB nr. 63 dt. 28.12.2020 "Për miratimin e Buxhetit të vitit 2021" dhe Programit Buxhetor Afatmesëm Përfundimtar 2021-2023 të Bashkisë Shkodër", i ndryshuar u miratua mbështetja financiare për familjen e të ndjerit Musaen Zeneli.

- **P10430.O5.A1.** Ngritja dhe vendosja në funksion e Qendrave Komunitare "Për Familjen"

Në vitin 2016 filloi krijimi i rrjetit të shërbimit social në komunitet. Për herë të parë u ngritën qendrat komunitare "Për familjen", të cilat ofrojnë shërbime sociale si informim, orientim, këshillim, shërbim në familje, mbështetje psiko- sociale, etj. Në vazhdim të krijimit dhe zgjerimit të rrjetit për ofrimin e shërbimit social në territor, janë ngritur dhe vënë në funksion në total 12 qendra komunitare "Për Familjen", të shtrira në territorin e Bashkisë së Shkodrës. Gjatë kësaj periudhe, sa i përket konsolidimit të shërbimit komunitar në qendrat komunitare "Për Familjen", janë rritur shërbimet e ofruara, aktivitetet dhe përfituesit, pranë këtyre qendrave. Duke u mbështetur në shërbimet e ekzistuese, eksperiencën e krijuar dhe nevojat sociale në komunitet, Bashkia e Shkodrës synon të mbështesë zhvillimin e integruar dhe të vazhdueshëm të mirëqënies sociale të familjes si qeliza bazë e komunitetit tonë të shtrirë në të gjithë territorin.

- **P10430.O5.A2.** Shërbime alternative për fëmijët dhe familjen.

Sigurimi i mbrojtjes shoqërore për fëmijët pa kujdes prindëror dhe i të drejtave të tyre është një ndër sfidat më të rëndësishme për Bashkinë e Shkodrës, por edhe për shoqërinë civile, duke kërkuar një vëmendje më të veçantë për këtë target grup. Gjatë kësaj periudhe, në bashkëpunim me organizatën Nisma për ndryshim shoqëror janë identifikuar familje në rrezik institucionalizimi dhe po punohet për fuqizimin e tyre dhe paralelisht po punohet me fuqizimin e familjeve që kanë

fëmijë në institucione rezidenciale, me synim deinstitutionalizimin e tyre. Ka vazhduar bashkëpunimi me Bethany, duke realizuar një fushatë ndërgjegjësuese me aktorë të ndryshëm publik dhe jo publik, por edhe me komunitetin për të rritur ndërgjegjësimin dhe informacionin mbi shërbimin e kujdestarisë ligjore si mundësia më e mirë për fëmijët pa kujdes prindëror. Këto aktivitete janë zhvilluar online si dhe në median lokale dhe kanë qenë pjesë e aktiviteteve të zhvilluara nga Bashkia, në kuadër të 15 majit “Ditës ndërkombëtare të Familjes”.

- **P10430.O5.A3.** Ndërhyrje të integruara për përfshirjen dhe integrimin socio- ekonomik të fëmijëve dhe të rinjve pa përkujdes prindëror.

Me synim ofrimin e kushteve sa më të përshtatshme për mirërritjen dhe zhvillimin e fëmijëve, Bashkia e Shkodrës po implementon shërbimet alternative të kujdestarisë për fëmijët pa përkujdes prindëror; shërbimin e kujdestarisë familjare dhe ofrimin e shërbimeve alternative pranë shtëpi – familje. Me synim parandalimin e institucionalizimit, po koordinohen shërbimet në territor për fuqizimin e familjeve në vështirësi socio- ekonomike pranë qendrave komunitare “Për Familjen”. Përveç kësaj, për të rinjtë të cilët tashmë kanë dalë nga strukturat rezidenciale janë planifikuar shërbime për mbështetjen e fuqizimin e tyre përmes përfshirjes në kurse profesionale me synim arritjen e autonomisë për kujdesin personal social, ekonomik, etj. Ka përfunduar dhe pritet të vihet në funksion modeli i ri i Komunitetit Edukativ të së Ardhmes ose Shtëpi Familje për fëmijët pa përkujdes prindëror të Bashkisë Shkodër, si model i parë në vendin tonë i shërbimit alternativ pranë shtëpi familje për fëmijët pa kujdes prindëror. Kjo strukturë është ndërtuar në kuadër të zbatimit të projektit “Komuniteti i të Ardhmes: ndërhyrje të përfshirjes sociale dhe në tregun e punës për jetimet e Shkodrës”, AID 10950, projekt i financuar nga Agjencia Italiane për Bashkëpunim dhe Zhvillim (AICS), dhe që po zbatohet nga Shoqata IPSIA, në bashkëpunim me Bashkinë Shkodër, CODE PARTNERS, SHIS, Universitetin e Bolonjës, Universitetin e Shkodrës dhe Kooperativën Lybra, në të cilin është parashikuar që të mbulohen kostot e shërbimit dhe të stafit gjatë vitit të parë. Gjatë thirrjes së parë për plotësimin e vendeve vakante pranë kësaj strukture janë kualifikuar vetëm dy persona, në periudhën në vijim do të shpallet thirrja e dytë për plotësimin e vendeve vakante të mbetura. Sfidë mbetet financimi për të siguruar qëndrueshmërinë e këtij shërbimi inovativ në lidhje me kujdesin alternativ për fëmijët pa kujdes prindëror. Gjatë kësaj periudhe është hartuar Rregullore e brendshme e funksionimit të kësaj strukture që do të shërbejë si udhërrëfyes i veprimtarisë së saj.

- **P10430.O6.A1** Qendra Rinore "Atelie"

Gjatë kësaj periudhe, u realizuan trajnime për aftësimin digjital rreth sigurisë online dhe mënyrat se si të mbrohem nga rreziqet që na paraqiten nga bota virtuale, që mund të çojnë deri në trafikimin e personave. U realizua ekspozitë me të rinjtë e shkollës "Prenkë Jakova" me rastin e 7- 8 marsit. U realizuan ëorkshope për ngritjen e startup- eve dhe bizneseve në bashkëpunim me organizatën YEA. U realizua ekspozita multimedia "Dark Rooms" nga artistët e rinj shkodranë dhe koncerti për promovimin e të rinjve instrumentistë dhe këngëtarë në Qendrën Rinore "Atelie". U realizuan: Koncerti i të rinjve të Shkodrës organizuar nga Qendra Rinore "Atelie". U realizua takimi me aktorë publik dhe jopublik për identifikimin, referimin e çështjeve rinore, në bashkëpunim me

organizatën "Gruaja Tek Gruaja". U realizua ekspozita "Puna edukon dhe jep shpresë" nga Ledina Hebovija dhe Oendi Gelqerja mbështetur nga Terre des Hommes - Albania. U realizua takimi informues dhe ndërjegjësues me të rinjtë e qendrës mbi fushatën e Bashkisë Shkodër "Mos dhuro para, dhuro kujdes!". Qendra Rinore "Atelie" ishte pjesë në organizimin dhe realizimin e kampionatit veror 2021 me fëmijë dhe të rinjtë më në nevojë. U realizua Cikli i këshillimit "Aftësim drejt Punësimit" për një periudhë 1 mujore pranë Qendrës Rinore "Atelie" duke mbështetur të rinjtë e Bashkisë Shkodër, Bashkisë Vau Dejës dhe Bashkisë Malësi e Madhe, në bashkëpunim me organizatën "Gruaja tek Gruaja". U realizua kinema për fëmijët nga klasa e 1-rë deri në 9-të, me qëllim edukimin mbi marrëdhëniet dhe mbrojtjen e mjedisit, në bashkëpunim me SHIS. U realizua ekspozita e të rinjve nga Shkodra dhe Tirana "Trashëgimia në dizajn tekstil", në bashkëpunim me organizatën "Moda Konfeksion në shërbim të gruas". U realizua projekti "GROËTH - Green Theater for School Emploerment" me qëllim promovimin e arsimit cilësor, të barabartë dhe gjithëpërfshirës me anë të teatrit social, në bashkëpunim me organizatën Dora e Pajtimit. U realizua prezantimi i projektit "Ura Adriatike", i cili ofron shërbime për të rinjtë si: formimi profesional në sektorin hoteleri- turizëm dhe agrikulturë, kurse gjuhë italiane dhe siguri ligjore në punë, informim dhe mbështetje administrative të punësimit në Itali. Ky aktivitet u realizua në bashkëpunim me Cefal Emilia Romagna dhe ESCCOP. U realizua Shkodra Jazz Festival, në bashkëpunim me shoqatën Rrok Jakaj dhe takime mbi shëndetin mendor: shkrimi i një letre, piktura kolektive, role playing në bashkëpunim me Nisma për ndryshim shoqëror, Arsis. U realizua aktiviteti me qëllim mirëmbajtjen e ambientit dhe diskutim mbi problematikat dhe nevojat e komunitetit me të rinjtë e qendrës rinore dhe komunitetit rom në bashkëpunim me Terre des Hommes. U realizua muralja në shkollën e Gurit të Zi dhe ngritja e skuadrës së futbollit (vajza dhe djem) në kuadër të projektit "ArtVocacy - E drejta absolute për jetën", në bashkëpunim me YMCA – Tirana. Dy të rinj të Qendrës Rinore u bënë pjesë e trajnimeve të organizuar nga organizata PVN Albania me tematika mbi "Organizatrat Rinore, Media dhe Monitorimi Qytetar" dhe "Vullnetarizmi i Qëndrueshëm 2.0"; Qendra Rinore Atelie u bë pjesë e ëorkshopit "Vijimësia e intershiveve për të rinjtë – Perspektiva Advokuese" organizuar nga Caritas Albania në kuadër të projektit Your Job. U realizua aktiviteti "Le të flasim për: Mundësitë e vetëpunësimit për rininë që ofron Drejtoria Rajonale e Agjencisë Kombëtare të Punësimit në Shkodër". U realizuan pranë Qendrës Rinore Atelie takimet e mentorimit të të rinjve pjesë e #Ëork4Youth projekt në të cilin Bashkia Shkodër është partner. U realizua aktiviteti "Është koha për të thënë MJAFT" në bashkëpunim me Qendra Komunitare "Për Familjen" nr. 2, ku u diskutua mbi problematiken e trafikimit të qënieve njerëzore. Në bashkëpunim me Zyrën Rajonale për Bashkëpunim Rinor (RYCO) u realizua aktiviteti Supershkollat për shkëmbimet shkollore në 6 vendet e Ballkanit Perëndimor që ka për qëllim të mbështesë proceset e paqes e pajtimit, si dhe dialogun dhe të mësuarit ndërkulturor midis shkollave, nxënësve dhe komuniteteve të tyre, ku morën pjesë përfaqësues nga shkollat e Bashkisë Shkodër. U realizua aktiviteti i Këshillimit drejt Punësimit (C4EE) në bashkëpunim me Institute of Romani Culture in Albania - IRCA. U zhvillua ëorkshop informues "Dita e Solidaritetit dhe Aktivizimit Social" në bashkëpunim me AS@N ku morën pjesë të rinjtë e shkollave të Shkodrës. U realizua aktiviteti "Le të flasim për: Mundësitë e vetëpunësimit, kurse profesionale dhe

internship për rininë që ofron Caritasi Dioqezan me anë të projektit YourJOB në Shkodër”. Qendra Rinore në bashkëpunim me Qendrën YEA vazhdon siparin e takimeve në kuadër YEA! AËARDS 2022. Qendra Rinore "Atelie" ishte pjesë takimit të bashkëndarjes së praktikave të mira në shërbim të rinisë të organizuar nga Observatori për të Drejtat e Fëmijëve dhe të Rinjve. Qendra Rinore "Atelie" në bashkëpunim me Fondacionin Konrad- Adenauer-Stiftung Albanien për zhvillimin e një paneli informues me tematika si: "Integrimi i ballkanit në Bashkimin Europian" për të cilën relatoi Dr. Zemaida Mozali dhe "Kontributi i Bashkimit Europian në politikat rinore" për të cilën relatoi Dr. Elda Zotaj. Qendra Rinore “Atelie” në bashkëpunim me Ambasadën Franceze, Ambasadën Spanjolle, UN Eëomen në Shqipëri prezantoi dokumentarin “HUNTED – Dhuna Kompjuterike në familje” nga Znj. Marine Périn. Në bashkëpunim me UNICEF Albania u mundësua hapësira #BiblioTech, e vënë në dispozicion për nxënësit e talentuar, të cilët i afroi më shumë me mësimin digjital, lundrimin e sigurt në internet, Friendly Eëi-Fi Albania dhe të gjitha avantazhet që #BiblioTech ofron dhe do të ofrojnë në muajt në vijim.

- **P10430.O7.A1.** “Asnjë Fëmijë Jashtë”

“Asnjë fëmijë jashtë” është një aktivitet social- kulturor që organizohet që nga viti 2005, me rastin e festave të fundvitit. Protagonistë të këtij aktiviteti janë fëmijët e familjeve në vështirësi social-ekonomike. Ky aktivitet përfshin të gjitha kategoritë e fëmijëve të familjeve në vështirësi të theksuara social- ekonomike, gjithashtu përfshin aktivisht PAK, fëmijë të komunitetit rom dhe egjiptian, fëmijët e ngjuar, fëmijë të institucioneve rezidenciale, fëmijë në situatë rruge duke përfshirë edhe fëmijë nga të gjitha njësitë administrative të Bashkisë Shkodër. Fëmijët përgatiten dhe performojnë në fusha të ndryshme artistike si: muzikë, recitim, vegla muzikore, teatër, etj duke synuar gjithëpërfshirjen e fëmijëve në fusha të ndryshme të artit duke qenë vetë ata protagonistët. Ky aktivitet është planifikuar të realizohet me metodën RELOAD, e cila është hedhur 2 herë si procedurë, por nuk ka pasur ofertues, ndaj nuk është realizuar.

- **P10430.O7.A2.** Mbështetja e trupës muzikore të Personave me Aftësi Ndryshe.

Që nga viti 2005 në qytetin e Shkodrës zhvillon veprimtarinë e saj trupa muzikore The DOOR Albania, e vetmja në rajonin e Ballkanit. “Trupa muzikore e PAN- ve” përbëhet nga një grup të rinjsh me aftësi të kufizuara, të gjithë ish- nxënës të shkollës speciale “3 Dhjetori”. Kjo trupë muzikore angazhohet në aktivitete të ndryshme që realizohen në territorin e Bashkisë Shkodër, por jo vetëm. Kursi synon integrimin e fëmijëve me aftësi të kufizuara të cilët janë shumë të aftë në veglat frymore dhe përmes angazhimit përcjellin mesazhin: Mundësi integrimi për të gjithë. Trupa Muzikore përbëhet nga 25 të rinj me aftësi ndryshe. Gjatë këtij viti kjo bandë ka punuar dhe vazhduar provat dhe ka arritur të marrë pjesë dhe të performojë në aktivitete të ndryshme.

- **P10430.O7.A3** Shtëpi Familje për persona me aftësi të kufizuara nga Opera Madonnina del Grappa.

Opera Madonnina del Grappa është një organizatë e liçensuar që ofron shërbim të përkujdesit social të tipit shtëpi- familje, për PAK të braktisur nga familja dhe të deinstitutionalizuar. Kjo organizatë, është krijuar dhe vepron në qytetin e Shkodrës që prej vitit 1992 ku filloi aktivitetin e saj në mbështetje të personave dhe familjeve më në nevojë. Në vitin 1994 filloi ristrukturimi i plotë i ish spitalit psikiatrik të fëmijëve në Shkodër, duke sjellë përmirësimin e kushteve të jetesës dhe trajtimit të fëmijëve, por në mënyrë të veçantë ky projekt realizoi krijimin për herë të parë në Shqipëri të Qendrës Ditore për fëmijët më aftësi të kufizuar dhe të krijimit të Shtëpisë Familje. Aktualisht në shtëpinë familje të Opera Madonnina del Grappa marrin shërbim 17 persona me aftësi të kufizuar. Qëllimi i kësaj strukture është rehabilitimi dhe përfshirja në jetën sociale e komunitare nëpërmjet aktiviteteve të ndryshme me karakter edukativ e integruar duke ju ofruar përfituesve të saj shërbim rezidencial konform standarteve të miratuara nga Ministria e Linjës. Mbështetja e shtëpive – familje të “Opera Madonnina del Grappa” është një domosdoshmëri, për të ofruar shërbimin sipas standarteve të përcaktuara në ligj për personat me aftësi ndryshe dhe përmbushjen e nevojave sipas rasteve specifike. Me qëllim sigurimin e vazhdimësisë dhe qëndrueshmërinë e shërbimeve shoqata “Opera Madonnina del Grappa”, i është drejtuar vazhdimisht për mbështetje Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Bashkisë Shkodër me kërkesën për financim të shërbimeve, në mbështetje të ligjit nr.121/2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”. Në përgjigje të këtyre kërkesave Bashkia Shkodër, i është drejtuar Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale me kërkesën për fonde për mbështetje të “Opera Madonnina del Grappa”, për fond për paga dhe sigurime shoqërore për punonjës, si kujdestar social dhe figura profesionale në fusha të ndryshme si: drejtor, ekonomist, psikolog, punonjës social, fizioterapist, infermier dhe kuzhinier, punëtor mirëmbajtës etj. Përveç pagesës për personelin, Bashkia Shkodër do të mbështesë “Opera Madonnina del Grappa” duke mbuluar kuotën ushqimore për personat me aftësi të kufizuar të sistemuar pranë “Opera Madonnina del Grappa”, energjinë elektrike, ujë, gaz, karburant, shpenzime mjekësore etj. sipas marrëveshjes së bashkëpunimit mes Bashkisë Shkodër dhe “Opera Madonnina del Grappa”.

- **P10430.O7.A4.** Projekti “Shpresa” për personat e braktisur dhe me aftësi ndryshe.

Projekti Shpresa është një organizatë e liçensuar që ofron shërbim të përkujdesit social të tipit shtëpi- familje, për PAK e braktisur nga familja dhe të deinstitutionalizuar. Kjo organizatë është krijuar dhe vepron në qytetin e Shkodrës që prej vitit 1995. Projekti “Shpresa” ka 7 shtëpi-familje, të shpërndara në komunitet dhe aktualisht marrin shërbim 60 persona me aftësi ndryshe. Projekti “Shpresa”, duke ofruar shërbime alternative për personat me aftësi të kufizuara, të cilët janë pa asnjë përkujdes dhe interesim familjar, dhe me problematika të ndryshme, ka nevojë për mbështetje financiare dhe vëmendje të shtetit. Mbështetja e projektit “Shpresa” është një domosdoshmëri, për të ofruar shërbimin sipas standarteve të përcaktuara në ligj për personat me aftësi ndryshe dhe përmbushjen e nevojave sipas rasteve specifike. Në këto qendra përfitojnë shërbime të përkujdesit shoqëror, rehabilitues dhe shëndetësor 60 individë me aftësi ndryshe.

- **P010430.O8.A1.** Pagesë PAK dhe Invaliditeti.

Në zbatim të Ligjit Nr. 57/2019 “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë”, Ligjit nr. 8626 datë 22.6.2000 “Statusi i invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik” të ndryshuar; Ligjit nr. 8098, datë 28.03.1996 “Për statusin e të verbërit” i ndryshuar, Ligjit nr. 7889 datë 14.12.1994 “Statusi i invalidit” të ndryshuar.

Numri i personave të trajtuar me pagesë paaftësie ka qenë: në muajin Janar 4023, në Shkurt 3995, në Mars 4010, në Prill 3971, në Maj 3961, në Qershor 3945, në Korrik 3928, në Gusht 3930, në Shtator 3939, në Tetor 3935, në Nëntor 3927, në Dhjetor 3959, Shpërblime Fundviti 1253.

Numri i invalidëve të punës të trajtuar me shtesë kempit ka qenë: në muajin Janar 3284, në Shkurt 3320, në Mars 3295, në Prill 3289, në Maj 3286, në Qershor 3270, në Korrik 3276, në Gusht 3274, në Shtator 3289, në Tetor 3274, në Nëntor 3263, në Dhjetor 3269.

Për kryerjen e këtyre pagesave mujore fondet e çelura nga Shërbimi Social Shtetëror janë si më poshtë:

PAK: Janar - Shkurt 138,340.000 Lekë, Mars - Prill 127,988,000 Lekë, Maj - Qershor 125,262,000, Korrik - Gusht 126,256,000, Shtator - Tetor 125,388,000 , Nëntor - Dhjetor 123,414,000, Shpërblimi i fundvitit 9,384,000.

- **P10430.O8.A2.** Ndihma ekonomike.

Në zbatim të Ligjit Nr. 57/2019 “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë”, VKM nr 597, datë 14.09.2019 “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike”.

Përfitues të skemës së ndihmës ekonomike kanë qenë:

Në muajin Janar 2014 familje, nga të cilat: 1810 familje janë trajtuar nga sistemi elektronik Kombëtar dhe 204 nga fondi i kushtëzuar i bllok ndihmës deri në 6%.

Në muajin Shkurt 2064 familje, nga të cilat: 1855 familje janë trajtuar nga sistemi elektronik Kombëtar dhe 209 nga fondi i kushtëzuar i bllok ndihmës deri në 6%.

Në muajin Mars 2107 familje, nga të cilat: 1898 familje janë trajtuar nga sistemi elektronik Kombëtar dhe 209 nga fondi i kushtëzuar i bllok ndihmës deri në 6%.

Në muajin Prill 2122 familje, nga të cilat: 1913 familje janë trajtuar nga sistemi elektronik Kombëtar dhe 209 nga fondi i kushtëzuar i bllok ndihmës deri në 6%.

Në muajin Maj 2149 familje, nga të cilat: 1938 familje janë trajtuar nga sistemi elektronik Kombëtar dhe 211 nga fondi i kushtëzuar i bllok ndihmës deri në 6%.

Në muajin Qershor 2138 familje, nga të cilat: 1931 familje janë trajtuar nga sistemi elektronik Kombëtar dhe 207 nga fondi i kushtëzuar i bllok ndihmës deri në 6%.

Në muajin Korrik 2041 familje, nga të cilat: 1834 familje janë trajtuar nga sistemi elektronik Kombëtar dhe 207 nga fondi i kushtëzuar i bllok ndihmës deri në 6%.

Në muajin Gusht 2033 familje, nga të cilat: 1826 familje janë trajtuar nga sistemi elektronik Kombëtar dhe 207 nga fondi i kushtëzuar i bllok ndihmës deri në 6%.

Në muajin Shtator 2001 familje, nga të cilat: 1789 familje janë trajtuar nga sistemi elektronik Kombëtar dhe 212 nga fondi i kushtëzuar i bllok ndihmës deri në 6%.

Në muajin Tetor 1869 familje, nga të cilat: 1675 familje janë trajtuar nga sistemi elektronik Kombëtar dhe 194 nga fondi i kushtëzuar i bllok ndihmës deri në 6%.

Në muajin Nëntor 1855 familje, nga të cilat: 1663 familje janë trajtuar nga sistemi elektronik Kombëtar dhe 194 nga fondi i kushtëzuar i bllok ndihmës deri në 6%.

Në muajin Dhjetor 1644 familje, nga të cilat: 1644 familje janë trajtuar nga sistemi elektronik Kombëtar dhe 0 nga fondi i kushtëzuar i bllok ndihmës deri në 6% (kalon në Janar).

Shpërblimet e fundvitit 2021, 1831 familje, nga të cilat : 1639 familje janë trajtuar nga sistemi elektronik Kombëtar dhe 192 nga fondi i kushtëzuar i bllok ndihmës deri në 6%.

Duhet të theksojmë faktin se pagesa e muajit Dhjetor, për familjet që trajtohen me fondin e kushtëzuar të bllok ndihmës deri në 6%, për 205 familje në vlerën 552,808 Lekë, është paguar me çeljen e fondeve të reja të vitit kalendarik 2021.

Për kryerjen e këtyre pagesave mujore fondet e çelura nga Shërbimi Social Shtetëror janë si më poshtë:

Ndihma Ekonomike: Janar – Shkurt 23,300,000 Lekë, Mars-Prill 19,564,000 Lekë, Maj - Qershor 17,866,000, Korrik - Gusht 20,136,000, Shtator - Tetor 20,324,000, Nëntor - Dhjetor 20,017,000, Shpërblimi i fundvitit 5,685,000 .

Në zbatim të Vendimit Nr. 85, datë 10.2.2021 "Për një shtesë në vendimin nr. 597, datë 4.9.2019, të Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e procedurave, dokumentacionit dhe masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike", masa e ndihmës ekonomike është dyfishuar për periudhën Janar- Qershor 2021.

Fondet e çelura nga Shërbimi Social Shtetëror për kryerjen e pagesave të dyta të ndihmës ekonomike janë si më poshtë:

Ndihma Ekonomike 2- fishimi: Janar 9,780,000 Lekë, Shkurt 9,801,000 Lekë, Mars 10,357,500 Lekë, Prill 10,147,000 Lekë, Maj 9,724,000, Qershor 10,096,000.

- **P10430.O9.A1.** Administrimi dhe funksionimi i çerdheve.

Është realizuar vlerësimi i nevojave për ndërhyrje me qëllim krijimin e kushteve sa më të favorshme për foshnjat që frekuentojnë këto çerdhe dhe gjithashtu familjet e tyre. Në Bashkinë e Shkodrës, ofrojnë shërbim për foshnjat dhe familjet e tyre 6 çerdhe. Numri i foshnjeve që frekuentojnë këto çerdhe është 194.

1. "Shpenzime për paga e sigurime"

Fondi i planifikuar për mbulimin e shpenzimeve për paga dhe sigurime është **41,278 mijë lekë** dhe realizimi i 12 mujorit paraqitet në vlerën **28,517 mijë lekë** dhe realizimi për sigurime paraqitet në vlerën **4,782 mijë lekë**.

2. "Shpenzime për Mallra dhe Shërbime të tjera"

Fondi i planifikuar për këtë zë është **9,541 mijë lekë** dhe realizimi i këtij artikulli paraqitet me vlerën **8,626 mijë lekë**.

Në zërin “**Materiale zyre dhe të përgjithshme**”, fondi i planifikuar është **95 mijë lekë** për blerje kancelarie është realizuar në vlerën **80 mijë lekë**.

Në zërin “**Materiale për pastrim ngrohje dhe ndriçim**” fondi i planifikuar është **1,000 mijë lekë**. Materiale për pastrim është realizuar në vlerën **600 mijë lekë**, plani në vlerën **400 mijë lekë** për blerje gazi që nuk është realizuar për shkak se ka teprica nga vitet e kaluara.

Në zërin “**Furnizime me ushqime**” për 6 Çerdhe, fondi i planifikuar është **5,300 mijë lekë**, është lidhur kontrata në muajin Prill, për 12 mujorin është realizuar në vlerën **4,905 mijë lekë** në bazë të frekuentimit të fëmijëve në çerdhe. Nga periudha Janar- Mars është mbuluar me gjendjen e ushqimeve në magazinë nga kontrata e vitit 2020.

Në zërin “**Blerjeve të materialeve të tjera**” si batanije, carcafé, enë kuzhine etj fondi i planifikuar është **150 mijë lekë** dhe është realizuar në vlerën **147 mijë lekë**.

Në zërin “**Shërbime nga të tretë**” fondi i parashikuar është **1,800 mijë lekë**. Kjo vlerë përfaqëson faturat e energjisë elektrike që janë realizuar për periudhën 12 mujore në shumën prej **1,370 mijë lekë**, faturat e konsumit të ujit në shumën prej **430 mijë lekë**. Për vlerën **46 mijë lekë** të parashikuar për internet, realizimi është **46 mijë lekë** dhe likuidimi bëhet çdo muaj. Në zërin “**Blerje e lëndëve djegëse**” dru zjarri fondi i parashikuar prej **300 mijë lekë** është realizuar plotësisht.

Shërbimi për **dezinfektimin** e ambienteve të Çerdheve është parashikuar në vlerën prej **40 mijë lekë**. Është realizuar për vlerën **21 mijë lekë**.

Në zërin “**Shpenzime Transporti**” fondi i parashikuar përfshin vlerën prej **200 mijë lekë** në të cilën përfshihen shpenzimet që janë për blerje karburanti parashikuar dhe realizuar. Në zërin “**Mirëmbajtje e zakonshme e rrjetit elektrik Çerdhes Perash**” është realizuar në vlerën **300 mijë lekë**. Mirëmbajtje (Vendosje e strehë, vendqëndrim për bicikleta) në shumën prej **200 mijë lekë** është realizuar në vlerën **189 mijë lekë**. **Mirëmbajtje e aparateve dhe pajisjeve teknike** në vlerën prej **40 mijë lekë** si dhe **30 mijë lekë** për mirëmbajtje të pajisjeve të zyrës përdoren për t’u realizuar sipas nevojës, nuk janë realizuar për vitin 2021.

Në zërin “**Shpenzime për sigurimin e ndërtesave**” fondi i planifikuar është **40 mijë lekë** dhe është realizuar në vlerën **39 mijë lekë**.

Transferta Buxhetore për individë që akordohet për rastet e daljes në pension fondi për periudhën 12 mujore paraqitet në vlerën **262 mijë lekë** dhe realizimi në vlerën **177 mijë lekë**.

Në zërin “**Investime**” fondi i planifikuar është **400 mijë lekë** për **Blerje pajisje TIK** me plan **100 mijë** dhe është realizuar për **100 mijë lekë**, ndërsa **Blerje pajisje sigurie (Kamera)** me plan **300 mijë lekë** është realizuar në vlerën **298 mijë lekë**.

Programi 10661: Strehimi social

Ky program përfshin institucione dhe konkretisht:

1. Drejtorinë e Shërbimeve Sociale, Strehimit dhe Shëndetit Publik.

Realizimi i qëllimit dhe objektivave të politikës së programit.

Qëllimi i programit të “Strehimi social”.


- Ndërtimi dhe administrimi i banesave për strehimin social, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj.

Objektivat e programit buxhetor për përmbushjen e këtyre funksioneve për vitin 2021 kanë qenë:

- O1.Përmirësimi i kushteve të banimit për shtresat në nevojë.
- O2. Vlerësimi, planifikimi dhe sigurimi i kushteve të përshtatshme të banimit, për individët dhe familjet në nevojë, përmes ofrimit të alternativave për një strehim të gatshëm, të arritshëm, të përballueshëm dhe të përshtatshëm.


Realizimi i Buxhetit të planifikuar
Programi “Strehimi social”.

Programi 10661	Shpenzime operative	Transferta	Investime	Totali
PBA 2021	1,154	600	25,000	26,754
Plani fillestar 2021	1,647	1,200	49,552	52,399
Plani i rishikuar 2021	1,182	9,042	78,601	88,825
Realizimi viti 2021	115	3,747	50,574	54,436
% e realizimit	9.7%	41.4%	64.3%	61.3%



Realizimi i shpenzimeve korrente dhe kapitale për këtë program, duke e krahasuar me planifikimin është në total 61.3%, sipas zërave kryesorë më poshtë:

Shpenzimet korrente	37.8%
Shpenzimet kapitale	64.3%



Faktorët që kanë ndikuar në mosrealizimin e fondeve të planifikuara.

Një arsye e mosrealizimit të fondeve të planifikuara është mos depozitimi i kontratës së qirasë nga përfituesi duke penguar lëvrimin e fondeve të parashikuar për “Subvencionimi i qirasë në treg të lirë”.

E njëjta arsye e mosrealizimit të të gjitha fondeve të parashikuara për “Subvencionimin e interesave të kredisë” është mos depozitimi i kontratave të blerjes së banesës nga përfituesit pranë bankave që zbatojnë programin.

Projekti “P10661.O2.A4 Bashkëfinancim për përshtatje për strehim social të objektit ekzistues pjesë të konviktit të shkollës Industriale "Arben Broci", i hartuar në kuadër të Thirrjes "Banesë sociale me qira që sigurohet nëpërmjet adaptimit të objekteve ekzistuese, procedurat e të cilit përcaktohet sipas VKM- së nr. 458, datë 3.7.2019”, nuk është miratuar nga ministria e linjës.

Realizimi i treguesve të performancës:

Aneksi nr.4 Raporti i realizimit të objektivave të politikës së programit

Periudha e Raportimit: 01.01.2021-31.12.2021

Kodi i Programit	10661	Emertimi i programit:	Strehimi social						Komente
Qellimi 1	Ndërtimin dhe administrimin e banesave për strehimin social, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj.							
Objektivat e politikës:		Kodi i Treguesit te Performances/Produktit	Emertimi i Treguesit te Performances***/Produktit	Niveli faktik i vitit paraardhes	Niveli i planifikuar ne vitin korent	Niveli i rishikuar ne vitin korent	Niveli faktik ne fund te vitit korent	% e Realizimit te Treguesit te Performances/Produktit	
Objektivi 1	Përmirësimi i kushteve të banimit për shtresat në nevojë	1	Numri i apartamenteve sociale funksionale për jetimët dhe grate kryefamiljare pa asnjë përkrahje;	24	24	24	24	100%	
		2	Numri i përfituesve të grantit për banesa me kosto të ulët.	0	0	2	2	100%	
Objektivi 2	Vlerësimi, planifikimi dhe sigurimi i kushteve të përshtatshme të banimit, për individët dhe familjet në nevojë, përmes ofrimit të alternativave për njëstrehim të	3	Numri i aplikimeve pranë Bashkisë për strehim social, bonus strehimi	163	233	347	339	98%	
		4	Numri i aplikimeve pranë qeverisë dhe donatorëve për programet sociale të strehimit në vit,	2	6	6	4	67%	
		5	Numri i banesave në rrezik shembje	0	50	10	10	100%	

gatshëm, të arritshëm, të përballueshëm dhe të përshtatshëm	6	Numri i banorëve përfitues;	3000	3000	3000	3000	100%	
	7	Numri i familjeve përfituese;	673	673	673	673	100%	
	8	Numri i banesave sociale me qira 2+1 dhe 1+1 (kontenier);	28	27	27	27	100%	
	9	Numri i familjeve përfituese	0	33	33	0	0%	
	10	Numri i banorëve përfitues	0	142	142	0	0%	
	11	Numri i banesave sociale prane ish konviktit të shkollës veterinare	28	28	28	28	100%	
	12	Numri i familjeve përfituese	0	28	28	0	0%	
	13	Numri i banesave sociale me qira pranë ish objektit ekzistues "pjesë të konviktit të shkollës Industriale " Arben Broci"	0	0	32	0	0%	

Realizimi i produkteve:

ANEKSI nr.3 "Raporti permbledhes i realizimit te treguesve te performances/produkteve te programit"

Emri i Grupit	Bashkia Shkodër	Kodi i Grupit	141
Program i	Strehimi Social	Kodi i Programit	10661

Kodi	Emertimi i Produktit	Njësia matese	Sasia Faktike (v. 2020)	Shpenzimet (v. 2020)	I		II		III		IV		Luhatjet ne Koston per Njesi			Komente		
					Kosto per Njesi (v. 2020)	Sasia (v. 2021)	Shpenzimet (v. 2021)	Kosto per Njese Rishikuar (v. 2021)	Shpenzimet e Rishikuar (v. 2021)	Kosto per Njese Rishikuar (v. 2021)	Sasia Faktike (v. 2021)	Shpenzimet Faktike (v. 2021)	Kosto per Njese Faktike (v. 2021)	V = IV - I	V = IV - II		V = IV - III	
1	Persona të mbështetur me strehim social ne banesa sociale me kosto të ulët	Numër Familjesh		737		16	1,154		39	1,182	30	16	115	7	7	7	-23	
2	Persona të mbështetur me grant të menjëhershëm për lehtësimin e pagesës së kredisë me kosto të ulët.	Numri i përfituesve							2	574	287	2		0	0	0	-287	
3	Persona të mbështetur me subvencionim qiraje në tregun e lire	Numri i Aplikimeve	163				600		44	8,468		44	3,747	85	85	85	85	

4	Projekte per permiresi min e kushteve te banimit te komunitete ve te paforizuar a	Numër projekt esh	2		0	6	0	6	0	4	0	0	0	0				
5	Rikonstruk sion i godinave në pronësi të njëjësive të vetëqeverisjes vendore për strehim social	Numri i banesa ve sociale	28	24,123	862	28	25,000	893	28	65,962	2,356	28	50,574	1,806	945	913	-550	
6	Rikonstruk sion i godinës ekzistuese pranë konviktit të shkollës industriale Arben Broci.	Numri i banesa ve sociale							32	12,639	395				0	0	-395	Projek ti nuk është miratuar nga Ministria e Linjës
7	Numri i banesave sociale me qira 2+1 dhe 1+1 (kontenier) ;	Numër banesash	28	35,571	1,270	27		0	27		0	27		0	-1,270	0	0	

Drejtuesi i Ekipit Menaxhues të Programit	Emri	Filip Vila	Kryetari i Njësisë së Vetëqeverisjes Vendore	Emri	Voltana Ademi
	Firma			Firma	
	Data			Data	



Për vitin 2021 në Programin “**Strehimi social**”, në funksion të veprimtarisë kryesore dhe përmbushjes së objektivave të përcaktuara , janë parashikuar këto aktivitete.

Aktivitete/Projekte	Buxheti fillestar 000/Lekë	Buxheti i rishikuar 000/Lekë	Realizimi Viti 2021 000/Lekë
P10661.O1.A1 Administrimi i banesave sociale me qira të ngritura pranë Qendrës Komunitare "Për Familjen" nr 6. dhe ofrimi i shërbimeve integruese & zhvilluese dhe te trasheguara.	1,154	1,182	115
P06190 Kodi i Ministrise P10661.O1.A2 Grant i menjëhershëm në zbatim të programit të strehimit social "Banesa me kostot të ulët"	-	574	Realizuar
P06190 Kodi i Ministrise P10661.O2.A1 Zbatimi i programeve të strehimit social dhe te trasheguara	600	8,468	3,747
P10661.O2.A2 Projekte qe synojne permiresimin e kushteve te banimit te komuniteteve te paforizuara	-	-	Realizuar
P6190.O2.A3. Rikonstruksion i godinave në pronësi të njëjësive të vetëqeverisjes vendore për strehim social (Rikonstruksion i ish Konviktit te Shkolles Veterinare) dhe te trasheguara.	25,000	65,962	50,574
P10661.O2.A4 Bashkëfinancim për përshtatje për strehim social të objektit ekzistues "pjesë të konviktit të shkollës Industriale " Arben Broci"	-	12,639	Projekti nuk eshte miratuar nga Ministria e Linjës
Të Trashëguara	25,645	-	-
Totali	52,399	88,825	54,436

- **P10661.O1.A1** Administrimi i banesave sociale me qira të ngritura pranë Qendrës Komunitare "Për Familjen" nr. 6 dhe ofrimi i shërbimeve integruese & zhvilluese.

Në funksion të vënies në zbatim të Shërbimeve integruese & zhvilluese dhe administrimin e apartamenteve sociale, të krijuar për personat e dalë nga institucionet e përkujdesit rezidencial dhe gratë kryefamiljare me probleme social- ekonomike, pranë Qendrës Komunitare "Për Familjen" nr 6 janë miratuar disa vendime mbi të cilat do të zbatohet dhe ky program strehimi si: Vendim i K.B nr. 14 datë 26.2 2021 "Për miratimin e masës së qirasë mujore për banesat sociale (tek Ish konvikti i shkollës pyjore), Vendim "Për miratimin e rregullores së administrimit dhe mirëmbajtjes së banesave sociale me qira pranë qendrës komunitare nr. 6".

Aktualisht kanë përfunduar të gjitha procedurat administrative dhe jemi në fazën përmbyllëse të këtij programi. Pranë banesave sociale me qira pranë Qendrës komunitare "Për familjen" nr. 6 janë strehuar 16 jetimë të dalë nga institucionet rezidenciale dhe familje një prindërore, të miratuar me vendim të Këshillit Bashkiak. Apartamentet në këtë godinë sociale janë pajisur me pajisjet e domosdoshme. Këto përfitues mbështeten me shërbime të kujdesit social për fuqizimin dhe përfshirjen sociale pranë Qendrës Komunitare "Për familjen" nr. 6.

- **P06190 Kodi i Ministrisë P10661.O1.A2** Grant i menjëhershëm në zbatim të programit të strehimit social "Banesa me kosto të ulët"

Në zbatim të shkresës nr. 773 prot. datë 15.1.2021 "Mbi fondet për programet e strehimit për vitin 2021" të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, Shtojca "A" dhe në zbatim të VKM- së nr. 555, datë 15.07.2020 "Për procedurat, kriteret dhe përparësitë për akordimin e grantit të menjëhershëm për banesat me kosto të ulët nga buxheti i shtetit", familjet që përfitojnë nga ky program janë:

- a) një person me aftësi të kufizuar, në përputhje me përcaktimet e bëra në nëndarjen "i", të shkronjës "c", të nenit 16, të këtij ligji, për këtë kategori;
- b) një individ me statusin e jetimit, i cili, në momentin e aplikimit nuk ka mbushur moshën 30 vjeç;
- c) kryefamiljarin e vetëm, në rastin kur ka në ngarkim fëmijë nën moshën 18 vjeç;
- d) familjet e komunitetit rom dhe egjiptian.

Shuma e grantit të menjëhershëm, që përfiton individi, është në masën 10% të çmimit të shitjes së banesës me kosto të ulët.

Pranë Bashkisë Shkodër janë depozituar dy kërkesa për të përfituar nga Granti i menjëhershëm, të cilat pas plotësimit të dokumentacionit dhe vlerësimit rezultojnë që përmbushin kriteret e përcaktuara duke vërtetuar statusin përkatës, në zbatim të pikës 11 të VKM-së 555 datë 15.07.2020 "Për procedurat, kriteret dhe përparësitë për akordimin e grantit të menjëhershëm për banesat me kosto të ulët nga buxheti i shtetit", të cilët janë miratuar si përfitues të këtij fondi me VKB nr. 4 datë 28.01.2021 "Për miratimin e listës së përfituesve të Grantit të Menjëhershëm për banesat me kosto të ulët për vitin 2021". Janë ndjekur procedurat për lëvrimin e këtij fondi pas miratimit nga

ministra e linjës.

- **P06190 Kodi i Ministrisë P10661.O2.A1** Zbatimi i programeve të strehimit social

Për të filluar zbatimin e programeve të strehimit social, në përmbushje të detyrimeve ligjore, Bashkia Shkodër ka përgatitur dhe miratuar në Këshill Bashkiak një paketë vendimesh, të cilat rregullojnë veprimtarinë e strukturës përgjegjëse dhe Komisionit të Strehimit pranë Bashkisë gjatë zbatimit të programeve të strehimit social. Gjatë kësaj periudhe informacioni në lidhje me programet e strehimit në zbatim ka qenë i publikuar në faqen zyrtare të Bashkisë si dhe janë shfrytëzuar mediat lokale për promovimin dhe shpërndarjen e këtij informacioni sa më shumë tek qytetarët. Gjithashtu specialisti i strehimit pranë Bashkisë ka qenë në dispozicion për ofrimin e informacionit dhe mbështetjes së nevojshme për qytetarët, çdo ditë pranë zyrës me një ndalesë.

Për instrumentin financiar “Subvencionimi i interesave të kredisë”, në fazën e parë kanë aplikuar 123 qytetarë, nga të cilët pas njoftimit për kualifikim në fazën e parë dhe plotësimit dokumentacioni, janë paraqitur për të plotësuar dokumentacionin 81 qytetarë.

Meqënëse Bashkia Shkodër kishte në dispozicion 100 kuota për vitin 2021, u zgjat afati i aplikimeve dhe në përfundim të procedurave, shqyrtimit në Komisionin e Strehimit, në total u miratuan 103 përfitues, nga të cilët 12 përfitues kanë nënshkruar kontratat me institucionet financiare, 19 të tjerë janë drejt finalizimit të kontratës për të përfituar kredinë me interes të lehtësuar. Në total 54 aplikues kanë paraqitur kërkesë për shtyerje të afatit të lidhjes së kontratës sipas parashikimeve ligjore.

Për të plotësuar kuotën e 100 përfituesve të parashikuar nga ministria e linjës me VKB nr. 41 datë 27.7.2021 “Për miratimin e listës shtesë së përfituesve dhe masën e subvencionimit të interesave të kredisë për individët/familje që përfitojnë banesa me kosto të ulët me kredi të lehtësuar nga shteti, për kuotat miratuar për vitin 2020”, është miratuar Lista shtesë prej 75 përfituesish, e cila i është dërguar Drejtorisë së përgjithshme të EKB-së dhe institucioneve financiare që zbatojnë këtë program.

Gjithashtu gjatë vitit 2021 është zbatuar instrumenti financiar për programin banesa sociale me qira “Subvencionimi i qirasë në treg të lirë”. Pas vlerësimit dhe shqyrtimit nga Komisioni i strehimit në varësi të fondit të parashikuar në buxhetin e Bashkisë për këtë fond, u miratua në Këshill Bashkiak lista me 3 përfitues në këtë program të cilët vijnë të përfitojnë nga ky program. Gjithashtu është miratuar lista me 41 përfitues të këtij programi me financim nga buxheti i shtetit dhe bashkëfinancim nga Bashkia Shkodër. Pas akordimit të fondit nga ministria e financës me shkresë nr. 3501/1 datë 22.2.2021 dhe miratimit të bashkëfinancimit nga ana e Bashkisë me VKB nr. 26 datë 20.4.2021, kanë filluar procedurat për lëvrimin e këtij fondi për ato përfitues që kanë depozituar kontratat e qirasë.

Në mbledhjen e Komisionit të strehimit me datë 09.12.2021 është miratuar lista me 123 përfitues për programin e Subvencionimit të qirasë në treg të lirë për vitin 2022. Të gjithë përfituesve i është

dërguar shkresë për dorëzimin e kontratave të qirasë më qëllim përcaktimin e vlerës së subvencionimit për secilin përfitues.

P10661.O2.A2 Projekte që synojnë përmirësimin e kushteve të banimit të komuniteteve të pafavorizuara.

Bashkia e Shkodrës prej disa vitesh po zbaton projekte me synim rritjen e fondit të banesave sociale për familjet dhe individët më në nevojë, duke rikonstruktuar dhe vënë në përdorim objekte publike pronë të Bashkisë Shkodër, si në ish konviktin e shkollës Pyjore dhe në ish konviktin e shkollës Veterinare.

Në vlerësimet e bëra, Bashkia e Shkodrës ka në pronësi objekte të tjera të cilat nuk janë përdorur asnjëherë ose nuk përdoren më sipas funksionit të tyre. Pranë konviktit të shkollës Industriale “Arben Broci” është një godinë që ka filluar ndërtimin në vitin 2008, me sipërfaqe ndërtimi 480 m², me numrin e kateve mbi tokë 1-4-5 kate, me leje ndërtimi.

Gjatë vitit 2021 është hartuar dhe kemi aplikuar për adaptimin e këtij objekti në banesa sociale me qira.

Gjithashtu vijon zbatimi i projektit për përshtatjen në banesa sociale me qira të ish konviktit të shkollës veterinare. Ka përfunduar projekti i strehimit social “Godina sociale” Rikonstruksion i godinave në pronësi të njërive të vetëqeverisjes vendore për strehim social (Ndërtim i ri, godina sociale, me kontinier 1+1 dhe 2+1)”, që synon përmirësimin e kushteve të banimit të komunitetit rom.

Me VKB nr. 29 datë 3.6.2021 “Për miratimin e listës përfundimtare të përfituesve për programin e banesave sociale të ngritura për komunitetin rom dhe për miratimin e “Rregullores së administrimit të banesave sociale me qira të ngritura për komunitetin rom në zbatim të projektit “Rikonstruksion i godinave në pronësi të njërive të vetëqeverisjes vendore për strehim social (Ndërtim i ri godina, me kontinier 1+1 dhe 2+1), është miratuar lista me 23 përfitues si dhe kuadri rregullator për administrimin e këtyre banesave. Gjithashtu është miratuar me vendim të Këshillit Bashkiak masa e qirasë mujore në këto banesa. Pavarësisht të kërkesës së vazhdueshme nga ana jonë kundrejt OSHE (Operatori i shpërndarjes së Energjisë Elektrike), për lidhjen e energjisë elektrike për banesat sociale, ata nuk e kanë realizuar lidhjen, kjo është bërë shkak që përfituesit e miratuar nga Këshilli Bashkiak të mos hyjnë në banesat që i janë dedikuar atyre.

- **P6190.O2.A3.** Rikonstruksion i godinave në pronësi të njërive të vetëqeverisjes vendore për strehim social (Rikonstruksion i ish Konviktit të Shkollës Veterinare)

Projekti për adaptimin e ish konviktit të shkollës veterinare në banesa sociale është në fazën përfundimtare. Nga ky projekt synohet të rikonstruktohen 28 banesa sociale dhe rreth 28 familje përfituese. Ky projekt është miratuar nga ministria e linjës dhe bashkëfinancohet nga Bashkia

Shkodër. Projekti është në proces zbatimi dhe synon përmirësimin e kushteve të banimit për disa familje në nevojë përmes rikonstruksionit të godinave ekzistuese në pronësi të Bashkisë Shkodër për strehim social.

Projekti i strehimit social "Godina sociale" Rikonstruksion i godinave në pronësi të njërive të vetëqeverisjes vendore për strehim social (Ndërtim i ri, godina sociale, me kontinier 1+1 dhe 2+1)", në Programin 10661 "Srehimi Social", art. 231, zëri: Investime si dhe në Programin e Ministrisë së Financës nr. 6190, art. 231, ka përfunduar. Ky projekt synon të strehojë 142 banorë të komunitetit rom në 27 banesa 1+1 dhe 1+2.

- **P10661.O2.A4** Bashkëfinancim për përshtatje për strehim social të objektit ekzistues pjesë të konviktit të shkollës Industriale "Arben Broci".

Duke vlerësuar si shumë të nevojshëm shtimin e fondit të banesave sociale me qira në dispozicion të individëve dhe familjeve në nevojë për të rritur numrin e përfituesve të strehimit social dhe përmirësimin e kushteve të strehimit për individët/familjet në nevojë për shtrehim, Bashkia Shkodër ka hartuar dhe aplikuar pranë ministrisë së linjës projektin për adaptimin e godinës pranë konviktit të shkollës industriale në banesa sociale me qira. Ky projekt përmban rikonstruksionin e objektit më synim krijimin e 32 banesave monolokale dhe gjithashtu krijimin e një qendre komunitare multifunksionale që do të ofrojë programet e shërbimeve sociale e administrative për përfituesit e këtyre banesave dhe për komunitetin e lagjes.

Që me përfundimin e punimeve në vitin 2010 ky objekt nuk është vënë asnjëherë në përdorim si rezultatet i mungesës së nevojës për akomodimin e nxënësve. Gjatë këtyre viteve dhe në vazhdim numri i kërkesës së nxënësve për akomodim në konvikte ka rënie progresive dhe si rezultat i mos përdorimit të objektit kanë filluar dëmtimet të cilat me kalimin e viteve kanë ardhur në rritje.

Aktualisht Ministria e Financave dhe Ekonomisë, përmes shkresës nr. Shkresës së Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 657, datë 14.01.2021 "Mbi fondet për projektet e strehimit për vitin 2021", ka hapur një thirrje për financim të projekteve për strehimin social ku një ndër projektet që financohet është: "Banesë sociale me qira që sigurohet nëpërmjet adaptimit të objekteve ekzistuese, procedurat e të cilit përcaktohen sipas VKM-së nr.458, datë 3.7.2019.

Bashkia Shkodër ka miratuar bashkëfinancimin e këtij projekti me VKB nr. 26 datë 20.4.2021 pasi ka miratuar më përpara bashkëfinancimin në parim.

Ky projekt i hartuar në kuadër të Thirrjes së sipërcituar, nuk është miratuar nga ministria e linjës.